

# PASQYRË E KOMUNITETIT ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN TË KOSOVËS

**osbe**

Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Misioni në Kosovë

JANAR 2020



Pasqyrë e përgjithshme	4
Komuna e Deçanit	8
Komuna e Ferizajt	12
Komuna e Fushë Kosovës	16
Komuna e Gjakovës	20
Komuna e Gjilanit	24
Komuna e Graçanicës	28
Komuna e Istogut	32
Komuna e Kamenicës	36
Komuna e Klinës	40
Komuna e Leposaviqit	44
Komuna e Lipjanit	48
Komuna e Mamushës	52
Komuna e Mitrovicës së Veriut	54
Komuna e Mitrovicës së Jugut	56
Komuna e Novobërdës	60
Komuna e Obiliqit	64
Komuna e Pejës	68
Komuna e Podujevës	72
Komuna e Prishtinës	76
Komuna e Prizrenit	78
Komuna e Rahovecit	82
Komuna e Shtimes	86
Komuna e Suharekës	90
Komuna e Vushtrrisë	94
Shtojca 1: Fotografitë e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta që vijohen nga nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë	98
Shtojca 2: Të dhëna demografike për të gjitha komunat e Kosovës	107

# Pasqyrë e përgjithshme

Romët e Kosovës, ashkallitë e Kosovës dhe egjiptianët e Kosovës jetojnë tradicionalisht në Kosovë dhe kanë kontribut thelbësor në shoqërinë e larmishme të saj me traditat dhe kulturat e tyre të dalluara. Pjesëtarët e këtyre tri komuniteteve janë të shpërndarë në tërë Kosovën, kryesisht në 24 komuna, me një prani më të madhe në komunat Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Pejë dhe Prizren.

Në këtë publikim janë marrë parasysh të gjitha komunat në të cilat, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, më shumë se 50 pjesëtarë të ndonjërit prej komunitetit rom, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës kanë banim të përhershëm dhe kanë ndjenjë të komunitetit.<sup>1</sup>

Të dhënat e fundit zyrtare mbi përfaqësimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë janë marrë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011,<sup>2</sup> i cili thekson se në Kosovë jetojnë 8.824 romë, 15.436 ashkali dhe 11.524 egjiptianë. Kështu, romët përbëjnë 0.51 për qind të popullsisë në Kosovë, ashkallitë 0.89 për qind dhe egjiptianët 0.66 për qind. Megjithatë, këto shifra nuk paraqesin imazhin e saktë demografik të këtyre tri komuniteteve, meqë në regjistrim nuk morën pjesë të gjithë pjesëtarët e tyre dhe regjistrimi nuk është kryer në katër komunat veriore.<sup>3</sup> Për më tepër, përfaqësuesit e komunitetit dhe zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) kanë vlerësime joformale të numrit të secilit komunitet dhe mospërputhjet në numër mund të paraqesin shkallën e lindshmërisë dhe vdekshmërisë brenda komuniteteve, por edhe lëvizjet e popullatës në lidhje me migracionin dhe riatdhesimit nga Evropa Perëndimore, veçanërisht në periudhën 2014 dhe 2016.<sup>4</sup>

Shumica e anëtarëve të tri komuniteteve shpeshherë jetojnë në margjina të shoqërisë, në përpjekje me nivele të larta të papunësisë dhe arritje të ulët arsimore. Shpeshherë jetojnë në vendbanime të cilat janë në disa raste janë joformale, me infrastrukturë të dobët, dhe në shtëpi që janë në kushte të mjera. Për më tepër, anëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, dhe gratë në veçanti, përballen me barriera që çojnë në përjashtimin e tyre nga pjesëmarrja në të gjitha fushat e jetës. Në të njëjtën kohë, shumë pjesëtarë të tri komuniteteve marrin ndihmë sociale të administruar nga Pr-

ishtina ose Beogradi. Në mars të vitit 2019, 2,000 romë (813 burra, 1,187 gra), 3,581 ashkali (1,372 burra, 2,209 gra) dhe 947 egjiptianë (399 burra, 548 gra) kanë pranuar ndihmë sociale nga Prishtina<sup>5</sup>; nuk ka të dhëna të ngjashme të besueshme për ndihmat sociale të dhëna nga Beogradi. Në rastet kur pjesëtarët e këtyre tri komuniteteve janë të punësuar, kjo punë është shpesh punë manuale sezonale. Disa punojnë në sektorin publik, kryesisht si mësues ose nëpunës civilë.

Situata në lidhje me shkollimin është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme. Monitorimi i OSBE-së tregon se braktisja e shkollimit nuk është më problem sistemik. Në vitin shkollor 2018 / 2019, 1.509 romë të Kosovës (810 djem, 699 vajza), 3,439 ashkali të Kosovës (1.750 djem, 1.689 vajza) dhe 847 egjiptianë të Kosovës (444 djem, 403 vajza) vijonin shkollimin fillor dhe të mesëm të ulët me kurrikulë të Kosovës<sup>6</sup>. Numri i nxënësve nga tri komunitetet që vijojnë shkollimin e mesëm tregon një trend pozitiv – në vitin shkollor 2018 / 2019, 161 romë të Kosovës (98 djem dhe 63 vajza), 262 ashkali të Kosovës (151 djem dhe 111 vajza) dhe 160 egjiptianë të Kosovës (93 djem dhe 67 vajza) vijonin shkollat e mesme me kurrikulë të Kosovës<sup>7</sup>. Kjo u ndihmua nga dhënia e bursave nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.<sup>8</sup> Numri i studentëve universitarë nga të tri komunitetet gjithashtu është rritur në vazhdimësi. Sipas përfaqësuesve të Roma Versitas, 42 studentë nga të tri komunitetet u regjistruan në institucionet e arsimit të lartë në vitin akademik 2018 / 2019, ndërsa kjo shifër u rrit në 53 në vitin akademik 2019 / 2020.<sup>9</sup>

Brenda komunave ku ata banojnë në një numër të konsiderueshëm, komuniteti rom, komuniteti ashkali dhe ai egjiptian përfaqësohen në mënyrë adekuate në mekanizmat e mbrojtjes së komuniteteve: ZKKK dhe komiteti i komuniteteve (KK), të detyrueshëm për secilën komunë ku duhet të përfaqësohen të gjitha komunitetet që banojnë në një komunë të caktuar; nënkryetari i komunës për komunitete (NKK) dhe zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal për komunitete (ZKKKK), i detyrueshëm për komunat ku komunitetet përbëjnë së paku dhjetë për qind të popullsisë së përgjithshme.<sup>10</sup> Më 2019, Ferizaj, Fushë Kosova dhe Lipjani kanë NKK dhe në Lipjan është një ashkali si ZKKKK. Gjersa pjesëtarët e stafit të ZKKK janë nëpunës civilë, pozitat e NKK dhe ZKKKK janë të emëru-

ar politikë dhe nuk llogariten në prapësinë e shërbimit civil. Anëtarët e KK që nuk janë nëpunës civilë marrin mëditje për çdo takim ku marrin pjesë. Jashtë komunave ku ata jetojnë në numër të konsiderueshëm, pjesëtarët e tre komuniteteve nuk janë të përfaqësuar sa duhet në shërbimin civil.<sup>11</sup> Në vitin 2017, vetëm 12 nga 24 komunat e synuara përmbushën prapësinë minimale<sup>12</sup> për përfaqësim në shërbimin civil për të gjitha komunitetet në pakicë numerike; komuniteti rom është i përfaqësuar në mënyrë adekuate në shërbimin civil komunal në pesë komuna,<sup>13</sup> ndërsa komuniteti ashkali dhe komuniteti egjiptian janë të nënpërfaqësuar në shërbimin civil në secilën komunë ku ata banojnë.

Shumë pjesëtarë të tri komuniteteve u shpërngulën pas konfliktit 1998-99, kryesisht në Serbi, Maqedoni të Veriut dhe Mal të Zi. Sipas Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), deri në fund të shtatorit 2019, 3,935 romë të Kosovës, 2,172 ashkali të Kosovës dhe 1.513 egjiptianë të Kosovës janë kthyer vullnetarisht në Kosovë. Për më tepër, gjithsej 3,917 ashkali dhe egjiptianë u kthyen vullnetarisht në Kosovë nga 2001 dhe 2005.<sup>14</sup>

Që nga themelimi i tij, Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE, ka promovuar përfshirjen e të tri komuniteteve në Kosovë duke mbështetur dhe avokuar zhvillimin dhe zbatimin e politikave, me qëllim të përmirësimit të përfshirjes sociale dhe mirëqenies së anëtarëve të komuniteteve. Puna e OSBE-së, kryesisht përmes roleve monitoruese dhe këshilluese të ekipeve të saj në terren nëpër komuna, ka kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e lidhjeve midis tri komuniteteve dhe institucioneve.

Monitorimi i OSBE-së ka identifikuar mungesën e publikimeve gjithëpërfshirëse që paraqesin një pasqyrë të jetës së komuniteteve në komuna, siç janë publikimet që identifikojnë sfidat më të zakonshme me të cilat komunitetet përballen në jetën e tyre të përditshme. Ky publikim synon të ngrisë vetëdijësimin mbi situatën e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të Kosovës, duke identifikuar vendet ku ata banojnë në numër më të madh. Gjithashtu, publikimi synon t'i paraqesë nevojat e tyre duke përshkruar sfidat themelore me të cilat përballen të tre komunitetet në nivel komunal, si dhe duke paraqitur fakte pa hyrë në analizë ose vlerësim thelbësor të performancës institucionale.

## ■ Metodologjia

Për qëllime të këtij publikimi, ekipet e OSBE-së në terren siguruan të dhëna të monitorimit për 24 nga 38 komuna.<sup>15</sup> Këto komuna të veçanta janë përzgjedhur sepse kanë përqendrim të dukshëm prej së paku një nga tri komunitetet.<sup>16</sup> Njëzetënjë komuna janë zgjedhur bazuar në të dhënat e regjistrimit të vitit 2011.<sup>17</sup> Për më tepër, janë përfshirë edhe Leposaviqi dhe Mitrovica e Veriut, pasi monitorimi i OSBE-së tregon se romët dhe ashkalitë e Kosovës janë me bazë në këto komuna, megjithëse disa prej tyre janë të zhvendosur. Situata e romëve dhe ashkalive të Kosovës të zhvendosur në kampe në komunën e Leposaviqit kishte tërhequr vëmendje të konsiderueshme ndërkombëtare, që është arsye shtesë për përfshirjen e komunës në këtë botim.

Kapitujt për secilën komunë bazohen në të dhënat e mbledhura nga pyetësorët e zhvilluar dhe intervistat e kryera gjatë qershorit dhe korrikut 2017 nga OSBE. Sipas nevojës, të dhënat u përditësuan përmes intervistave të kryera në mars 2019, në mënyrë që të pasqyrojnë çdo ndryshim që mund të ketë ndodhur që nga intervistat fillestare. Pyetësi kryesor që përfshin seksionet aktuale është përshtatur enkas për secilën kategori të të anketuarve. Të intervistuarit e përzgjedhur të intervistuar në secilën prej 24 komunave të përfshira në këtë botim ishin: përfaqësues të komunitetit,<sup>18</sup> përfaqësues të ZKKK, përfaqësues të drejtorive komunale të shëndetësisë dhe arsimit, drejtorë të shkollave me një numër të konsiderueshëm nxënësish nga të tre komunitetet, përfaqësues të organizatave joqeveritare (OJQ) aktive në komunë, përfaqësues të qendrave mësimore me bazë në komunë dhe përfaqësues të qendrave rajonale të punësimit. Gjithashtu, në konsideratë u mor edhe vlerësimi i ekipeve në terren të OSBE-së bazuar në monitorimin e tyre të rregullt në 24 komuna. Të gjitha të dhënat e paraqitura në botim janë të vlefshme që nga marsi 2019, përveç nëse specifikohet ndryshe.

## ■ Struktura

Ky publikim përmban 23 profile, të cilat paraqesin secilën nga 23 komunat. Komunat janë radhitur sipas rendit alfabetik dhe secili profil komunal së pari paraqet regjistrimin e vitit 2011 dhe numrin e vlerësuar të pjesëtarëve të tri komuniteteve që jetojnë në komunë deri në dhjetor 2018, të siguruar nga ZKKK dhe përfaqësuesit e komunitetit, si dhe listohen vendbanimet ku pjesëtarët e tri komuniteteve jetojnë në komunë. Pjesët në vijim ofrojnë një përmbledhje të situatës së tri komuniteteve në komunë në fushën e strehimit dhe infrastrukturës; përfaqësimit në vendimmarrje; arsimit;<sup>19</sup> punësimit dhe mirëqenies sociale - me fokus të veçantë në punën e fëmijëve; dhe kujdesin shëndetësor. Më pas paraqitet situata e përgjithshme e pjesëtarëve të riadhesuar dhe të kthyer vullnetarisht të tri komuniteteve. Kur është e aplikueshme, në kapitull është përfshirë edhe një pjesë për gjuhën rome si gjuhë në përdorim zyrtar në nivelin komunal.<sup>20</sup> Secili kapitull plotësohet me fotografi që paraqesin jetën e pjesëtarëve të tri komuniteteve në komunën e caktuar. Në fund, ky publikim gjithashtu përfshin një Shtojcë që përshkruan të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë për vijueshmërinë shkollore të nxënësve nga tri komunitetet në 24 komunat e paraqitura. Shtojca e fundit ofron një pasqyrë të detajuar demografike për të tri komunitetet në të gjitha komunat e Kosovës. Pasqyra ofron të dhëna demografike nga Regjistrimi i popullsisë më 2011, i zbërthyer sipas komuniteteve dhe gjinisë dhe jep vlerësime të përafërta në komunat nuk u mbajt regjistrimi i popullsisë më 2011.

## ■ Shënim për të tri komunitetet

OSBE-ja i njeh romët, ashkalitë dhe egjiptianët e Kosovës si tri komunitete të veçanta. Megjithatë, ky publikim botimi mbulon të tri komunitetet meqë ata përgjithësisht përbal len me pengesa dhe sfida të ngjashme, në kuptim të përfshirjes së tyre në shoqëri. Në komunat ku jetojnë pjesëtarë të më shumë se një prej tri komuniteteve, është bërë një përpjekje për t'i zbërthyer qartas të dhënat dhe për të bërë dallimin midis komuniteteve të ndryshme.

<sup>1</sup> Leposaviqi, për të cilin nuk ka të dhëna të regjistrimit të popullsisë, është megjithatë i rëndësishëm për shkak të fokusit ndërkombëtar lidhur me ndotjen me plumb që prek pjesëtarët romë dhe ashkali të Kosovës, të cilët kanë banuar në kampe të personave të zhvendosur. Ngjashëm, Mitrovica e Veriut gjithashtu është shtuar duke krahasuar popullatën e saj të madhe të komunitetit rom dhe ashkali të Kosovës. Në mungesë të të dhënave të regjistrimit të popullsisë, janë përdorur të dhënat e profilit komunal të Misionit të OSBE-së në Kosovë të tetorit 2018; Profili Komunal i Leposaviqit, Profili Komunal i Mitrovicës së Veriut, tetor 2018,

në dispozicion në <http://www.osce.org/kosovo/13120> (qasur më 11 nëntor 2019).

<sup>2</sup> Agjencia e Kosovës për Statistika, Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave të Kosovës 2011 - Rezultatet përfundimtare, 14 shtator 2012, në dispozicion në [http://ask.rks-gov.net/media/2075/final-results\\_eng.pdf](http://ask.rks-gov.net/media/2075/final-results_eng.pdf) (arrihen më 12 tetor 2017), faqe 143.

<sup>3</sup> Komunat Leposaviqi, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut.

<sup>4</sup> Nuk ka në dispozicion fare të dhëna për personat që kanë braktisur Kosovën në periudhën nga 2014 dhe 2016 e që mëpastaj janë riadhesuar. Çdo shtet

anëtar i BE-së ka të dhëna kumulative për të gjithë personat e riadhesuar në Kosovë.

**5** Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, statistikat e vitit 2019 në dispozicion të Misionit të OSBE-së në Kosovë

**6** Të dhëna nga një email i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për OSBE-në, të datës 17 shtator 2019.

**7** Po aty.

**8** Shih raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Qasja e komuniteteve në arsimin parauniversitar në Kosovë, dhjetor 2018, në dispozicion në <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/406952> (qasur më 17 shtator 2019), f. 18.

**9** Shifrat e siguruar nga Roma Versitas për OSBE përmes postës elektronike më 17 shtator 2019. Arsimi universitar i pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë do të jetë subjekt i një raporti të planifikuar të Misionit të OSBE-së në Kosovë.

**10** Neni 61 i ligjit nr. 03 / L-040 për vetëqeverisjen lokale; dhe neni 6.2 i udhëzimit administrativ nr. 2014 / 01 për procedurat e emërimit të zëvendëskryetarëve të komunave, i cili përcakton se komuna ku së paku 10 për qind e banorëve të saj i përkasin komuniteteve në pakicë numerike duhet të emërojnë NKK dhe kjo pozitë duhet t'i jepet përfaqësuesit të komunitetit më të madh joshumicë që banon në komunë.

**11** Në nenin 11.3 të ligjit nr. 03 / L-149 për shërbimin civil (14 qershor 2010) përcaktohet që në komunat ku komunitetet nuk përbëjnë shumicë, numri i pozitave të rezervuara në shërbimin civil do të jetë në përputhje me përqindjen e përfaqësimit të komuniteteve në komunën e caktuar.

**12** Deçan, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjilan, Istog, Kamenicë, Klinë, Lipjan, Mitrovice e Jugut, Obiliq, Vushtrri, Rahovec. Për hollësi ju lutem shihni Raportin e OSBE-së Përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil në Kosovë: Raporti përcjellës (maj 2017), f.44 <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/320496?download=true> (qasur më 29 maj 2018).

**13** Ferizaj, Fushë Kosova, Klinë, Lipjan dhe Novobërdë, shiko shënimin më sipër 8.

**14** Zyra e UNCHR në Kosovë, Pasqyrë Statistike 2019. Ju lutem vëreni se UNHCR ka regjistruar numrin e pjesëtarëve të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë ndaras nga viti 2016 e tutje.

**15** Për informata të përgjithshme mbi komunat, shihni profilet komunale të OSBE-së të disponueshme në adresën <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/410279>.

**16** Për qëllime të këtij publikimi, një komunë

përfshihet nëse numri i kombinuar i pjesëtarëve të tri komuniteteve është më i madh se 50, sipas regjistrimit të vitit 2011 ose nëse ceket ndryshe.

**17** Komunitet janë: Deçan, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Graçanicë, Istog, Kamenicë, Klinë, Lipjan, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Suharekë dhe Vushtrri.

**18** Përkufizuar si "persona të një pozicioni të autoritetit zyrtar ose joformal brenda komuniteteve që kanë pasur histori afatgjate të kontaktit dhe bashkëpunimit me strukturat komunale dhe me ekipet në terren të Misionit të OSBE-së".

**19** Një numër mospërputhjes vërehen midis numrit të banorëve romë, ashkali ose egjiptianë të regjistruar me regjistrimin e vitit 2011 dhe numrit të nxënësve nga tri komunitetet që vijojnë arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, për disa arsye: disa komuna nuk e pasqyrojnë përkatësinë e komunitetit të nxënësve, ose i regjistrojnë nxënësit bazuar në vetëdeklarimin e prindërve, ose bazuar në perceptimin e tyre për përkatësinë e komunitetit të një nxënësi të caktuar. Çështje të ngjashme mund të aplikohen edhe për shifrat e papunësisë të ofruara nga qendrat e punësimit.

**20** Që nga korriku 2017, Graçanicë e ka përcaktuar gjuhën rome si gjuhë në përdorim zyrtar në nivel komunal, ndërsa ka pasur përpjekje për të arritur këtë përcaktim në Prizren.



# Komuna e Deçanit

## Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 ka zbuluar se nga 40,019 banorë të regjistruar në komunën e Deçanit, 68 janë romë, 42 ashkali dhe një është egjiptian.<sup>21</sup> Sidoqoftë, vlerësimet e siguruara nga ZKKK tregojnë se në dhjetor 2018, në komunë banonin 283 egjiptianë dhe 11 romë, ndërsa nuk ishte regjistruar asnjë pjesëtar i komunitetit ashkali.<sup>22</sup> Në qytetin e Deçanit, në fshatrat Baballoq, Pemishtë dhe Shaptej banojnë pjesëtarë të komunitetit rome dhe atij egjiptian, ndërsa në fshatrat Gramaçel dhe Dubovik kryesisht banojnë pjesëtarë të komunitetit egjiptian.<sup>23</sup>

## Banimi dhe infrastruktura

Që nga dhjetori i vitit 2018, shumica e pjesëtarëve të komunitetit egjiptian dhe atij rom jetonin në vendbanime formale, në shtëpi të përhershme, pa çështje madhore, por disa familje janë në nevojë të madhe për rinovim dhe zgjerim për shkak të rritjes së numrit të anëtarëve të familjes. Disa nga shtëpitë mund të konsiderohen

të papërshtatshme për banim. Pjesëtarët e komunitetit egjiptian që jetojnë në fshatrat Gramaçel dhe Dubovik vuajnë nga probleme të kamotshme që kanë të bëjnë me infrastrukturën e dobët rrugore dhe mungesën e sistemeve të kanalizimit.<sup>24</sup>

## Përfaqësimi në vendimarrje<sup>25</sup>

Edhe komuniteti egjiptian edhe ai rom përfaqësohen me nga një person në KK; pjesëtari burrë egjiptian kryeson komitetin.<sup>26</sup> Një burrë rom, një burrë ashkali dhe një burrë egjiptian përfaqësojnë komunitetet e tyre në Këshillin Komunal të Sigurisë në Bashkësi (KKS). Asnjë pjesëtarë i këtyre komuniteteve nuk është i punësuar në kuadër të ZKKK. Pozitat e NKK-së dhe ZKKK-së nuk janë të detyrueshme meqë komunitetet në pakicë numerike përbëjnë më pak se dhjetë për qind të tërë popullatës në komunë.

## Arsimi

Pjesëtarët e komunitetit rom dhe atij egjiptian marrin pjesë në shkollat e ciklit fillor dhe të mesëm të ulët me kurrikula të Kosovës. Sipas të dhënave të siguruar nga drejtoria komunale e arsimit më 25 korrik 2018, gjithsej 14 nxënës romë të Kosovës, 45 ashkali të Kosovës dhe 63 egjiptianë të Kosovës janë regjistruar në shkollën "Jusuf Gërvalla" në fshatin Prapaqan, shkollën "Drita" në fshatin Gramaçel, shkollën "Rexhep Kadrija" në fshatin Rastavicë dhe shkollën "Heronjët e Dukagjinit" në fshatin Glllogjan. Të gjitha shkollat e cekura ofrojnë arsim fillor dhe të mesëm të ulët. Në komunën e Deçanit nuk ka qendra mësimi ose klasa të gjuhës dhe kulturës rome.<sup>27</sup>

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Gjersa Deçani ka përmbushur pragun minimal për përfaqësimin e të gjitha komuniteteve në pakicë numerike në shërbimin civil, ai nuk e ka përmbushur pragun minimal të kërkuar për secilin komunitet

që banon në komunë.<sup>28</sup> Sipas informacionit të ofruar nga përfaqësuesi i qendrës së punësimit, në komunë nuk ka shërbyes civilë romë ose egjiptianë dhe vetëm një grua egjiptiane është e punësuar nga institucionet publike si pjesë e stafit të pastrimit dhe mirëmbajtjes.<sup>29</sup>

Pjesëtarët e komunitetit rom dhe egjiptianë mbështeten në të ardhurat e krijuara nga aktiviteti ekonomik joformal ose nga punësimi sezonal, ku kryesisht janë burrat ata që e mbajnë familjen. Qasja në sektorin privat mbetet sfidë për pjesëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian të Kosovës. Sipas zyrës komunale të punësimit, janë 56 romë (36 burra dhe 20 gra), dhe 21 egjiptianë (19 burra dhe dy gra) të regjistruar si punëkërkuar aktivë, ndërsa sipas qendrës për mirëqenie sociale, janë 19 familjet egjiptiane (me gjithsej 86 anëtarë) dhe katër familje ashkali (me gjithsej 21 anëtarë) që marrin ndihmë sociale.<sup>30</sup> Bazuar në informatat e ofruara nga përfaqësuesit e komunitetit rom dhe atij egjiptian, ekziston puna e fëmijëve, por nuk ka të dhëna të besueshme në dispozicion për numrin dhe gjininë e fëmijëve të prekur.<sup>31</sup>

## Shëndetësia

Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor ofrohen nga qendra kryesore të mjekësisë në Deçan dhe qendra e mjekësisë familjare në fshatra. Asnjë çështje madhore nuk është identifikuar në lidhje me qasjen në kujdesin shëndetësor për pjesëtarët e komunitetit rom dhe atij egjiptian në komunën e Deçanit, përveç për banorët e fshatit Pemishtë, ku ofruesi i kujdesit shëndetësor ndodhet pesë kilometra larg. Ndihma pa pagesë rreth shëndetit riprodhues është në dispozicion në komunë.<sup>32</sup>



## ■ Kthimi dhe riatdhesimi

Asnjë pjesëtar i komunitetit nuk është kthyer nga zhvendosja në periudhën mes 1 janarit 2016 dhe 31 dhjetorit 2018. Në të njëjtën periudhë, një grua rome me gjashtë fëmijë dhe dy burra egjiptianë u riatdhesuan në komunë.<sup>33</sup>

**21** Agjencia e Statistikave të Kosovës, shih më sipër shënimin 2.

**22** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, mbajtur më 12 mars 2019.

**23** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, mbajtur më 12 mars 2019, si dhe me tre përfaqësues të komuniteteve, mbajtur më 13 mars 2019 dhe 14 mars 2019.

**24** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, mbajtur më 18 korrik 2017, si dhe me tre përfaqësues të komuniteteve, mbajtur më 4 korrik 2017 dhe 15 korrik 2017.

**25** Të dhënat për përfaqësimin në vendimmarrje në tërë raportin janë të vlefshme që nga 15 marsi 2019. Bazohet në monitorimin dhe njohuritë e ekipeve në terren.

**26** Një grua rome, një burrë egjiptian.

**27** Intervistë me drejtorin komunal të arsimit, mbajtur më 17 korrik 2017.

**28** Raporti i OSBE-së, shih shënimin sipër8.

**29** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punësim, zhvilluar më 12 mars 2019.

**30** Intervista me përfaqësues të qendrës së punësimit dhe qendrës për punë sociale, mbajtur më 12 mars 2019.

**31** Intervistat me përfaqësues të komunitetit u mbajtën më 4 dhe 15 korrik 2017, dhe me përfaqësues të OJQ-së më 17 korrik 2017.

**32** Intervista me drejtorin komunal të shëndetësisë u mbajt më 20 korrik 2017.

**33** Nuk ka të dhëna të zbërthyera sipas gjinisë për fëmijët; intervistë me përfaqësuesin e ZKKK, mbajtur më 12 mars 2019.







# Komuna e Ferizajt

## Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Një numër i konsiderueshëm i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të Kosovës besohej se kishin jetuar në komunën e Ferizajt para konfliktit të vitit 1999. Sidoqoftë, nuk ka statistika zyrtare në dispozicion, sepse regjistrimi i vitit 1991 në Kosovë siguron vetëm të dhëna për komunitetin rom.<sup>34</sup> Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, nga 108,610 banorë të regjistruar në komunën e Ferizajt 3,629 janë ashkali, 204 janë romë dhe 24 janë egjiptianë.<sup>35</sup> Sipas ZKKK dhe përfaqësuesve të komunitetit, vlerësohet se 3,332 ashkali (1,624 burra dhe 1,708 gra), 286 romë (138 burra dhe 148 gra) dhe 14 egjiptianë (gjashtë burra dhe tetë gra) janë me banim në komunë.<sup>36</sup>

Të gjithë romët dhe egjiptianët dhe shumica e ashkalive jetojnë në lagjet urbane Sallahane, Halit Ibishi, Geric dhe Koçi Xoxe. Një numër i konsiderueshëm i ashkalive është me banim në fshatrat rurale të Dubravës (1.335 pjesëtarë) dhe Koshare (34 pjesëtarë).

## Banimi dhe infrastruktura

Sipas kreut të ZKKK dhe NKK, as komuniteti rom as ai egjiptian nuk ka çështje madhore të banimit, gjersa pjesëtarët e komunitetit ashkali kanë nevojë për ndërtimin apo rindërtimin e shtëpive, që përfshin ose riparime ose ndërtime të anekseve dhe banjave të brendshme. Sipas kreut të ZKKK, afërsisht 170 kërkesa që kanë të bëjnë me ndërtimin ose rindërtimin e shtëpive nga pjesëtarët e komunitetit ashkali janë dorëzuar nga janari 2015 dhe korriku 2017. Nga korriku deri në dhjetor 2017, 26 raste janë proceduar si pjesë e një projekti të përbashkët të komunës me OJQ-në “Zëri i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve” (OJQ VoRAE), nga të cilat 14 ndërtime të njësisive të banimit dhe 12 projekte rindërtimi kanë përfunduar.<sup>37</sup> Për shkak të mungesës së fondeve, rastet e mbetura iu përcollën Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) për ndihmë. Në Tetor 2018, komuna nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me MPMS për ndërtimin e 14 shtëpive për dhjetë familje të cënueshme ashkali, tri familje egjiptiane dhe një familje rome. Ministria ka shpallur

tenderin për zbatimin e projektit dhe ndërtimi përfundoi në vitin 2019.

## Përfaqësimi në vendimmarrje

Të tri komunitetet janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate në mekanizmat komunalë për mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e komuniteteve, ku secila prej tri komuniteteve ka anëtar në KK dhe KKS. Kryesuesi i KK dhe udhëheqësi i ZKKK janë pjesëtarë të komunitetit ashkali; që të dy janë burra. Në periudhën e administratës komunale 2013–2017, një burrë ashkali u zgjodh në kuvendin komunal (KK). Por, që pas zgjedhjeve lokale të tetorit 2017, nuk ka asnjë përfaqësues të tri komuniteteve në kuvendin komunal. Një burrë ashkali u emërua si NKK.<sup>38</sup>

## Arsimi

Fëmijët nga të tri komunitetet vijojnë mësimin në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta të Kosovës. Ferizaj nuk ka shkollë që punojnë me kurrikulën serbe, kështu nxënësit romë janë të integruar në arsimin

me kurrikulë kosovare, gjë që ishte njëjtë edhe para konfliktit të vitit 1999. Sipas të dhënave të siguruar nga drejtorja komunale e arsimit, në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët janë të regjistruar 36 romë, 637 ashkali dhe dy egjiptianë, ndërsa 97 fëmijë nga të tri komunitetet janë duke vizuar arsimin e mesëm të lartë.<sup>39</sup> Shumica e nxënësve nga të tri komunitetet janë regjistruar në katër shkolla fillore dhe të mesme të mesme të Kosovës, “Ahmet Hoxha”, “Tefik Çanga”, “Gjon Sereqi” dhe “Vezir Jashari” në qytetin e Ferizajt dhe shkollën “Naim Frashëri” në fshatin Zaskok.

Sipas drejtorit të shkollës fillore dhe të mesme të ulët “Ahmet Hoxha” në Ferizaj, në këtë shkollë mësohet gjuha rome me elemente të kulturës dhe historisë. Ajo është lëndë zgjedhore. Pagesa e mësuesit si dhe botimi dhe blerja e teksteve shkollore financohen nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Lënda mbahet një herë në javë për rreth 20 nxënës të regjistruar.<sup>40</sup>

Për më tepër, sipas statistikave të ZKKK, 38 fëmijë ashkali dhe gjashtë fëmijë romë janë regjistruar në institucione parashkollore.<sup>41</sup> Për më tepër, Qendra e Edukimit Ashkali në fshatin Dubravë organizon aktivitete passhkollore, si klasa mësimore për fëmijët nga tri komunitetet duke i ndihmuar ata të përmirësojnë arritshmërinë e tyre në shkollë. Qendra gjithashtu siguron ambiente ku fëmijët kryejnë detyrat e shtëpisë dhe mësojnë, meqë shumica e fëmijëve nuk kanë kushte të përshtatshme sepse jetojnë në shtëpi të vogla dhe me familje të zgjeruara.<sup>42</sup>

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Gjersa komunitetet kanë përfaqësim adekuat në mekanizmat e mbrojtjes së komuniteteve dhe pjesëmarrjes, asnjëri komunitet nuk është i përfaqësuar mirë në shërbimin civil komunal, ku Ferizaj nuk ka përmbushur pragun e kërkuar minimal për përfaqësimin e secilit komunitet në shërbimin civil.<sup>43</sup> Gjithsej, dy romë dhe shtatë ashkali, të gjithë burra, punojnë në administratën komunale, dy burra romë dhe dy gra ashkali janë të punësuar në sektorin e kujdesit shëndetësor, dhe tre burra ashkali dhe një grua rome janë të punësuar në sektorin e arsimit.<sup>44</sup> Katër burra ashkali dhe dy gra ashkali janë të punësuar në Policinë e Kosovës, një burrë rom në Doganat e Kosovës dhe shtatë burra ashkali në Forcat e Sigurisë së Kosovës. Për më tepër, 18 romë dhe 88 ashkali janë të punësuar në ndërmarrje të ndryshme publike, kryesisht ndërmarrje rajonale të ujit dhe shërbimeve publike,<sup>45</sup> dhe 13 ashkali të Kosovës (dhjetë burra dhe tri gra) nga komuna janë të angazhuar drejtpërdrejt në politikë (NKK Ferizaj, dy zëvendësministra, ekspertë për dialog) ose të punësuar nga persona të angazhuar në politikë (këshilltarë, anëtarë kabineti, shoferë)<sup>46</sup>.

Situata socio-ekonomike e pjesëtarëve të tri komuniteteve dhe qasja e tyre në punësimin e sektorit privat mbetet sfidë. Sipas zyrës komunale të punësimit, 38 pjesëtarë të komunitetit rom, 607 të komunitetit ashkali dhe asnjë nga ai egjiptian janë regjistruar si punëkërkues aktivë.<sup>47</sup> Sipas informatave të ofruara nga qendra për mirëqenie sociale, nëntë familje rome (që përbëhen nga 44 individë) dhe 250 familje ashkali (që përbëhen nga 1.259 indi-

vidë) janë përfitues të ndihmës sociale.<sup>48</sup> Përfaqësuesit e komunitetit kanë identifikuar 20 deri 40 fëmijë të angazhuar në punë të fëmijëve, të cilët mblidhnin kanaçe ose bartnin mallra në tregun e gjelbër.<sup>49</sup>

## Shëndetësia

Shërbimet e shëndetësisë primare ofrohen nga dy qendra të shëndetësisë primare pesë ditë në javë, një që gjendet në fshatin Dubravë dhe një në lagjen urbane Sallahane. Fëmijët nga të tri komunitetet marrin rregullisht vaksinime të detyrueshme. Planifikimi familjar dhe kujdesi shëndetësor riprodhues për gratë është gjithashtu i qasshëm. Shërbimet e stomatologjisë ofrohen në fshatin Dubravë. Për më tepër, qendra kryesore e mjekësisë familjare organizon kontrolle sistematike të përgjithshme mjekësore për fëmijët e këtyre komuniteteve në vendbanimet e tyre dhe në Qendrën e Komunitetit Ashkali në fshatin Dubravë.

## Kthimi dhe riatdhesimi

Procesi i kthimit të personave të zhvendosur dhe riintegrimi i personave të riatdhesuar gjithashtu mbetet sfidues. Nga 1 janari 2016 dhe 31 dhjetori 2018, 20 familje ashkali dhe dhjetë familje rome u kthyen vullnetarisht në komunë, përfshirë gjashtë familje me origjinë nga Kaçaniku, Lipjani dhe Prishtina të cilët shprehën dëshirën për t'u rikthyer në Ferizaj. Që nga janari i vitit 2016, komuna kishte bërë përpjekje që të identifikojë një lokacion për ndarjen e tokës për gjashtë familje ashkali dhe tre familje rome të patokë me origjinë nga Ferizaj, që u kthyen nga Maqedonia e Veriut më 2015. Në vitin 2018, departamenti komunal i gjeodezisë dhe kadastrit në

bashkëpunim me ZKKK ka identifikuar një ngastër toke komunale dhe i propozoi KK-së që kjo ngastër të ndahet për ndërtimin e ndërtesës për akomodimin e familjeve të kthyer dhe që nuk kanë tokë. Projekti është në pritje të aprovimit të KK. Ndërmjet 1 janarit 2016 dhe 31 dhjetorit 2018, 226 pjesëtarë të komunitetit ashkali (125 burra dhe 101 gra) si dhe 18 të komunitetit rom (10 burra dhe 8 gra) janë riatdheuar në komunë.<sup>50</sup>

<sup>34</sup> Sipas regjistrimit të vitit 1991, në atë kohë 2,081 romë jetonin në komunën e Ferizajt.

<sup>35</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, shih më sipër shënimin 2.

<sup>36</sup> Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 13 mars 2019.

<sup>37</sup> Kosto e projektit të përbashkët ishte 70,000 euro ku komuna kontribuoi me 30,000 euro dhe shuma

e mbetur u financua nga OJQ VoRAE.

<sup>38</sup> Pozita e NKK është e detyrueshme në komunat ku të paktën 10 për qind e popullsisë së saj janë nga komunitetet joshumicë. Kjo pozitë nuk është e detyrueshme në Ferizaj, por është themeluar në periudhën 2013–2017 të administratës komunale me vullnet të mirë politik të udhëheqjes së mëparshme komunale.

<sup>39</sup> 91 ashkali dhe gjashtë romë, sipas intervistës me drejtorinë komunale të arsimit të mbajtur më 25 korrik 2017.

<sup>40</sup> Sipas drejtorit të shkollës, numri i nxënësve vijues ndryshon, duke pasur parasysh që lënda nuk është e detyrueshme. Sidoqoftë, 12–13 romë, 7–10 ashkali dhe dy nxënës shqiptarë e ndjekin lëndën rregullisht.

<sup>41</sup> Intervista me udhëheqësin e ZKKK është mbajtur më 25 korrik 2017.

<sup>42</sup> Qendra e Edukimit Ashkali në fshatin Dubravë administrohet nga komuna e Ferizajt në bashkëpunim me mbështetjen e organizatës joqeveritare lokale Caritas Kosova dhe OJQ VoRAE. Rreth 276 fëmijë të moshës shkollore nga të cilat 261 ashkali (120 djem dhe 131 vajza), tre romë (një djalë dhe dy vajza) dhe 12 shqiptarë (shtatë vajza dhe pesë djem) marrin pjesë në aktivitetet jashtëshkollore. Sipas udhëheqësit të ZKKK, komuna, në bashkëpunim me shkollën fillore "Naim Frashëri" dhe Qendrën, organizon shkollim

parashkollor për 38 ashkali dhe gjashtë romë në Qendër. Ky aranzhim është bërë për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të fëmijëve ashkali dhe romë në arsimin parashkollor.

<sup>43</sup> Raporti i OSBE-së, shih shënimin sipër.

<sup>44</sup> Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punësim, mbajtur më 14 mars 2019.

<sup>45</sup> Po aty.

<sup>46</sup> Monitorimi i OSBE-së.

<sup>47</sup> Nuk ka në dispozicion të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë. Anketa e ekipeve të OSBE-së në terren, e kryer në secilën komunë në periudhën maj-qershor 2018 ku intervistoheshin zyrat

komunale për punësim dhe përfaqësuesit e qendrave për mirëqenie sociale.

<sup>48</sup> Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punë sociale, mbajtur më 14 mars 2019

<sup>49</sup> Intervistë me kryetarin e organizatës së shoqërisë civile "BRAN", mbajtur më 27 korrik 2017, si dhe me një zyrtar rom në zyrën e ZKKK më 24 korrik 2017.

<sup>50</sup> Informacion i marrë përmes një interviste të realizuar me kreun e ZKKK më 13 mars 2019









# Komuna e Fushë Kosovës

## Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Sipas regjistrimit të vitit 2011, komuna e Fushë Kosovës ka 34.827 banorë, nga të cilët 436 janë romë, 3.230 janë ashkali dhe 282 egjiptianë.<sup>51</sup> Që nga 31 dhjetori 2018, përfaqësuesit e komunitetit vlerësoan se rreth 1.050 romë, mbi 4.000 ashkali dhe mbi 500 egjiptianë jetonin në komunë.<sup>52</sup>

Shumica dërmuese e ashkalive dhe egjiptianëve e Kosovës banojnë në zonat "02", "07", "28" dhe "29" në qytetin e Fushë Kosovës në vendbanime të formalizuara<sup>53</sup> dhe në fshatin Henc.<sup>54</sup> Pjesëtarët e komunitetit rom banojnë në qytetin e Fushë Kosovës, si dhe në fshatrat Bresje dhe Kuzmin. gjatë viteve të 1950-ta është vërejtur një rritje në numrin e banorëve ashkali në komunë, gjatë kohës së industrializimit të Prishtinës dhe Fushë Kosovës, ku pjesëtarët e komunitetit ashkali ishin të punësuar në fabrikat lokale.

## Banimi dhe infrastruktura

Shumica e shtëpive në lagje janë ndërtuar pa leje. Pasi që toka nuk është e regjistruar në emër të banorëve, ata nuk janë në gjendje të bëjnë kërkesë për legalizim të shtëpive të tyre. Nga 2014 deri 2016, OJQ VoRAE zhvilloi një projekt që synonte përmirësimin e kushteve të banimit të pjesëtarëve të tri komuniteteve. Gjithsej, 155 familje në Fushë Kosovë kanë përfutur nga ky projekt në vlerë prej 315,000 euro (nga të cilat 82,000 euro janë siguruar nga komuna). Rrugët kryesore të hyrjes janë të asfaltuara, por rrugët dytësore në zonat e banuara nga tri komunitetet janë ende të pashtuara.<sup>55</sup> Rrjeti i ujërave të zeza në qytetin e Fushë Kosovës dhe zonën Kuzmin u përfundua në 2016–2017; megjithatë, tubat nuk ishin shtrirë deri te lagjet "28" dhe "29" të qytetit Fushë Kosovë, duke bërë që banorët të mbështeten në ujë të pijshëm nga pusët e zonës së Kuzminit.<sup>56</sup>

## Përfaqësimi në vendimarrje

Të tri komunitetet janë të përfaqësuara mirë në mekanizmat e pjesëmarrjes së komunitetit lokal, ku secili komunitet ka një përfaqësues në KK, një burrë rom, një burrë ashkali dhe një grua egjiptiane. Ngjashëm, të tri komunitetet janë të përfaqësuara nga një burrë në KKSB. Komunitetet në pakicë numerike përbëjnë afërsisht 13 për qind të popullsisë së Fushë Kosovës, dhe komuniteti ashkali është komuniteti më i madh joshumicë. Kështu, komuna është e detyruar të krijojë postet e NKK dhe ZKKKK. Nga 2013 deri 2017, të dy postet, NKK dhe ZKKKK janë zënë nga burra ashkali, të cilët u rizgjodhën edhe pas zgjedhjeve lokale të tetorit 2017. Komunitetet ashkali dhe ai egjiptian përfaqësohen edhe në KK nga një pjesëtarë i secilit komunitet; që të dy anëtarët e Kuvendit Komunal janë burra. Përveç kësaj, një burrë romë i Kosovës është i punësuar në ZKKK.

## Arsimi

Sipas informatave të siguruar nga drejtorja komunale e arsimit, janë dhjetë romë, 236 ashkali dhe 45 nxënës egjiptianë të regjistruar në shkollat fillore dhe të mesme të ulët me kurrikulë të Kosovës "Selman Riza", "Daut Bogujevci" dhe "Mihail Grameno." Përveç kësaj, 49 nxënës romë vijojnë mësimin në sistemin arsimor të Serbisë në shkollën fillore dhe të mesme "Aca Marović" në Bresje. Rreth 250 nxënës ndjekin mësimet në qendrat e mësimi të drejtuar nga OJQ "Balkan Sunflowers" dhe "The Ideas Partnership".<sup>57</sup> Këto qendra ofrojnë hapësira të sigurta dhe të ngrohta, ku fëmijët mund t'i kryejnë detyrat e tyre të shtëpisë dhe të marrin ndihmën e nevojshme. OJQ The Ideas Partnership gjithashtu angazhon avokues të komunitetit nga lagjet për të vepruar si urë lidhëse midis prindërve dhe shkollave dhe për të ndihmuar në forcimin e marrëdhënieve midis të dyve. Si pjesë e nismës, komuna gjithashtu sponsorizon orë plotësuese për të rriturit. Në komunë nuk ofrohen lënda e gjuhës dhe kulturës romë dhe asnjë pjesëtarë i të tri komuniteteve nuk është i angazhuar si mësimdhënës në komunë.<sup>58</sup>

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Fushë Kosovës ka përmbushur pragun minimal për përfaqësimin e të gjitha komuniteteve në pakicë numerike në shërbimin civil; megjithatë, sipas kuotave individuale të komunitetit, komuna ka përmbushur pragun minimal vetëm për komunitetin rom.<sup>59</sup> Sipas informacionit të siguruar nga ZKKK, vetëm një nëpunës civil rom është i punësuar në komunë dhe disa burra romë dhe ashkali janë të punë-

suar në institucione publike si staf i sigurisë dhe mirëmbajtjes.<sup>60</sup>

Shumica e pjesëtarëve të tri komuniteteve janë të papunë ose të përfshirë në sektorin ekonomik joformal.<sup>61</sup> Rreth 30 për qind e familjeve e mbështesin veten duke mbledhur materiale të riciklueshme.<sup>62</sup> OJQ The Ideas Partnership zbaton projekte mikro-financiare në lagjen "29" për përpunimin e sapunit, riciklimin, prodhimin e kavanozave të qirinjve dekorativë, pastrimin e këpucëve, për t'i mundësuar prindërit (veçanërisht gratë) që të fitojnë të ardhura bazë, t'i fuqizojnë ata dhe t'u mundësojnë atyre t'i dërgojnë fëmijët në shkollë.<sup>63</sup> Sipas një përfaqësuesi të OJQ-së, fëmijët nga pesë deri në dhjetë familje ashkali janë të detyruar të kërkojnë lëmshë në rrugët e komunës së Prishtinës, dhe disa fëmijë janë gjithashtu të angazhuar në mbledhjen e materialeve të riciklueshme.<sup>64</sup> Sipas zyrës komunale të punësimit, gjashtë romë (dy burra dhe katër gra), 52 ashkali (30 burra dhe 22 gra) dhe pesë egjiptianë (tre burra dhe dy gra) u regjistruan si punëkërkuar në 31 dhjetor 2018,<sup>65</sup> ndërsa 51 familje romë, 320 familje ashkali dhe 49 familje egjiptiane merrnin ndihmë sociale.<sup>66</sup>

## ■ Shëndetësia

Pjesëtarët e të tri komuniteteve kanë qasje në institucione shëndetësore, ndërsa të dy gjinitë janë përfituese të barabarta. Objektet ekzistuese mjekësore ofrojnë ndihmë të shëndetit riprodhues falas për gratë, dhe ato janë të vendosura në distanca të arritshme në zonat e banuara nga pjesëtarët e tri komuniteteve.<sup>67</sup>

## ■ Kthimi dhe riatdhesimi

Nga 1 janari 2016 dhe 31 dhjetori 2018, 288 pjesëtarë të komunitetit rom, komunitetit ashkali, si dhe atij egjiptian janë riatdhesuar në komunë.<sup>68</sup> Gjatë së njëjtës periudhë, 13 romë, 63 ashkali dhe pesë egjiptianë janë kthyer vullnetarisht në komunë nga vendi ku ishin zhvendosur.<sup>69</sup>

**51** Agjencia e Statistikave të Kosovës, shih më sipër shënimin 2.

**52** Intervistat me tre përfaqësues të komunitetit janë mbajtur më 8 dhe 12 mars 2019.

**53** Në vendbanimet formale / të formalizuara, pronat dhe titujt pronësorë janë regjistruar me rregull, në krahasim me vendbanimet joformale ku nuk janë të regjistruar.

**54** Këto zona nuk njihen zyrtarisht si pjesë të veçanta të qytetit brenda statutit komunal.

**55** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së është mbajtur më 24 korrik 2017.

**56** Monitorimi afatgjatë i ekipeve të OSBE-së në terren.

**57** Intervista me përfaqësuesin e qendrës mësimore zhvilluar më 14 korrik 2017.

**58** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit u zhvillua më 19 korrik 2017.

**59** Raporti i OSBE-së, shih shënimin sipër.

**60** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 18 korrik 2017.

**61** Intervista me tre përfaqësues të komunitetit, mbajtur më 6, 7 dhe 10 korrik 2017.

**62** Intervista me tre përfaqësues të komunitetit, mbajtur më 6, 7 dhe 10 korrik 2017.

**63** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së është mbajtur më 24 korrik 2017.

**64** Intervista me përfaqësuesin e OJQ-së është mbajtur më 14 korrik 2017.

**65** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punësim, mbajtur më 12 mars 2019.

**66** Nuk ka të dhëna të zëbërthyer sipas gjinisë në dispozicion; intervista me përfaqësuesin e qendrës për mirëqenie sociale është mbajtur më 12 mars 2019.

**67** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të shëndetësisë u zhvillua më 21 korrik 2017.

**68** Nuk ka në dispozicion të dhëna të zëbërthyer

sipas komunitetit apo gjinisë. Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së është mbajtur më 12 mars 2019.

**69** Nuk ka shifra të sakta apo zëbërthim gjinor. Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së është mbajtur më 12 mars 2019.









# Komuna e Gjakovës

## Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Shifrat e regjistrimit të popullsisë së vitit 2011 zbuluan që nga 94,556 banorë të regjistruar në komunën e Gjakovës, 738 janë romë, 613 janë ashkali dhe 5.117 janë egjiptianë.<sup>70</sup> Nga 31 dhjetori 2018, ZKKK nuk posedonte të dhëna të përditësuara mbi popullsinë e komuniteteve.<sup>71</sup> Megjithatë, vlerësimi më i fundit i numrit të pjesëtarëve të tri komuniteteve që jetojnë në komunë është 8.000.<sup>72</sup> Pjesëtarët e të tri komuniteteve jetojnë në lagjet "Ali Ibra", "Brekoc",<sup>73</sup> "Piskotë" dhe "Sefë" të qytetit të Gjakovës, ndërsa vetëm pjesëtarët e komunitetit rom dhe atij egjiptian banojnë në lagjet "Qyl" dhe "Musa Zajmi" dhe fshatin Neticë. Komuniteti rom jeton vetëm në rrugën "Musa Zajmi" të qytetit të Gjakovës. Për më tepër, ka zona të banuara me pjesëtarë egjiptianë në fshatrat Bec, Hereq, Jabllanicë, Skivjan, zona të përziera egjiptiane dhe ashkali në fshatrat Neticë dhe Rogovë, dhe një fshat i përziera egjiptian dhe rom në fshatin Plançor.

## Banimi dhe infrastruktura

Pjesa më e madhe e pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe atij egjiptian në komunën e Gjakovës jetojnë në shtëpi me kushte modeste. Në zonat rurale, shumica e pjesëtarëve të tri komuniteteve jetojnë në shtëpi dhe baraka jostabile. Në lagjen "Brekoc" dhe në zona të tjera rurale janë regjistruar probleme me infrastrukturën rrugore dhe sistemet e kanalizimeve.<sup>74</sup>

## Përfaqësimi në vendimarrje

Që të tri komunitetet kanë përfaqësim adekuat në mekanizmat lokal për mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e komuniteteve. Në KKSB çdo komunitet përfaqësohet me burra, dhe në KK nga një burrë rom, një burrë ashkali dhe dy egjiptianë, nga të cilët një grua kryesuese. Pozicionet e NKK dhe ZK-KKK nuk janë të detyrueshme dhe Kuvendi aktual Komunal nuk ka pjesëtarë të këtyre tri komuniteteve. Dy nëpunës civilë egjiptianë janë të punësuar brenda ZKKK, një burrë egjiptian si udhëheqës i zyrës dhe

një grua egjiptiane që shërben si koordinatorë për të drejtat e komuniteteve.

## Arsimi

Fëmijët nga të tre komunitetet vijnë në sistemin arsimor të Kosovës. Sipas informacionit të dhënë nga drejtoria komunale e arsimit, 476 romë, 403 ashkali dhe 244 nxënës egjiptianë ndjekin shkollat fillore dhe të mesme të ulëta "Mustafa Bakija", "Mazllum Këpuska", "Zekeriya Rexha", "Emin Duraku", "Fehmi Agani", "Zef Lush Marku" dhe "Selman Riza" në qytetin e Gjakovës. Në zonat rurale, 197 fëmijë ashkali dhe 113 fëmijë egjiptianë janë të regjistruar në shkollat fillore dhe të mesme të ulët "Luigj Gurakuqi" në fshatin Korenicë, "Dëshmorët e Kombit" në Jabllanicë, "Isa Boletini" në fshatin Osek Hylë, "Sylejman Vokshi" në Smolicë, "Fan Noli" në fshatin Dujakë, "Ukshin Myftari" në fshatin Skivjan, "Haxhi Hoti" në fshatin Rogovë, "Dëshmorët e Herecit" në Herec, "Ali M. Hasi" në fshatin Cermjan.

Shkolla në fshatin Cermjan vijohet nga nxënës të fshat fqinj Neticë, i cili është më shumë se katër kilometra larg, dhe

komuna siguron transport falas.<sup>75</sup> Orët e gjuhës dhe kulturës romë u organizuan vetëm gjatë vitit shkollor 2015 / 2016 dhe u ndërpre pas çështjeve me pagesën e mësuesit. Dy mësues egjiptianë punojnë në shkollën e mesme të lartë të muzikës. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Emin Duraku" në qytetin e Gjakovës ofron shkollim fillor dhe të mesëm të ulët, ndërsa shkolla e mesme e lartë "Nexhbedin Nixha" ofron arsim të mesëm të lartë për të rritur. Janë dy qendra të mësimi në komunitet në komunë, një në lagjen e përziera etnikisht Ali Ibra në Gjakovë, e cila drejtohet nga OJQ Caritas Kosova dhe vijohet rregullisht nga 22 fëmijë,<sup>76</sup> dhe një në lagjen "Brekoc" gjithashtu në qytetin e Gjakovës, i cili drejtohet nga OJQ Bethany Christian Services dhe vijohet nga 150 deri në 170 fëmijë.<sup>77</sup> Qendra mësimore në lagjen "Brekoc" përballet me vështirësi me mungesë periodike të fondeve.<sup>78</sup>

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Gjakovës nuk e ka përmbushur as pragun minimal për përfaqësim të përgjithshëm të komuniteteve e as kuotën e veçantë për përfaqësimin e secilit komunitet në shërbimin civil komunal. Vetëm pesë nëpunës civilë nga komuniteti rom dhe ai egjiptian janë të punësuar, që është nën pragun minimal, ndërsa komuniteti ashkali nuk është i përfaqësuar në shërbimin civil komunal.<sup>79</sup>

Në fund të dhjetorit 2018, 290 romë, ashkali dhe egjiptianë u regjistruan si të papunë, ndërsa 16 romë, 20 ashkali dhe 25 egjiptianë u punësuan zyrtarisht në fund të dhjetorit 2018. 150 pjesëtarë të tjerë të tri komuniteteve çdo vit angazhohen në



punë sezonale në Verarinë Stonecastle në Rahovec.<sup>80</sup> Sipas qendrës për mirëqenie sociale, 90 romë, 170 ashkali dhe 110 egjiptianë ishin përfitues të ndihmës sociale në fund të vitit 2018.<sup>81</sup> Pjesëtarët e tri komuniteteve që nuk janë të punësuar zyrtarisht janë të angazhuar kryesisht në punë joformale siç është prerja e drurit dhe mbledhja e materialeve të riciklueshme.<sup>82</sup> Komuna ndan grante vjetore për bizneset e vogla dhe asistencë për bujqit. Gjithashtu, ajo zbaton projekte punësimi për persona të riatdhesuar dhe të rinj të mbështetur nga UNDP dhe GIZ, nga të cilët përfitojnë pjesëtarët e tri komuniteteve.<sup>83</sup> Nga 100 punëtorët sezonalë bujqësorë të angazhuar përmes marrëveshjes midis qendrës rajonale të punësimit dhe kompanive private, 70 i përkasin këtyre tri komuniteteve.<sup>84</sup> Rreth 100 fëmijë janë të angazhuar në aktivitete pune. Rreth 50 djem bartin mallra për blerësit në treg, dhe rreth 50 djem dhe vajza shesin cigare dhe gjësende të tjera të vogla.<sup>85</sup>

## ■ Shëndetësia

Pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe atij egjiptian në përgjithësi nuk përballen me vështirësi të mëdha lidhur me qasjen në qendrat shëndetësore për shkak të distancës fizike, me përjashtim të fshatrave Neticë dhe Jabllanicë.<sup>86</sup> Ndihma shëndetësore riprodhuese për gratë ofrohet falas.<sup>87</sup>

## ■ Kthimi dhe riatdhesimi

Ndërmjet 1 janarit 2016 dhe 31 dhjetorit 2018, 124 pjesëtarë të komunitetit rom (70 burra, 54 gra), 152 të komunitetit ashkali (90 burra, 62 gra), dhe 208 të komunitetit egjiptian (nuk ka zberthim gjinor të këtij numri) janë riatdhesuar në komunë.<sup>88</sup> Gjatë së njëjtës periudhë, 12 pjesëtarë të komunitetit rom (tetë burra dhe katër gra) dhe 170 të komunitetit egjiptian (80 burra dhe 90 gra) u kthyen vullnetarisht nga vendet ku ishin të zhvendosur.<sup>89</sup>

**70** Agjencia e Statistikave të Kosovës, shih më sipër shënimin 2.

**71** Intervista është mbajtur më 11 dhe 13 mars 2019.

**72** Nuk ka zberthim të të dhënave sipas komunitetit apo gjinisë; intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 5 korrik 2017.

**73** Një pjesë e lagjes është vendbanim joformal.

**74** Informacion aktual i bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, nga 15 marsi 2019.

**75** Komunat kanë detyrim të sigurojnë transport për nxënësit që banojnë më larg se katër kilometra nga shkolla më e afërt. Neni 15, ligji nr. 04 / L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës (29 gusht 2011).

**76** 14 djem dhe tetë vajza.

**77** Rreth 60 për qind djem dhe 40 për qind vajza..

**78** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit u zhvillua më 19 korrik 2017.

**79** Raporti i OSBE-së, shih shënimin sipër8.

**80** Nuk ka të dhëna të zberthyer; Intervista me përfaqësuesin e qendrës për punësim u mbajt më 13 mars 2019.

**81** Intervistë me përfaqësuesin më 12 mars 2019..

**82** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, më 30 korrik 2017.

**83** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 5 korrik 2017.

**84** Intervista me përfaqësuesin e qendrës rajonale të punësimit është zhvilluar më 21 korrik 2017.

**85** Intervistë me përfaqësuesin e OJQ-së më 21 korrik 2017, dhe me përfaqësuesit e komuniteteve më 30 qershor 2017.

**86** Informacion aktual i bazuar në monitorimin nga

ekipet e OSBE-së në terren, nga 15 marsi 2019.

**87** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të shëndetësisë u zhvillua më 19 korrik 2017.

**88** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, më 11 dhe 13 mars 2019.

**89** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, mbajtur më 11 dhe 13 mars 2019.







# Komuna e Gjilanit

## Pasqyrim i përgjithshëm i situatës dhe vendbanimeve

Sipas ZKKK-së, rreth 6,000 romë, 50 ashkalinj dhe asnjë egjiptianë jetonin në komunën e Gjilanit para vitit 1999.<sup>90</sup> Regjistrimi i popullatës i vitit 2011, nga ana tjetër, tregon se nga 90.178 banorë, 361 janë romë, 15 janë Ashkali të Kosovës dhe një është egjiptian.<sup>91</sup> Sipas përfaqësuesve të komunitetit, janë 128 ekonomi familjare të komunitetit rom<sup>92</sup> (407 anëtarë gjithsej të përbërë nga 263 burra dhe 144 gra) në komunë, si dhe nuk ka asnjë informacion mbi vendndodhjen e pjesëtarëve të komunitetit ashkali ose të atij egjiptian.<sup>93</sup> Pjesëtarët e komunitetit rom banojnë në katër lagje urbane në qytetin e Gjilanit: "Abdullah Presheva", "Elez Agushi", "Xhemajl Mustafa" dhe "Gyrrel Sylejmani", dhe në vendin e kthimit në "Gllamë" në periferi të qytetit.<sup>94</sup> Duke pasur parasysh numrin e ulët të banorëve nga komunitetet ashkali dhe egjiptianë dhe mungesën e informacionit në dispozicion për këto dy komunitete në komunë, ky profil komunal përqendrohet vetëm në gjendjen e komunitetit rom.<sup>95</sup>

## Banimi dhe infrastruktura

Meqenëse zonat e banuara nga komuniteti rom janë të vendosura në zonën urbane, komuniteti ka qasje në shërbimet komunale dhe të gjitha shërbimet publike. Shtëpitë në përgjithësi kanë cilësi të mjaftueshme; megjithatë, gjendja e dobët e disa shtëpive paraqet rrezik të shembjes përmbi banorët e atij vendbanimi. Më 12 nëntor 2018, komuna e Gjilanit zbatoi vendimin e drejtorisë komunale të inspeksionit për rrënimin e shtëpive të braktisura që ishin dëmtuar gjatë konfliktit të vitit 1999 gjendja e së cilave po përkeqësohej dita ditës. Ajo gjithashtu e pastroi një deponi të paligjshme të mbeturinave në lagjen "Abdullah Presheva" në qytetin e Gjilanit. Ky vendim, i lëshuar në 6 nëntor 2018, përcaktoi se rrënimet ishin të domosdoshme pasi që shtëpitë përbënin kërcënim për sigurinë publike. Vendimi u morr si rezultat i ankesave të banorëve lokalë në qershor të vitit 2018, i ndjekur nga njoftimi pasues i pronarëve shtëpitë e të cilëve do të rrënoheshin.

Sipas anëtarit të KK-së nga radhët e komunitetit rom dhe kryesuesit të ZKKK-së,

aksioni u pranua mirë nga shumica e banorëve romë në qytetin e Gjilanit. Në të vërtetë, anëtari i KK tregoi se disa pronarë të tjerë të komunitetit rom, pronat e të cilëve janë të dëmtuara por nuk janë në listën e rrënimëve, kërkuan që edhe pronat e tyre të përfshihen në të. Ai i këshilloi që ta kontaktojnë komunën.

## Përfaqësimi në vendimmarrje

Komuniteti Rom i Kosovës është i përfaqësuar në KK dhe KKSB; të dy përfaqësuesit janë burra. Pozitat e NKK dhe ZKKKK nuk janë të obligueshme në komunë. Përveç kësaj, një burrë rom nga Kosova është i punësuar në ZKKK, dhe një tjetër në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronave.

## Arsimi

Të gjithë fëmijët romë janë regjistruar në shkollat që punojnë me planprogram të Serbisë në komunën e Gjilanit dhe në fshatrat përreth të banuara nga serbët në komunën e Novobërdës. Në shkollën fillore "Vuk Karaxhiq" në qytetin e Gjilanit, që punon me planprogram të Serbisë, mësimi vijohet nga 70 nxënës romë dhe shkolla funksionon në shtëpi private. Shkolla ka gjashtë punonjës romë (katër mësues dhe dy staf ndihmës).<sup>96</sup> Mësimi përfshinë lëndë të gjuhës rome që mbahen nga mësues romë.<sup>97</sup> Dy qendra të arsimit plotësues të menaxhuara nga OJQ-ja VoRAE dhe Rrjeti i Organizatave të Grave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (RROGRAEK) gjenden në komunën e Gjilanit. Qendra mësimore e OJQ-së RROGRAEK funksionon në shkollën fillore me planprogram të Serbisë "Vuk Karaxhiq" dhe vijohet nga afërsisht 28 nxënës romë.<sup>98</sup> Qendra mësimore e OJQ-së VoRAE është e vendosur në shtëpi private dhe vijohet nga 43 nxënës romë.<sup>99</sup> Komuna nuk ofron programe formale të arsimit për të rritur.

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Gjilanit nuk e ka përmbushur as pragun minimal për përfaqësim të përgjithshëm të komuniteteve e as kuotën e veçantë për përfaqësimin e secilit komunitet në shërbimin civil komunal.<sup>100</sup> Në dhjetor të vitit 2018, vetëm dhjetë banorë romë ishin të punësuar, asnjë prej të cilëve nuk punonte në sektorin privat.<sup>101</sup> Vlen të përmendet që gjashtë prej tyre kanë



punuar në shkollën me planprogram të Serbisë në komunën e Gjilanit.<sup>102</sup> Shumica e anëtarëve të komunitetit mbijetojnë me ndihmë sociale dhe duke mbledhur metale nëpër mbeturina. Në aktivitetet e mbledhjes janë të angazhuar edhe vajzat dhe djemtë.<sup>103</sup> Sipas qendrës për punë sociale në komunën e Gjilanit, 34 familje rome pranojnë asistencë sociale.<sup>104</sup> Sipas zyrës komunale të punësimit në komunën e Gjilanit, 12 romë<sup>105</sup> janë regjistruar si punëkërkuar aktivë.<sup>106</sup>

## ■ Shëndetësia

Pjesëtarët e komunitetit rom kryesisht përdorin shërbime të ofruara nga klinikat shëndetësore të menaxhuara nga Serbia që gjenden në komunat e Gjilanit, Novobërdës, Ranillugut dhe Graçanicës, por edhe nga klinikat shëndetësore të Kosovës në komunën e Gjilanit. Shërbimet shëndetësore janë në dispozicion për të gjithë anëtarët e komunitetit në mënyrë të barabartë dhe nuk është raportuar asnjë problem nga anëtarët e komunitetit në drejtorinë komunale të shëndetësisë. Për më tepër, spitali i maternitetit ofron asistencë për shëndetin riprodhues falas për gratë nga të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Gjilanit.<sup>107</sup>

## ■ Kthimi dhe riatdhesimi

Në vitin 2010, komuna ndau tokë në periferi të Gjilanit për gjashtë familje rome që nuk kishin pronë, të kthyer nga Maqedonia Veriore. Ministria për Komunitete dhe Kthim ka financuar ndërtimin e gjashtë shtëpive me infrastrukturë adekuate.<sup>108</sup> Që nga viti 1999, 374 romë të kthyer janë regjistruar në ZKKK.<sup>109</sup> Çështja e pronave të dëmtuara ose të uzurpuara ka

kontribuar në rritjen e vështirësive në lidhje me kthimin e romëve të zhvendosur.<sup>110</sup> Në periudhën mes 1 Janarit 2016 dhe 31 Dhjetorit 2018, në komunë janë riatdhesuar gjashtë pjesëtarë të komunitetit romë (një familje që përbëhet nga dy burra dhe katër gra). Për më tepër, gjatë periudhës së njëjtë të raportimit, dy familje rome (të përbëra nga katër burra dhe shtatë gra) u kthyen vullnetarisht.<sup>111</sup>

- 90** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 17 korrik 2017.
- 91** Agjencia e Statistikave të Kosovës, shih më sipër, fusnota 2.
- 92** Intervistë me ZKKK, zhvilluar më 8 mars 2019.
- 93** Intervista me përfaqësuesin e komunitetit rom, zhvilluar më 12 korrik 2017.
- 94** Intervistë me ZKKK-në, zhvilluar më 17 korrik 2017.
- 95** Bashkëbiseduesit e intervistuar nuk kishin ndonjë njohuri për komunitetet ashkali dhe egjiptianë në komunë përtej shifrave të regjistrimit të popullatës të vitit 2011.
- 96** Tre gra dhe tre burra.
- 97** Intervista me drejtorin e shkollës është zhvilluar më 25 korrik 2017.
- 98** 18 djem dhe dhjetë vajza. Intervista me përfaqësuesin e qendrës mësimore është zhvilluar më 13 korrik 2017.
- 99** 23 vajza dhe 20 djem. Intervista me përfaqësuesin e qendrës mësimore është zhvilluar më 13 korrik 2017.
- 100** Raporti i OSBE-së, shih fusnotën më sipër 8.
- 101** Një rom në ZKKK, një rom në doganë, një në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronave, një rome është drejtore ekzekutive e OJQ-së RROGRAEK, dy burra romë punojnë në OJQ VoRAE si mësues në Qendrën e të mësuarit, katër burra romë punojnë si mësues dhe dy romë të Kosovës (një burrë dhe një grua) punojnë si pastrues në shkollën filllore me planprogram të Serbisë "Vuk Karaxhiq". Intervistë me përfaqësuesin e qendrës së punësimit, e mbajtur më 8 mars 2019. Asnjë pjesëtar i romëve nuk është i punësuar në sektorin privat.
- 102** Katër burra dhe dy gra. Intervista me drejtorin e shkollës është zhvilluar më 25 korrik 2017.
- 103** Intervista me përfaqësuesin e OJQ-së zhvilluar

më 12 korrik 2017.

**104** Intervista me përfaqësuesin e QPS-së, është zhvilluar më 12 korrik 2017.

**105** Gjashtë burra gjashtë gra.

**106** Intervista me përfaqësuesin e qendrës rajonale të punësimit është zhvilluar më 12 korrik 2017.

**107** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të shëndetësisë u zhvillua më 13 korrik 2017.

**108** Informacion i bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**109** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 17 korrik 2017.

**110** Informacion i bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**111** Intervistë me ZKKK, zhvilluar më 8 mars 2019.







# Komuna e Graçanicës

## Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, nga 10,675 banorë të regjistruar në komunë 745 janë romë, 104 janë ashkali dhe 168 janë egjiptianë.<sup>112</sup> Sipas përfaqësuesve të komunitetit që nga dhjetori i vitit 2018, në komunë kanë jetuar 1,271 banorë romë (630 burra, 641 gra), 100 ashkali (51 burra, 49 gra) dhe tre egjiptian (një burrë dhe dy gra).<sup>113</sup> Shumica e komunitetit rom banon në Mahallën e Romëve në Graçanicë dhe në zonat më rurale në Çagllavicë, Dobratin, Lepi, Livagjë, Llapllasellë, Radevë, Skullan, dhe Uglarë. Komunitetet ashkali dhe egjiptian jetojnë, përkatësisht, në fshatrat Radevë dhe zonën urbane të Graçanicës.<sup>114</sup>

## Banimi dhe infrastruktura

Pjesëtarët e tre komuniteteve banojnë në vendbanime gjysmë formale në baneza të përhershme individuale, me qasje në energji elektrike, ujë dhe kanalizim; shtëpitë nuk kanë tituj të qartë dhe dokumente pronësore. Në vitin 2016, komuna e Graçanicës realizoi projekte të investi-

meve kapitale në zonat e banuara nga tre komunitetet, përfshirë asfaltimin e rrugëve dytësore, sigurimin e rrjeteve të kanalizimit dhe furnizimit me ujë. Mirëpo, komuniteti ashkali nga Radeva ende ka mbetur pa qasje në ujë të pijshëm. Deri në korrik 2017, OJQ-ja VoRAE ka ofruar mbështetje për ndërtimin e anekseve dhe banjave për disa banorë. Disa familje të komunitetit rom në qytetin e Graçanicës vazhdojnë të jetojnë në struktura betoni në gjendje të rëndë.<sup>115</sup>

## Përfaqësimi në vendimarrje

Komuniteti ashkali dhe komuniteti rom janë të përfaqësuar mirë në mekanizmat për mbrojtjen e komuniteteve. Në përbërjen e tij KK ka një ashkali dhe një rom, dhe i dyti shërben si kryesues tij. Të dy anëtarët e KK si ai i komunitetit rom ashtu edhe ai i komunitetit ashkali janë edhe anëtarë të KKS-së, së bashku me një grua nga komuniteti rom. Komuniteti egjiptian nuk është i përfaqësuar në asnjërin nga mekanizmat lokal për mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e komuniteteve. Asnjëra nga këto tre komunitete nuk përfaqësohet në

Kuvendin e Komunës. Komuna është e obliguar që të krijojë pozita të NKK dhe ZKKKK. Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2017, komuniteti rom i Kosovës humbi pozitën e NKK, e cila ishte mbajtur nga një burrë i komunitetit rom mes viteve 2013 dhe 2017.

## Arsimi

Komuna e Graçanicës siguron arsimim sipas planprogramit të Serbisë dhe ka një paralele me të shkollës fillore me planprogram të Kosovës nga komuna e Lipjanit në fshatin Radevë, në të cilën marrin pjesë nxënës të komunitetit ashkali. Sipas drejtorisë komunale të arsimit, 227 nxënës të komunitetit rom vijojnë mësimin në shkollat fillore dhe të mesme "Kral Millutin" në qytetin e Graçanicës dhe "Milladin Mitiq" në Llapllasellë. Komuna siguron transport për nxënës nga fshatrat tjerë që ndjekin shkollat me planprogram të Serbisë. Pesëmbëdhjetë, Nxënësit e komunitetit ashkali nga Radeva vijojnë mësimin në shkollën fillore dhe të mesme të ulët "Vëllezërit Frashëri", paralele kjo me planprogram të Kosovës e menaxhuar nga komuna e Lipjanit dhe arsimin

e mesëm e vijojnë në gjimnazin "Ulpiana" në qytetin e Lipjanit.<sup>116</sup> Në mënyrë të ngjashme, tre nxënës shtesë të komunitetit ashkali nga Kishnica dhe Sushica vijojnë mësimin sipas planprogramit të Kosovës, në shkollën fillore dhe të mesme të ulët "Ditët e Minatorit", paralele kjo që menaxhohet nga komuna e Prishtinës dhe vijojnë arsimin e mesëm në Gjimnazin "Ulpiana" në qytetin e Lipjanit. Nxënësit e komunitetit ashkali kanë vështirësi në gjetjen e një zgjidhjeje të përhershme për problemin e transportit në komunën e Lipjanit. Komuna e Graçanicës nuk siguron transport për shkollim jashtë komunës ndërsa komuna e Lipjanit nuk siguron transport për nxënësit që nuk banojnë në komunë. Në të kaluarën, transporti është siguruar në baza ad-hoc qoftë nga prindërit ose nga komunat. Prindërit mbulojnë vetë shpenzimet e transportit. Transporti i parregullt është nga faktorët kryesorë që shpie në braktisjen e shkollës së mesme nga komuniteti ashkali në Graçanicë, duke pasur parasysh që shumica e prindërve nuk mund t'i përballojnë shpenzimet e transportit.<sup>117</sup>

OJQ-ja "Balkan Sunflowers", e mbështetur nga komuna, administron një qendër mësimi në zonën "Mahalla Rome" të qytetit e Graçanicës, dhe mësimi i tyre vijohet rregullisht nga rreth 65 nxënës.<sup>118</sup> Qendra e dytë të mësuarit në fshatin Preoc administrohet nga OJQ VoRAE dhe frekuentohet rregullisht nga rreth 20 nxënës. Qendra e të mësuarit funksionon në shtëpi private me qasje në energji elektrike dhe furnizim me ujë.<sup>119</sup> Të rriturit kanë qasje në arsimin formal në shkollën fillore dhe të mesme "Kral Millutin" në qytetin e Graçanicës. Një burrë nga komuniteti rom punon si mësues i TIK-ut në shkollën fillore dhe të mesme "Milladin Mitiq".<sup>120</sup> Në komunë nuk ofrohen njësi mësimore për gjuhën



dhe kulturën rome.

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Graçanicës nuk e ka përm-bushur as pragun minimal që kërkohet për të gjitha komunitetet e as atë për komunitete të veçanta për përfaqësimin e tyre në shërbimin civil komunal.<sup>121</sup> Asnjëra nga tre komunitetet nuk përfaqësohet në shërbimin civil. Më parë në ZKKK ishte punësuar një nëpunës civil nga komuniteti rom, por doli në pension në fillim të vitit 2017.<sup>122</sup> Përafërsisht 30 romë janë të punësuar në ndërmarrjet e shërbimeve publike "Komunalac" dhe "Pastrimi" dhe disa burra dhe gra romë dhe ashkali punojnë në sektorin e shoqërisë civile.

Pjesëtarët e komunitetit rom dhe atij ashkali - kryesisht burra - angazhohen në veprimtari joformale ekonomike, përfshirë mbledhje të metaleve nëpër mbeturina dhe punë sezonale bujqësore, derisa të rinjtë punësohen në veprimtari sezonale në ndërtimtari. Gratë nuk angazhohen as në aktivitete formale e as joformale ekonomike të punësimin. Fëmijët - kryesisht djem - ndihmojnë prindërit në punë bujqësore sezonale.<sup>123</sup> Sipas zyrës komunale të punësimin, 223 romë, dhjetë ashkali dhe asnjë egjiptian janë regjistruar si punëkërkues aktivë.<sup>124</sup> Sipas informacionit të siguruar nga qendra për punë sociale, 45 familje të komunitetit rom dhe dy familje të komunitetit ashkali përfitojnë nga asistencë sociale.<sup>125</sup> Nga korriku 2017, asnjë pjesëtar i tre komuniteteve nuk ishte i punësuar në sektorin privat; nuk kishte informacion të azhurnuar në kohën e publikimit.

## Shëndetësia

Pjesëtarët e të tri komuniteteve kanë qasje në të dy sistemet shëndetësore, ndërsa të dy gjinitë përfitojnë në mënyrë të barabartë. Institucionet shëndetësore gjenden në largësi të pranueshme, si në qytetin e Graçanicës ashtu edhe në fshatrat tjera të banuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

## Kthimi dhe riatdhesimi

Mes datës 1 janar 2016 dhe 31 dhjetor 2018, 21 pjesëtarë të komunitetit ashkali<sup>126</sup> janë riatdhesuar në komunë. Gjatë periudhës së njëjtë, dy pjesëtarë të komunitetit rom janë kthyer në komunë.<sup>127</sup>

## Përdorimi i gjuhës

Në tetor të vitit 2014, komuna e njohu gjuhën rome si gjuhë në përdorim zyrtar në komunë.<sup>128</sup> Si pjesë e një projekti të OJQ-së zvicerane CSD, dy individë vijuan kurs trajnimi gjashtëmuor dhe u punësuan si përkthyes të gjuhës rome. Pas gjashtë muajsh, komuna ndërpreu sigurimin e përkthimit në gjuhën rome për shkak të mungesës së fondeve, gjë që pengon zbatimin e vendimit komunal për njohjen e gjuhës rome si gjuhë në përdorim zyrtar në komunë - kjo ka mbetur problem edhe sot e kësaj dite.<sup>129</sup>

**112** Agjencia e Statistikave të Kosovës, shih më sipër, fusnota 2.

**113** Intervistat me dy përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 14 mars 2019.

**114** Intervistat me tre përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 13 dhe 14 mars 2019.

**115** Informacion aktual i bazuar në monitorimin

nga ekipet e OSBE-së në terren, nga 15 marsi 2019.

**116** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit u zhvillua më 19 korrik 2017.

**117** Informacion aktual i bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, nga 15 marsi 2019.

**118** 25 djem dhe 40 vajza. Intervista me përfaqësuesin e qendrës mësimore është zhvilluar më 21 korrik 2017.

**119** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit u zhvillua më 19 korrik 2017.

**120** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit u zhvillua më 19 korrik 2017.

**121** Raporti i OSBE-së, shih shënimin 8 sipër

**122** Informacion aktual i bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, nga 15 marsi 2019.

**123** Intervista me tre përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 13 dhe 21 mars 2017.

**124** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punësim, zhvilluar më 12 mars 2019.

**125** Intervistë me qendrën për punë sociale, zhvilluar më 13 mars 2019.

**126** Numri i individëve dhe ndarja gjinore nuk ishin në dispozicion. Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 14 mars 2019.

**127** Numri i individëve dhe ndarja gjinore nuk ishin në dispozicion. Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 14 mars 2019.

**128** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 6 korrik 2017.

**129** Sipas neneve 2.4 dhe 8 të Ligjit nr. 02 / L-37 për përdorimin e gjuhëve (korrik 2006), në ato komuna ku jeton një bashkësi, gjuha amtare e së cilës nuk është njëra nga gjuhët zyrtare në Kosovë dhe e cila përfaqëson më shumë se 3 për qind të popullatës së përgjithshme të komunës, gjuha e asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në atë komunë. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, komuniteti rom në komunën e Prizrenit përbën përafërsisht 6.9 për qind të popullsisë së përgjithshme.







# Komuna e

# Istogut

## Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, nga 39,289 banorë të regjistruar në komunë 39 janë romë, 111 ashkali dhe 1,544 egjiptianë.<sup>130</sup> Sipas ZKKK-së, rreth 46 romë, dhe 1.525 egjiptianë jetonin në komunë në dhjetor të vitit 2018.<sup>131</sup> Asnjë anëtar i komunitetit ashkali<sup>132</sup> nuk regjistrua si person që jeton në komunë.<sup>133</sup> Pjesëtarët e komunitetit rome dhe atij egjiptian jetojnë në qytetin e Istogut në këto fshatra: Banjë, Banjicë, Carallukë, Cercë, Dragolevc, Drejë, Gurakoc, Gusar, Koshicë, Kosh, Kovragë, Llukavc i Begut, Muzhevinë, Oprashkë, Prekallë, Saradran, Serbobran, Shalinovicë, Llukavc i Thatë, Tërshëvina, Tomoc, Veriq dhe Zallq

## Banimi dhe infrastruktura

Shumica e anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian jetojnë në vendbanime formale me banim të përhershëm në komunën e Istogut. Disa zona të banuara nga dy komunitetet përballen me vështirësi në furnizimin me ujë, veçanërisht gjatë

stinës së verës,<sup>134</sup> dhe disa zona kërkojnë përmirësim të sistemeve të ujërave të zeza.<sup>135</sup> Më parë, komuna rindërtoi 33 shtëpi në Serbobran që u përkisnin anëtarëve të komunitetit rom dhe atij egjiptian që ktheheshin nga vendet ku ishin të zhvendosur në Mal të Zi. Me kërkesë të ZKKK, komuna gjithashtu asfaltoi rrugët dhe rregulloi kanalizimin në fshat.

## Përfaqësimi në vendimarrje

Komuniteti egjiptian përfaqësohet nga një burrë në KK dhe nga një burrë e një grua në KKS, ndërsa komuniteti rom përfaqësohet nga një burrë vetëm në KKS. Përveç kësaj, tre burra egjiptianë janë të punësuar në ZKKK. Pozitat e NKK-së dhe ZKKK-së nuk janë të detyrueshme në komunën e Istogut pasi që komunitetet joshumicë përbëjnë më pak se dhjetë për qind të popullatës së gjithmbarshme në komunë. Asnjëra nga të dy komunitetet nuk kanë përfaqësim në kuvend komunal.

## Arsimi

Fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë janë regjistruar në shkollat filllore dhe të mesme të ulëta me planprogram të Kosovës. Sipas Drejtorisë Komunale të Arsimit, 20 romë, 67 ashkali dhe 328 egjiptianë vijnë në shkollat filllore dhe të mesme të ulëta "Mithat Frasheri" dhe "Bajram Curri" në qytetin e Istogut, "Martin Camaj" në Gurakoc, "Martin Camaj" në Llukavc i Thatë, paralelet e shkollës "Bajram Curri" në Cercë, Muzhevinë dhe Dubravë, "Avni Rustemi" në Zallq, "Ismajl Qemajli" në Saradran, "Trepça" në Banjë dhe "Fan S. Noli" në fshatin Llukavc i Begut.<sup>136</sup>

Asnjëra shkollë nuk është më shumë se katër kilometra larg nga cilido vendbanim. Njësitë mësimore të gjuhës dhe kulturës rome ose arsimit formal për të rritur nuk janë në dispozicion në komunë. OJQ-ja "Vizioni 02" drejton dy qendra mësimore në komunë. Që nga korriku 2017, qendra në fshatin Gurakoc u frekuentua nga 40 fëmijë,<sup>137</sup> dhe qendra në fshatin Serbobran nga 20 fëmijë.<sup>138</sup> Qendrat e mësimiit janë mbështetur financiarisht nga

komuna dhe OJQ-ja "Qendra për Arsim e Kosovës" në kuadër të projektit "EU-SIM-RAES 2".<sup>139</sup>

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Derisa komuna e Istogut e ka përbushur prapen e saj minimal për përfaqësimin e përgjithshëm të komuniteteve në shërbimin civil komunal, ajo nuk e ka përbushur prapen minimal për komunitetet individuale.<sup>140</sup> Në korrik të vitit 2017, pesë egjiptianë janë punësuar në shërbimin civil komunal, një egjiptianë është punësuar si infermiere në fshatin Zallq, pesë gra egjiptiane janë punësuar si staf i mirëmbajtjes në hapësirat e Forcave të Sigurisë së Kosovës, si dhe katër burra egjiptianë janë punësuar në Policinë e Kosovës. Po ashtu, një burrë rom e tre burra egjiptianë janë punuar si roje në qendrën korrektuese në fshatin Dubravë.<sup>141</sup> Nuk ka informata të përditësuara në dispozicion në kohën e publikimit.

Pjesëtarët e komunitetit egjiptian të cilët jetojnë në komunën e Istogut kryesisht punojnë si punëtorë sezonalë, prerës të druve dhe mbledhës të materialeve të riciklueshme.<sup>142</sup> Një numër i vogël i pjesëtarëve të komunitetit rom përfshihen në të njëjtat aktivitete joformale si komuniteti egjiptian - punë bujqësore sezonale, prerje e druve dhe mbledhje e materialeve të riciklueshme.<sup>143</sup> Sipas zyrës komunale të punësimiit, në fund të dhjetorit 2018 ishin 111 punëkërkuar të regjistruar (dy nga komuniteti romë, 86 nga komuniteti egjiptian, 23 nga komuniteti ashkali), ndërsa qendra për mirëqenie sociale tregoi se katër familje të komunitetit rom, 51 të komunitetit egjiptian dhe 21 të komuniteteve



tit ashkali kanë përfituar nga ndihma sociale.<sup>144</sup>

## ■ Shëndetësia

Sipas përfaqësuesve të komunitetit, sfida kryesore me të cilën përballen dy komunitetet në komunë është largësia midis disa fshatrave ku ata banojnë dhe qendrave mjekësore e farmacive.<sup>145</sup> Komuna është e vetëdijshme për këtë çështje, veçanërisht për pjesëtarët e moshuar nga radhët e komunitetit romë dhe atij egjiptian që jetojnë në zona rurale.<sup>146</sup> Komuna ka organizuar vizita sistematike të infermierëve nga spitalli i Istogut në fshatin Serbobran për t'iu dhënë anëtarëve të komunitetit ligjërata për shëndetin riprodhues dhe ndihmë, duke përfshirë kontrolle dhe kontraceptivë falas për gratë nga të dy komunitetet.<sup>147</sup>

## ■ Kthimi dhe riatdhesimi

Mes 1 janarit 2016 dhe 31 dhjetorit 2018, 33 pjesëtarë të komunitetit rom (15 burra, 18 gra), 29 të komunitetit ashkali (19 burra, dhe dhjetë gra), dhe 173 pjesëtarë të komunitetit egjiptian (93 burra dhe 80 gra) janë riatdheusar në komunë.<sup>148</sup> Gjatë së njëjtës periudhë, 38 pjesëtarë të komunitetit egjiptian (19 burra, 19 gra) janë kthyer vullnetarisht në komunë nga vendi ku ishin zhvendosur.<sup>149</sup>

**130** Agjencia e Statistikave të Kosovës, shih më sipër, fusnota 2.

**131** Intervistë me ZKKK, zhvilluar më 11 dhe 13 mars 2019.

**132** Shih shënimin më lartë 14 për shpjegim të mospërputhjeve në lidhje me përkatësinë e nxënësve.

**133** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 13 korrik 2017.

**134** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit në Veriq, zhvilluar më 20 korrik 2017.

**135** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit në Serbobran, zhvilluar më 19 korrik 2017.

**136** Shih shënimin sipër 14.

**137** 33 djem, shtatë vajza.

**138** 11 djem, nëntë vajza; Intervistë me përfaqësuesin e qendrës mësimore zhvilluar më 18 korrik 2017.

**139** Intervistë me drejtorin e qendrës së mësimi është realizuar në 18 korrik 2017 dhe me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit në 24 korrik 2017.

**140** Raporti i OSBE-së, shih fusnotën më sipër 8.

**141** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 13 korrik 2017.

**142** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 19, 20, 25 korrik 2017.

**143** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 19, 20, 25 korrik 2017.

**144** Intervistë me qendrën për punë sociale, zhvilluar më 14 mars 2019.

**145** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit në Veriq, zhvilluar më 19 korrik 2017 dhe në Serbobran më 19 korrik 2017.

**146** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të shëndetësisë u zhvillua më 10 korrik 2017.

**147** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të shëndetësisë u zhvillua më 10 korrik 2017.

**148** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 11 dhe 13 mars 2019.

**149** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 11 dhe 13 mars 2019.











## Komuna e

# Kamenicës

### Pasqyrim i përgjithshëm dhe vendbanimet

Regjistrimi i popullatës i vitit 2011 tregon se nga 36.085 banorë, 240 janë të komunitetit rom dhe asnjë pjesëtar i komunitetit ashkali apo atij egjiptian nuk është regjistruar në komunën e Kamenicës.<sup>150</sup> ZKKK vlerëson se deri në dhjetor të vitit 2018, kishte 387 banorë nga komuniteti rom dhe konfirmon se nuk ka pasur asnjë nga komuniteti ashkali ose ai egjiptian të regjistruar në komunë.<sup>151</sup> Pjesëtarët e komunitetit rom jetojnë në qytetin e Kamenicës, fshatin Berivojcë, vendbanimin Leshtare të fshatit Strezoc dhe fshatin Boscë.

### Banimi dhe infrastruktura

Të gjitha vendbanimet ku jeton komuniteti rom janë të vendosura në zona të përziera etnikisht të komunës dhe të gjitha janë vendbanime formale. Në përgjithësi, problemet infrastrukturore që prekin komunitetin rom në komunë kanë të bëjnë me instalime të dobëta dhe mirëmbajtje joadekuate të sistemeve të kanalizimit dhe furnizimit me ujë të pijshëm, gjendje

të keqe të rrugës dhe ndriçim joadekuat të rrugës. Situata e banimit e shumicës së pjesëtarëve të komunitetit është e rëndë për shkak të shtëpive të mbipopulluara dhe kushteve joadekuate të jetesës, veçanërisht për ata që jetojnë në fshatin Boscë dhe në qendër të qytetit të Kamenicës.<sup>152</sup>

### Përfaqësimi në vendimarrje

Vetëm komuniteti rom është i përfaqësuar me një burrë në Komitetin për Komunitete, dhe një në KKSB. Pozitat e NKK-së dhe ZKKKK-së nuk janë të detyrueshme në komunë pasi që komunitetet joshumicë përbëjnë më pak se dhjetë për qind të popullatës së gjithmbarshme në komunë. Një burrë rom është i punësuar në ZKKK. Një burrë rom punon si drejtor i financave.

### Arsimi

Fëmijët e komunitetit rom në komunën e Kamenicës vijnë në mësimin në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta me planprogram të Kosovës dhe shkollat me planprogram të Serbisë. Sipas informatave të

siguruara nga drejtorja komunale e arsimit, 141 nxënës të komunitetit rom që jetojnë në qytetin e Kamenicës dhe fshatrat Berivojcë dhe Boscë vijnë në mësimin në shkollën me planprogram të Serbisë “Desanka Maksimović” dhe paralelet e saj, ndërsa 18 fëmijë të komunitetit rom që jetojnë në fshatin Leshtar vijnë në mësimin në shkollën me planprogram të Kosovës “Idriz Seferi” në fshatin Strezoc. Fëmijët e komunitetit rom që vijnë në shkollat me planprogram të Serbisë kanë qasje në njësi mësimore të gjuhës rome që mbahen dy herë në javë nga mësuesi i komunitetit rom. Qendra mësimore e administruar nga OJQ-ja VoRAE është në dispozicion në fshatin Berivojcë. Ajo vijohet nga rreth 20 fëmijë të komunitetit rom,<sup>153</sup> dhe punëson dy kujdestare femra, një rome dhe një serbe. Qendra mësimore ndodhet brenda një ndërtese të përkohshme që ka mungesë të hapësirës së mjaftueshme, ngrohjes adekuate, ujit dhe kanalizimit.<sup>154</sup>

### Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Kamenicës ka përmbushur prapë prapë përgjithshëm minimal për të gjitha komunitetet në shërbimin civil komunal; mirëpo, ajo nuk e ka arritur prapë prapë minimal për përfaqësimin e secilit komunitet në shërbimin civil komunal.<sup>155</sup> Në këtë drejtim, ekzistojnë vetëm tre shërbyes civilë nga radhët e komunitetit rom. Për më tepër, një grua nga komuniteti rom është e punësuar në qendrën e mësimin VoRAE, dhe një pjesëtar i komunitetit rom punon në sektorin publik.<sup>156</sup> Përveç kësaj, tre burra të komunitetit rom janë të punësuar në shkollën me planprogram të Serbisë.

Shumica e pjesëtarëve të komunitetit rom jetojnë nga grumbullimi i hekurit dhe plastikës për riciklimin dhe burrat janë të përfshirë në punë sezonale në ndërtim-tari ose bujqësi. Ekzistojnë edhe raste të punës së fëmijëve që përfshijnë kërkimin e lëmshës ose ndihmën për grumbullimin e hekurit ose plastikës, por nuk ka të dhëna të besueshme për numrin e fëmijëve të prekur nga këto lloje të punëve.<sup>157</sup> Sipas zyrës komunale të punësimit, 54 pjesëtarë të komunitetit rom (36 burra, 18 gra) janë të regjistruar si punëkërkues aktivë, ndërsa, sipas informacionit të siguruar nga qendra për punë sociale, 54 pjesëtarë të këtij komuniteti përfitojnë nga asistencë sociale.<sup>158</sup>

### Shëndetësia

Komuniteti rom në komunën e Kamenicës përdor shërbimet e të dy sistemeve shëndetësore që gjenden në komunë.<sup>159</sup> Gratë preken nga mungesa e hapësirave adekuate të shëndetit riprodhues dhe



iu duhet të udhëtojnë jashtë komunës së Kamenicës.

## ■ Kthimi dhe riatdhesimi

Mes datës 1 janar 2016 dhe 31 dhjetor 2018, shtatë pjesëtarë të komunitetit rom janë riatdhesuar në komunë. Gjatë të njëjtës periudhë, janë kthyer 29 pjesëtarë të komunitetit rom të zhvendosur (12 burra, 17 gra).<sup>160</sup> Komuna e Kamenicës ka ndarë 12 parcela toke në fshatin e përzier etnikisht të Berivojcës për qëllime të procesit të kthimit. Shtatë janë përdorur për ndërtimin e shtëpive për pjesëtarët e komunitetit rom të kthyer, të financuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Zyra për Çështje të Komuniteteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.<sup>161</sup> Familjet e kthyer janë përballur me probleme të furnizimit adekuat me ujë dhe lidhje në kanalizim, pasi që puset e ujit dhe gropat septike janë afër njëra-tjetrës. Në Mars të vitit 2017, komuna nënshkroi marrëveshje me OJQ-në "Islamic Relief" për bashkëfinancim të ndërtimit të sistemit të furnizimit me ujë për vendin e kthimit. Më 15 gusht 2018, ndërmarrja rajonale e ujit e përfundoi instalimin e njëhisorëve të ujit dhe iu siguroi qasje në ujë të gjitha shtëpive në fshatin Berivojcë - përfshirë ato që i përkasin shtatë familjeve të kthyer të komunitetit rom.

**150** Agjencia e Statistikave të Kosovës, shih më sipër, fusnota 2.

**151** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 12 mars 2019.

**152** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 11 korrik 2017.

**153** 12 vajza dhe tetë djem.

**154** Intervista me përfaqësuesin e qendrës mësimore zhvilluar më 19 korrik 2017.

**155** Raporti i OSBE-së, shih fusnotën më sipër 8.

**156** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punësim, zhvilluar më 12 mars 2019.

**157** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 11 korrik 2017.

**158** Nuk ka të dhëna të zëbërthyer sipas gjinisë. Sondazhi i ekipeve në terren të OSBE-së, shih shënimin sipër 24.

**159** Informacion i bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**160** Intervistë me ZKKK, zhvilluar më 12 mars 2019.

**161** Informacioni i marrë përmes monitorimit afatgjatë në terren.







# Komuna e Klinës

## Pasqyrim i përgjithshëm dhe vendbanimet

Regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 ka zbuluar që nga 38,496 banorë të regjistruar në komunën e Klinës, 78 janë të komunitetit romë, 85 të komunitetit ashkali dhe 934 të atij egjiptian.<sup>162</sup> Përfaqësuesit e ZKKK-së ana tjetër tregojnë se, që nga dhjetori i vitit 2018, në komunë kanë jetuar afro 192 pjesëtarë të komunitetit rom, 130 të komunitetit ashkali dhe 1,718 të komunitetit egjiptian.<sup>163</sup> Anëtarët e tre komuniteteve jetojnë në zonën urbane "Mahalla" të qytetit të Klinës, dhe në 20 zona në të gjithë komunën, përfshirë fshatrat Berkovë, Binxhë, Bokshiq, Dollovë, Dërsnik, Grabanicë, Jagodë, Jashanicë, Klinafc, Resnik, Rudicë dhe Shtupel.<sup>164</sup>

## Banimi dhe infrastruktura

Sipas përfaqësuesve të komunitetit dhe ZKKK-së, shumica e pjesëtarëve të tri komuniteteve jetojnë në shtëpi të përhershme që janë në gjendje të mirë.<sup>165</sup> Një projekt i përbashkët i komunës dhe OJQ-së Vo-RAE për rindërtimin e disa prej shtëpive të banuara nga pjesëtarët e tre komuniteteve

u realizua në gusht të vitit 2018.<sup>166</sup> Infrastruktura në komunë është përgjithësisht e mirë dhe shumica e rrugëve kryesore që lidhin fshatrat janë të asfaltuara. Punimet për të përmirësuar sistemin e furnizimit me ujë dhe kanalizimit kishin filluar në korrik të vitit 2017, pasi të gjitha komunitetet në komunë ishin përballur me mungesë të ujit gjatë periudhës së verës.<sup>167</sup>

## Përfaqësimi në vendimarrje

Secili komunitet përfaqësohet në KK dhe KKSB. Aktualisht, në KK shërbejnë një burrë nga komuniteti rom, një grua nga komuniteti ashkali dhe një grua nga komuniteti egjiptian. Për më tepër, një burrë nga komuniteti rom, një nga komuniteti egjiptian dhe një grua nga komuniteti ashkali shërbejnë në KKSB. Pozitat e NKK-së dhe ZKK-KK-së nuk janë të detyrueshme në komunë pasi që komunitetet joshumicë përbëjnë më pak se dhjetë për qind të popullatës së gjithmbarshme në komunë. Asnjë prej tre komuniteteve nuk përfaqësohet në kuvendin komunal. Për më tepër, një pjesëtar i komunitetit rom dhe një shërbyes civil i komunitetit egjiptian punojnë në ZKKK; që

të dy janë burra.

## Arsimi

Fëmijët nga komunitete rom, komuniteti ashkali dhe ai egjiptian janë regjistruar në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta me planprogram të Kosovës. Sipas drejtorit të arsimit, 29 nxënës të komunitetit rom, 20 ashkali dhe dy egjiptianë vijojnë shkollat fillore dhe të mesme të ulëta "Ismet Rraci" dhe "Motrat Qiriazhi" në qytetin e Klinës, ndërsa 33 nxënës të komunitetit rom, 93 të komunitetit ashkali dhe 12 të atij egjiptian janë regjistruar në shkollat "Motrat Qiriazhi" në Zajm, "Azem Bejta" në Grabanicë, paralelet e shkollave "Tre Dëshmoret" në Jashanicë dhe Gjurgjevik, shkollën "Isa Boletini" në Drenoc dhe paralelen në Potërq të Poshtëm, "Atë Gjergj Fishta" në Jagodë, "Avni Zhabota" në Shtupel, "Nëna Terezë" në fshatin Budisalc. Asnjë shkollë nuk është më larg se katër kilometra nga zonat ku jetojnë pjesëtarët e të tria komuniteteve.<sup>168</sup> Mirëpo, mundësitë për të mësuar në qendrat mësimore njësitë mësimore të gjuhës dhe kulturës rome ose arsimin formal për të rritur nuk janë në dispozicion brenda komunës.

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Klinës ka përmbushur pragun minimal të kërkuar për të gjitha komunitetet në shërbimin civil dhe në lidhje me kuotat individuale të komunitetit, vetëm komuniteti rom i është i përfaqësuar mirë në shërbimin civil komunal.<sup>169</sup> Sipas ZKKK-së, që nga marsi 2019, dhjetë pjesëtarë të komunitetit egjiptian të Kosovës dhe një i komunitetit rom ishin të punësuar në sektorin publik - një burrë i komunitetit egjiptian në ZKKK, një burrë egjiptian si profesor, pesë burra egjiptianë dhe një rom në Forcën e Sigurisë së Kosovës, një grua egjiptiane si infermiere, një grua egjiptiane si doganiere dhe një grua egjiptiane si zyrtare në degën në Klinë të Gjykatës Themelore të Pejës.<sup>170</sup> Shumica e pjesëtarëve të tri komuniteteve vazhdojnë të përballen me sfida në punësim. Burimet kryesore të të ardhurave janë aktivitetet bujqësore të përkohshme, pastrimi dhe mbledhja e metaleve.<sup>171</sup> Disa projekte të gjenerimit të të ardhurave janë zbatuar në komunë nga organizata ndërkombëtare, veçanërisht Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM).<sup>172</sup> Në komunë nuk është raportuar puna e fëmijëve.<sup>173</sup> Sipas zyrës komunale të punësimit, 30 pjesëtarë të komunitetit rom, dhjetë të komunitetit ashkali dhe asnjë nga ai egjiptian janë regjistruar si punëkërkues aktivë.<sup>174</sup> Sipas informacionit të siguruar nga qendra për punë sociale, 20 pjesëtarë të komunitetit rom, 36 të komunitetit ashkali dhe 111 të komunitetit egjiptian janë regjistruar si përfitues të ndihmës sociale.<sup>175</sup>



## ■ Shëndetësia

Një qendër e mjekësisë familjare dhe tre klinika të mjekësisë familjare ofrojnë shërbime për pjesëtarët e të gjitha komuniteteve që jetojnë në komunën e Klinës. Anëtarët e komunitetit rom, komunitetit ashkali dhe atij egjiptian nuk përballen me asnjë pengesë në lidhje me distancën fizike nga institucionet shëndetësore. Komuna ofron ndihmë falas për shëndetin reproduktiv për gratë nga të tre komunitetet.<sup>176</sup>

## ■ Kthimi dhe riatdhesimi

Ndërmjet 1 janarit 2016 dhe 31 dhjetorit 2018, shtatë pjesëtarë të komunitetit rom (dy burra dhe pesë gra) si dhe 31 të komunitetit egjiptian (30 burra, dhe një grua) janë riatdheusar në komunë. Gjatë të njëjtes periudhë kohore, 16 familje (nuk ka të dhëna të zbërthyer për secilin komunitet) përveç tetë pjesëtarëve të komunitetit egjiptian (shtatë burra, një grua) dhe një burrë nga komuniteti rom janë kthyer vullnetarisht.<sup>177</sup>

**162** Agjencia e Statistikave të Kosovës, shih shënimin 2 më lart.

**163** Nuk ka ndarje të mëtejme në gjini; intervista me përfaqësuesit e ZKKK-së e zhvilluar më 8 deri 11 mars 2019.

**164** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së është zhvilluar më 4 korrik 2017, dhe me përfaqësuesin e komunitetit egjiptian më 19 korrik 2017.

**165** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së është zhvilluar më 4 korrik 2017, dhe me përfaqësuesin e komunitetit egjiptian më 19 korrik 2017.

**166** Informacion aktual i bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, i datës 15 mars 2019.

**167** Intervista me përfaqësuesin e komunitetit egjiptian të Kosovës u krye në 19 korrik 2017 dhe monitorim afatgjatë të ekipit në terren.

**168** Intervista me përfaqësuesin e komunitetit rom, zhvilluar më 19 korrik 2017.

**169** Raporti i OSBE-së, shih fusnotën më sipër 8.

**170** Intervistat me përfaqësuesit e ZKKK-së, zhvilluar më 8 dhe 11 mars 2019.

**171** Intervista me përfaqësuesin e komunitetit rom, zhvilluar më 19 korrik 2017.

**172** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 4 korrik 2017.

**173** Intervista me përfaqësuesin e komunitetit egjiptian dhe me përfaqësuesin e OJQ-së është zhvilluar më 19 korrik 2017.

**174** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punësim, zhvilluar më 12 mars 2019.

**175** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punë sociale, zhvilluar më 11 mars 2019.

**176** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të shëndetësisë u zhvillua më 5 korrik 2017.

**177** Nuk ka zbërthim sipas komuniteteve dhe gjinisë; intervista me përfaqësuesit e ZKKK-së e zhvilluar më 8 deri 11 mars 2019.







# Komuna e

# Leposaviqit

## Pasqyrim i përgjithshëm dhe vendbanimet

Nuk ka të dhëna të regjistrimit të popullatës për komunën e Leposaviqit. Sipas përfaqësuesit të komunitetit, që nga dhjetori i vitit 2018, 64 pjesëtarë të komunitetit rom kanë jetuar në komunën e Leposaviqit, nga të cilët 38 në fshatin Kamen dhe pesë familje me 26 individë janë vendosur në kampin kolektiv "Leposaviq" në qytetin e Leposaviqit.<sup>178</sup>

## Banimi dhe infrastruktura

Rreth 50 familje të komunitetit rom të zhvendosura, kryesisht nga Mitrovica e Jugut, u vendosën në "kampin kolektiv Leposaviq" në një ish-bazë ushtarake nga viti 1999 deri në 2010. Rreth 45 familje u kthyen në vendin e origjinës, kryesisht në "Mahallën e Romëve" në Mitrovicën Jugore. Që nga dhjetori i vitit 2018, pas prishjes së ndërtesës së bazës ushtarake, pesë familje vazhdojnë të jetojnë në ndërtesën në pronësi të Kryqit të Kuq të Serbisë.<sup>179</sup> Në vitin 2017, KK i komunës së Leposaviqit ishte në proces të miratimit të parcelave tokësore për projekte

të mundshme të ndërtimit të shtëpive të mbështetura nga organizata donatore ndërkombëtare; mirëpo, që nga ajo kohë nuk ka pasur asnjë përparim. Anëtarët e komunitetit rom nga Kamen jetojnë në shtëpi të përhershme, ku shpesh u mungojnë tualetet dhe banjat adekuate.<sup>180</sup>

## Përfaqësimi në vendimmarrje

Një burrë i komunitetit rom përfaqëson banorët romë të Kosovës në KK.<sup>181</sup> Asnjë pjesëtarë nga të tria komunitetet nuk punon për ZKKK dhe asnjë nga të tria komunitetet nuk janë të përfaqësuar në Kuvendin Komunal. Në komunë nuk është themeluar KKS-b-jë.

## Arsimi

Sipas informacionit të dhënë nga drejtori komunal i arsimit, 16 nxënës të komunitetit rom vijojnë mësimin në shkollën fillore dhe të mesme "Leposavić" në qytetin e Leposaviqit dhe një vijon mësimin në shkollën fillore dhe të mesme "Stana Baćanin" në fshatin Leshak. Asnjë mësues i komunitetit rom nuk është i punësuar në komunën e Leposaviqit, nuk është në dispozicion lënda

e gjuhës dhe kulturës rome e as qendra mësimore as arsim formal për të rritur.<sup>182</sup>

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Që nga korriku i vitit 2017, asnjë anëtar i komunitetit rom në komunën e Leposaviqit nuk ishte punësuar në shërbimin civil dhe sektorin publik. Në vitin 2019, duke mos e përmendur një grua të komunitetit rom që ishte e punësuar përmes një projekti të udhëhequr nga UNDP,<sup>183</sup> të dhënat për punësimin e pjesëtarëve të komunitetit rom në sektorin privat nuk ishin në dispozicion për institucionet komunale.<sup>184</sup> Mirëpo, në korrik të vitit 2017, një përfaqësues i komunitetit pohoi se asnjë anëtar i komunitetit rom nuk ishte punësuar.<sup>185</sup> Deri më 31 dhjetor të vitit 2018, zyra e punësimit regjistroi 11 pjesëtarë të komunitetit rom (katër gra, shtatë burra) si persona të papunë.<sup>186</sup>

## Shëndetësia

Komuniteti rom në komunë ka qasje në shërbimet shëndetësore në shtëpitë e shëndetit në qytetin e Leposaviqit, në fshatin Leshak dhe spitalin e Mitrovicës së Veriut. Komuna e Leposaviqit ofron ndihmë për shëndetin riprodhues për gratë e komunitetit rom.<sup>187</sup>

## Kthimi dhe riatdhesimi

Mes datës 1 janar 2016 dhe 31 dhjetor 2018, asnjë pjesëtar i komunitetit rom nuk është riatdhesuar në komunë. Gjatë të njëjtës periudhë, një familje, me një nënë rome dhe baba serb të Kosovës, u kthye vullnetarisht nga shpërnguljet.<sup>188</sup>

**178** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 18 korrik 2019.

**179** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 18 korrik 2019.

**180** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 1 korrik 2017.

**181** KKS-b nuk është themeluar në Leposaviq.

**182** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 09 korrik 2017.

**183** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punësim, zhvilluar më 20 mars 2019.

**184** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 20 korrik 2017.


**185** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 1 korrik 2017.

**186** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punësim, zhvilluar më 20 mars 2019.

**187** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 09 korrik 2017.

**188** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 13 mars 2019.















# Komuna e Lipjanit

## Pasqyrim i përgjithshëm dhe vendbanimet

Sipas regjistrimit të popullatës së vitit 2011, nga 57,605 banorë, 342 të komunitetit rom, 1.822 të komunitetit ashkali dhe katër banorë të komunitetit egjiptian janë regjistruar në komunën e Lipjanit.<sup>189</sup> Sipas ZKKK-së, 342 pjesëtarë të komunitetit rom, 1.912 të komunitetit ashkali dhe tetë të komunitetit egjiptian kanë jetuar në komunë deri më 31 dhjetor 2018, ndërsa përfaqësuesit e komunitetit treguan se janë rreth 390 banorë të komunitetit rom, 2,225 të komunitetit ashkali dhe tetë banorë të komunitetit egjiptian.<sup>190</sup> Disa pjesëtarë të komunitetit ashkali dhe rom banojnë në lagjen "Mostinë" në qytetin e Lipjanit. Shumica e pjesëtarëve të komunitetit ashkali jetojnë në fshatrat Gadime e Ulët, Hallaq i Vogël, Konjuh, Magurë dhe Medvec. Pjesëtarët e komunitetit rom - përveç një numri të vogël që jetojnë në qytetin e Lipjanit - kryesisht jetojnë në fshatin Janjevë, ndërsa anëtarët e komunitetit egjiptian jetojnë në fshatin Medvec.<sup>191</sup> Duke marrë parasysh numrin e vogël të pjesëtarëve të komunitetit egjiptian të regjistruar në komunë, informacioni do të

përshkruaj hollësisht situatën e komunitetit rom dhe atij ashkali.

## Banimi dhe infrastruktura

Pjesëtarët e tre komuniteteve kanë banim të përhershëm në lagje dhe vendbanime gjysmë formale; ndërsa shtëpitë janë të lidhura me energji elektrike, ujë dhe kanalizim, titujt dhe dokumentacioni pronësor nuk janë plotësuar nga pronarët. Disa shtëpi kërkojnë renovim për shkak të mbi-popullimit.<sup>192</sup> Për disa vite me radhë para muajit korrik 2017, familjet nga tre komunitetet që jetojnë në fshatrat Gadime e Ulët, Janjevë dhe Medvec kanë përfituar nga ndërtimi i shtëpive të financuar nga organizata të ndryshme donatore.<sup>193</sup> Në vitin 2017, OJQ-të "Diakonia" dhe VoRAE, së bashku me komunën, kanë siguruar materiale ndërtimi për 19 familje për ndërtimin e anekseve të shtëpive dhe banjave.<sup>194</sup> Ndërtimi i banjave brenda shtëpive përmirësoi ndjeshëm gjendjen shëndetësore të anëtarëve të familjes, veçanërisht grave. Disa familje të komunitetit ashkali dhe atij rom ende kërkojnë rindërtim të shtëpive, pasi që shtëpitë në të cilat jetojnë janë të vjetra dhe gjendja

e tyre dita ditës përkeqësohet. Komuna ka ndërmarrë projekte të investimeve kapitale për të përmirësuar rrjetin e kanalizimit dhe asfaltimin e rrugëve dytësore.<sup>195</sup>

## Përfaqësimi në vendimmarrje

Si komuniteti ashkali ashtu edhe ai rom janë të përfaqësuar mirë në mekanizmat lokalë për mbrojtjen e komuniteteve. Një burrë rom dhe një burrë ashkali janë anëtarë të KKS-së, ndërsa vetëm një burrë rom e përfaqëson komunitetin në KK.<sup>196</sup> Një burrë ashkali është anëtar i kuvendit komunal. Ndonëse pozitat e NKK dhe ZKKK nuk janë të detyrueshme në komunë, ato u krijuan vullnetarisht nga udhëheqësia e komunës. Të dy pozitat mbahen nga burra të komunitetit ashkali. Komuniteti egjiptian nuk është i përfaqësuar në asnjërin nga mekanizmat lokal për mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e komuniteteve.

## Arsimi

Sipas drejtorisë komunale të arsimit, pesë nxënës të komunitetit rom, 366 të komunitetit ashkali dhe dy egjiptianë vijnë pesë

shkolla fillore dhe të mesme të mesme të ulëta - "Fehmi Agani", "Haradin Bajrami", "Ismajl Luma", "Migjeni" dhe "Zenel Hajdini" - si dhe dy shkolla ofrojnë arsim të mesëm të lartë, përkatësisht shkolla profesionale "Adem Glavica" dhe gjimnazi "Ulpiana".<sup>197</sup> Të gjitha shkollat janë brenda një largësie të qasshme nga zonat ku jetojnë nxënësit. Nuk ofrohen lëndë të gjuhës dhe kulturës rome, dhe asnjë mësues nga të tre komunitetet nuk është i punësuar në shkollat brenda komunës.<sup>198</sup>

Përveç kësaj, 38 fëmijë të komunitetit rom nga fshati Janjevë ndjekin mësimin në shkollën fillore dhe të mesme të ulët "Sht-jefën Gjeqovi" me kurrikulë të Kosovës, dhe në shkollën fillore "Vladimir Nazor" sipas kurrikulës së Serbisë.<sup>199</sup> Nxënësit e shkollës "Vladimir Nazor" ndjekin shkollimin e mesëm në komunën e Graçanicës, pasi komuna e Lipjanit nuk ka asnjë shkollë të mesme me planprogram të Serbisë. Nxënësit e komunitetit rom që vijnë në shkollat e mesme përpiqen të gjejnë zgjidhje të përhershme për transport deri në Graçanicë. Komuna e Lipjanit nuk siguron transport për shkollim jashtë komunës ndërsa komuna e Graçanicës nuk siguron transport për nxënësit që nuk banojnë në komunë. Në të kaluarën, transporti është siguruar në baza ad-hoc qoftë nga prindërit ose nga komunat. Që nga viti akademik 2017 / 2018, prindërit kanë mbuluar vetë shpenzimet e transportit. Transporti i parregullt është nga faktorët kryesorë që shpie në braktisjen e shkollës së mesme nga komuniteti rom në fshatin e Janjevës, duke pasur parasysh që shumica e prindërve nuk mund t'i përballojnë shpenzimet e transportit. Përafërsisht 250 nxënës<sup>200</sup> vijnë në mësimin në qendrat e mësimi të menaxhuara nga OJQ-ja VoRAE, në qytetin Lipjanit dhe



fshatrat Gadime e Ulët, Magurë dhe Medvec. Qendrat e mësimit janë të vendosura në shkolla dhe drejtoria komunale e arsimit i mbështet ato duke ofruar hapësira shkollore pa pagesë.<sup>201</sup> Orët mësimore dy vjeçare të arsimit formal për të rritur, organizohen edhe nga komuna në qytetin Lipjanit, dhe në fshatin Magurë.<sup>202</sup>

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Lipjanit e ka përmbushur prapë minimal për përfaqësimin e përgjithshëm të komuniteteve në shërbimin civil komunal, ndonëse nuk janë përmbushur kuotat e komuniteteve individuale.<sup>203</sup> Një burrë nga komuniteti ashkali është i punësuar në shërbimin civil komunal, një grua nga komuniteti ashkali në shëndetësi dhe afërsisht pesë pjesëtarë të komunitetit janë të punësuar në sektorin publik si pastrues.<sup>204</sup>

Qasja në punësim në sektorin privat mbetet sfiduese. Pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali - kryesisht burra - angazhohen në veprimtari joformale ekonomike dhe punë sezonale bujqësore, derisa të rinjtë punësohen në veprimtari sezonale ndërtimore. Gratë nuk angazhohen as në aktivitete formale e as joformale ekonomike të punësimit.<sup>205</sup> Asnjë rast i punësimit të fëmijëve nuk raportohet, përveç fëmijëve - kryesisht djem - që ndihmojnë prindërit e tyre në punë sezonale bujqësore.<sup>206</sup> Një spikere rome, me prejardhje nga komuna, është e punësuar në RTK1, si dhe udhëheqë programet që i dedikohen komunitetit rom në Kosovë.<sup>207</sup> Në të kaluarën, disa individë nga të tre komunitetet kanë përfutur nga projektet e krijimit të ardhurave. Disa sosh janë dëshmuar të jenë të qëndrueshme,

si një garazh që udhëhiqet nga romët në qytetin e Lipjanit, si dhe një tjetër që udhëhiqet nga ashkalinjtë në fshatin Hallaq i Vogël.<sup>208</sup> Sipas zyrës komunale të punësimit, gjashtë romë (katër burra e dy gra) si dhe 23 ashkalinj (13 burra dhe dhjetë gra), banorët janë të regjistruar si të papunë, derisa qendra për mirëqenien sociale raporton që 220 familje ashkali dhe 25 familje rome marrin ndihma sociale.<sup>209</sup>

## Shëndetësia

Edhe gratë edhe burrat nga të tre komunitetet kanë qasje në institucione shëndetësore. Institucionet mjekësore janë të vendosura në distanca të qasshme, edhe në Lipjan edhe në fshatrat e banuar nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës. Kujdesi për shëndetin riprodhues i ofrohet grave.<sup>210</sup>

## Kthimi dhe riatdhesimi

Ndërmjet 1 janarit 2016 dhe 31 dhjetorit 2018, 285 pjesëtarë të komunitetit ashkali (149 burra, 136 gra) si dhe 74 të komunitetit rom (39 burra, 35 gra) janë riatdhesuar në komunë.<sup>211</sup> Gjatë të njëjtës periudhë, tetë pjesëtarë të zhvendosur të komunitetit ashkali (dy burra, gjashtë gra) nga rajoni janë kthyer vullnetarisht në komunë.<sup>212</sup>

**189** Agjencia Statistike e Kosovës, shih më sipër, fusnota 2.

**190** Intervista me tre përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 8 dhe 9 mars 2019 dhe me përfaqësuesin e ZKKK-së më 13 Mars 2019.

**191** Intervista me tre përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 8 dhe 9 mars 2019 dhe me përfaqësuesin e ZKKK-së më 13 Mars 2019.

**192** Informacion i bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi

2019.

**193** Informacion i bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**194** Intervista me përfaqësuesit e komuniteteve është zhvilluar më 6 korrik 2017, dhe me përfaqësuesin e ZKKK-së më 6 korrik 2017.

**195** Informacion aktual i bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, nga 15 marsi 2019.

**196** Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2017, udhëheqësit e komunitetit ashkali nënshkruan marrëveshje koalicioni me kryetarin e atëhershëm Imri Ahmeti të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) i cili u rizgjedh për mandat të dytë. Si pjesë e marrëveshjes për koalicion, komuniteti ashkali mori pozitat e NKK dhe ZKKK, dhe një vend në komitetin për politika dhe financa si dhe hoqi dorë nga vendi i saj në KK. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk ka lëshuar ndonjë shqyrtim të ligjshmërisë të vendimit për themelimin e KK-së.

**197** Të dhënat e ndara në gjini nuk janë në dispozicion; Intervista me drejtorinë komunale të arsimit u zhvillua më 7 korrik 2017.

**198** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit u zhvillua më 7 korrik 2017.

**199** Përderisa këto janë shkolla të ndara, ato ndodhen në të njëjtën ndërtesë.

**200** Përafërsisht 50 për qind djem dhe 50 për qind vajza.

**201** Intervista me përfaqësuesin e qendrës mësimore është zhvilluar më 19 korrik 2017.

**202** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit u zhvillua më 7 korrik 2017.

**203** Raporti i OSBE-së, shih fusnotën më sipër 8.

**204** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës rajonale për punësim, zhvilluar më 9 mars 2019.

**205** Intervista me dy përfaqësues të komunitetit mbajtur më 6 korrik 2017.

**206** Intervista me përfaqësuesin e OJQ-së zhvilluar më 19 korrik 2017.

**207** Informata bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**208** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 6 korrik 2017.

**209** Ndarja gjinore dhe numri i anëtarëve për familje nuk dihen; intervista me qendrën për punë sociale zhvilluar më 9 mars 2019.

**210** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të shëndetësisë u zhvillua më 11 korrik 2017.

**211** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 8 mars 2019.

**212** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 8 mars 2019.











## Komuna e

# Mamushës

### Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Komuna e Mamushës mbulon një sipërfaqe prej afro 11 km<sup>2</sup>. Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, 5,507 banorë janë të regjistruar në komunën e Mamushës, nga të cilët 74 janë romë të Kosovës dhe 12 janë ashkali të Kosovës.<sup>213</sup> Megjithatë, sipas ZKKK, 75 romë të Kosovës dhe asnjë ashkali i Kosovës aktualisht nuk banon në Mamushë (ndërsa 55 të tjerë janë të regjistruar në komunë por jetojnë jashtë Kosovës)<sup>214</sup>.

### Banimi dhe infrastruktura

Gjendja e banimit dhe infrastruktura në komunën e Mamushës është në përgjithësi e kënaqshme. Strehimi nuk konsiderohet të jetë nevojë e menjëhershme për shumicën dërrmuese të pjesëtarëve të komunitetit rom të Kosovës.

### Përfaqësimi në vendimmarrje

Komuniteti Rom i Kosovës është i përfaqësuar në KK dhe KKSBB nga një burrë në secilin mekanizëm. Një pjesëtar i komunitetit rom të Kosovës është i punësuar në ZKKK dhe komuniteti nuk është i përfaqësuar në KK. Pozitat e NKK është e plotësuar nga një shqiptar i Kosovës dhe ZKKKK nuk është e detyrueshme në komunë.

### Arsimi

Sipas informatave të dhëna nga drejtorja komunale e arsimit, tetë nxënës të komunitetit rom janë regjistruar në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta "Ataturk" dhe "Anadollu".<sup>215</sup> Shkollat gjenden mes një deri në katër kilometra nga zonat ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve dhe sipas përfaqësuesve të komuniteteve nuk ka asnjë gjë e cila i parandalon fëmijët për t'ju qasur shkollave.<sup>216</sup> Orët e mësimi të gjuhës dhe kulturës rome nuk janë në dispozicion në shkolla dhe as orët e mësimi për arsimin e të rriturve.<sup>217</sup>

### Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Mamushës nuk e ka përbushur as pragun minimal për përfaqësimin e përgjithshëm të komuniteteve e as kuotën e veçantë për përfaqësimin e komunitetit rom të Kosovës në shërbimin civil komunal.<sup>218</sup> Bujqësia është veprimtaria kryesore ekonomike informale për pjesëtarët e komunitetit rom të Kosovës në zonat rurale, ndërsa në zonat urbane disa pjesëtarë të komuniteteve punojnë në kompani private apo kryejnë punë sezonale.<sup>219</sup> Sipas ZKKK-së, ndonëse asnjë pjesëtar i komuniteteve nuk është i punësuar në sektorin publik, deri në dhjetor 2018 pesë janë të punësuar në sektorin privat.<sup>220</sup> Gjithsej, 34 romë të Kosovës (23 burra dhe 11 gra) janë regjistruar si punëkërkuar aktivë në zyrën komunale të punësimit, ndërsa dy familje rome të Kosovës me dhjetë anëtarë gjithsej marrin ndihmë sociale.<sup>221</sup> Ekonomia e komunës së Mamushës kryesisht bazohet në aktivitete bujqësore dhe tregtare në shkallë të vogël. Rreth 800 biznese të regjistruara private funksionojnë në komunë.

### Shëndetësia

Mamusha ka një qendër komunale të shëndetësisë familjare. Për çështje më komplekse shëndetësore, banorët shkojnë në Spitalin Rajonal të Prizrenit. Të gjitha komunitetet kanë qasje në kujdesin shëndetësor dhe të gjitha objektet shëndetësore. Komuna ofron ndihmë falas për shëndetin reprodaktiv për gratë nga të tre komunitetet.<sup>222</sup>

### Kthimi dhe riintegrimi

Sipas ZKKK-së, dy familje rome të Kosovës me dhjetë anëtarë gjithsej u riatdhesuan në komunë mes janarit të vitit 2017 dhe gushtit të vitit 2019. Asnjë pjesëtar nga të dyja komunitetit nuk u kthye në mënyrë vullnetare në komunë nga vendi i zhvendosjes gjatë të së njëjtës periudhë.<sup>223</sup>

**213** Agjencia e Statistikave të Kosovës, shih më sipër shënimin 2.

**214** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 17 shtator 2019.

**215** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit, zhvilluar më 7 tetor 2019.

**216** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 17 shtator 2019.

**217** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit, zhvilluar më 17 shtator 2019.

**218** Raporti i OSBE-së, shih shënimin sipër 8.

**219** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 17 shtator 2019.


**220** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 17 shtator 2019.

**221** Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë nuk janë në dispozicion; Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punë sociale, zhvilluar më 17 shtator 2019.

**222** Monitorimi në terren i OSBE-së.

**223** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 17 shtator 2019.





# Komuna e

# Mitrovicës së Veriut

## Informata të përgjithshme dhe vendbanimet

Nuk ka të dhëna zyrtare mbi popullsinë në Mitrovicë të Veriut. Sidoqoftë, raporti i OSBE-së për Profilin Komunal për vitin 2018 vlerëson se në vitin 2010, komuna kishte një popullsi prej 29.460. Kjo përfshinte 200 romë të Kosovës dhe 40 ashkali të Kosovës.<sup>224</sup> Sipas intervistave me përfaqësuesit e komunitetit, që nga nëntori 2019, janë afro 86 pjesëtarë të komunitetit rom të Kosovës dhe atij ashkali të Kosovës që banojnë në komunë.<sup>225</sup> Sipas intervistave, shumica e romëve të Kosovës jetojnë në lagjen e komunitetit të përzier në Kodrën e Minatorëve, ku pesë familje rome të Kosovës banojnë në një objekt të sapo-ndërtuar në atë lagje. Pjesëtarët e tjerë të komunitetit rom dhe ashkali të Kosovës banojnë në vende të ndryshme në të gjithë komunën, përfshirë në Lagjen Boshnjake, Kroin e Vitakut dhe Suhodollin.

## Banimit dhe infrastruktura

Në vitin 2013, Norwegian Church Aid dhe USAID financuan ndërtimin e një ndërtese banimi prej tre kateve, në lagjen e komunitetit të përzier Kodra e Minatorëve. Krahas romëve të Kosovës, në lagje banojnë edhe pjesëtarë të komunitetit shqiptar, serb, ashkali dhe boshnjak të Kosovës. Ndërtesa përmban gjashtë njësi banimi me dy dhe tre dhoma gjumi, pesë prej të cilave janë të banuara nga familje rome të Kosovës.<sup>226</sup> Familjet u vendosën në ndërtesë pas mbylljes së kampeve të personave të zhvendosur në Osterode dhe Cesminlukë, të dyja prej të cilave gjenden brenda qytetit të Mitrovicës së Veriut.

## Përfaqësimi në vendimarrje

As komuniteti rom i Kosovës dhe as ai ashkali i Kosovës nuk përfaqësohen aktualisht në KK. Për më tepër, nuk ka ZKKK<sup>227</sup>, KKSB ose NKK në Mitrovicë të Veriut. Sidoqoftë, komuna ka krijuar pozitën e ZKKK.<sup>228</sup>

## Arsimi

Në shtatë shkolla fillore në Mitrovicë të Veriut mësimin e vijnë 365 nxënës romë dhe ashkali të Kosovës, nga të cilët 290 banojnë në Mitrovicën e Jugut.<sup>229</sup> Shtatë shkolla fillore në Mitrovicë të Veriut kanë nxënës romë dhe ashkali të Kosovës. Pesë nga këto shkolla; “Veljko Banašević”, “Predrag i Miodrag Mihajlović”, “Desanka Maksimović”, “Dositelj Obradović” dhe “Vlado Četković”, vijohen vetëm nga romët dhe ashkalitë e Kosovës, të cilët përbëhen nga gjithsej 352 nxënës.<sup>230</sup> Për më tepër, 13 nxënës romë dhe ashkali të Kosovës vijnë shkollat që nuk janë vetëm për romët dhe ashkalitë e Kosovës “Branko Radičević” dhe “Sveti Sava”.<sup>231</sup> Të gjitha shkollat janë me kurrikulë të Serbisë dhe ndodhen në qytetin e Mitrovicës së Veriut. Transporti jo i rregullt i nxënësve ndërmjet komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Mitrovicës së Veriut dhe perceptimet negative të sigurisë çojnë në shkallë të lartë të braktisjes shkollore nga nxënësit romë<sup>232</sup>. Vlen të theksohet se të pesë shkollat e vijua vetëm nga nxënësit romë dhe ashkali të

Kosovës i ndajnë ambientet me shkollën “Branko Radičević”.

Sipas informatave të pranuar përmes një interviste me një përfaqësues të komunitetit, asnjë nga fëmijët e moshës shkollore të familjeve rome dhe ashkali të Kosovës që banojnë në ndërtesën e banimit në Kodrën e Minatorëve aktualisht nuk vijnë shkollimin.<sup>233</sup>

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Të gjitha familjet rome të Kosovës që banojnë në ndërtesën e banimit në Kodrën e Minatorëve aktualisht marrin ndihmë sociale, dhe kështu nuk janë të angazhuar në punësim të dobishëm.<sup>234</sup> Nga komuniteti ashkali të Kosovës, ekipet tona në terren janë në dijeni të një burri që punon në ndërmarrjen komunale të mbeturinave, një grua punon në spitalin rajonal të administruar nga Serbia dhe një burrë që punon për Kryqin e Kuq të Serbisë.<sup>235</sup> Një burrë rom është i punësuar në OSBE.

## Shëndetësia

Kujdesi shëndetësor ofrohet falas në spitalin rajonal të Serbisë në Mitrovicë të Veriut.

## Kthimi dhe riatdhesimi

Asnjë pjesëtar i komunitetit nuk është kthyer nga zhvendosja në periudhën mes 1 janarit 2016 dhe 31 dhjetorit 2018. Po ashtu, asnjë anëtar i komunitetit nuk u riatdhesua në komunë në të njëjtën periudhë.<sup>236</sup>



**224** Misioni i OSBE-së në Kosovë, Profili i Komunës së Mitrovicës së Veriut, në dispozicion në <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/122119>.

**225** Intervista me përfaqësues të romëve dhe ashkalive të Kosovës, të gjitha të realizuara më 11 nëntor 2019. Përderisa bashkëbiseduesit vlerësonin se janë 86 anëtarë të të dy komuniteteve, ata nuk ishin në gjendje të ndanin këto të dhëna për secilin komunitet individual.

**226** Njësia e gjashtë e banimit shfrytëzohet nga një familje serbe e Kosovës. Intervistë me përfaqësuesin romë të Kosovës që banon në kompleksin e banimit, realizuara më 11 nëntor 2019.

**227** Përderisa janë zyrtarët komunalë ata që i përmbushin këto role, zyra nuk është themeluar zyrtarisht sipas legjislacionit përkatës.

**228** Meqenëse nuk ka të dhëna zyrtare në lidhje me shifrat e popullsisë, është e vështirë të dihet nëse komunitetet joshumicë përbëjnë më shumë se dhjetë për qind të popullsisë duke i bërë kështu të detyrueshme pozitat e NKK dhe ZKKKK.

**229** Informatat e bazuara në raportin e komitetit të veprimit komunal në Mitrovicë të Jugut për vitin 2018.

**230** Informacioni i ofruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik të Serbisë; nuk u ofruan të dhëna të zbërthyera.

**231** Po aty.

**232** Informata të bazuara në monitorimin e ekipeve në terren të OSBE, të 15 marsit 2019.

**233** Intervistë me përfaqësuesin romë të Kosovës që banon në kompleksin e banimit, realizuara më 11 nëntor 2019.

**234** Intervistë me përfaqësuesin romë të Kosovës që banon në ndërtesë, realizuar më 11 nëntor 2019.

**235** Informata të bazuara në intervistën me përfaqësuesin ashkali të Kosovës, realizuar më 11 nëntor 2019.

**236** Intervistë me përfaqësuesin komunal më 18 nëntor 2019.

# Komuna e

# Mitrovicës së Jugut

## Informata të përgjithshme dhe vendbanimet

Regjistrimi i vitit 2011 ka treguar që nga 71,909 banorë të regjistruar në komunën e Mitrovicës së Jugut, 528 janë romë, 647 ashkalinj dhe gjashtë egjiptianë.<sup>237</sup> ZK-KK-ja vlerësonte që në korrik të vitit 2017, rreth 400 romë dhe 1,000 ashkalinj të Kosovës jetonin në komunë, si dhe konfirmonte që nuk ka egjiptianë që banojnë në komunë.<sup>238</sup> Pjesëtarët e komunitetit rom banojnë kryesisht në "Mëhallën Rome" të Mitrovicës së Jugut, bashkë me ashkalinjtë, 239 ndërsa komuniteti ashkali po ashtu banon tek lagjja "2 Korriku",<sup>240</sup> si dhe lagjet urbane në Shipol.<sup>241</sup>

## Banimi dhe infrastruktura

"Mëhalla rome" gjendet afër qendrës së qytetit të Mitrovicës së Jugut. Komunitetet romë dhe ashkalinj kanë banuar historikisht në këtë zonë. Si pasojë e konfliktit të vitit 1999, shumica e banorëve kishin braktisur "Mëhallën Rome", si dhe shumë nga ta ishin vendosur në kampin e personave të zhvendosur të Osterodes dhe

Cesminlukës. Më 2003, procesi i mbylljes së kampeve kishte filluar me përkrahjen e institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare<sup>242</sup> si dhe në bashkëpunim me komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërmjet viteve 2003 dhe 2014, mbështetja për kthimin gradual në "Mëhallën Rome" çoi drejt rritjes së vazhdueshme të popullatës rome dhe ashklike, si dhe përmirësimeve të infrastrukturës në vendbanim. Infrastruktura e banimit tek "Roma Mahalla" përbëhet nga shtëpitë private të përhershme për një familje,<sup>243</sup> banesa kolektive<sup>244</sup> si dhe shtëpi individuale me tarraca.<sup>245</sup> Kçjet në shërbime, energji elektrike, ujësjellës dhe kanalizim janë funksionale në "Mëhallën Rome". Megjithatë, për shkak të mospagesës së faturave për shërbime, kompanitë publike kanë zbatuar reduktime e shkyçje kolektive të ujësjellësit dhe energjisë elektrike. Edhe funksionimi i sistemit të kanalizimeve është problematik tek "Roma Mahalla."

Lagjja "2 Korriku" gjendet në qendër të qytetit të Mitrovicës së Jugut. Është lagje me popullsi të dendur dhe të përzier, historikisht e banuar nga shqiptarët dhe ashkalinjtë e Kosovës. Shumica e familjeve

ashklike në lagjen "2 Korriku" janë pronare të shtëpive të tyre, me përjashtim të disa familjeve që kanë ndërtuar shtëpitë e tyre në tokë komunale, pa leje. Përgjithsisht, infrastruktura dhe qasja në shërbime brenda lagjes janë mjaft të mira, si dhe përfshijnë ndriçimin publik, grumbullimin e depozitimitin e mbeturinave, energjinë elektrike, ujësjellësin dhe kanalizimet. Megjithatë, infrastruktura rrugore është në gjendje tejet të dobët. Për shkak të argjaturave të dëmtuara të lumit, si dhe sistemit jofunksional të gypave të kanalizimit, lagjja është mbuluar me vërshime të përsëritura nga lumi Sitnicë - duke shkaktuar dëme në shtëpi dhe evakuime të familjeve.

## Përfaqësimi në vendimmarrje

Vetëm komuniteti ashkali është i përfaqësuar me një burrë që mban ulëse në Komitetin për Komunitete, si dhe një në KKSB. Asnjë pjesëtar nga dy komunitetet nuk punon në ZKKK, e as mban ulëse në Kuvend të Komunës. Pozitat e NKK-së dhe ZKKK-së nuk janë obligative, pasi që ko-

munitetet jo-shumicë përbëjnë më pak se dhjetë për qind të gjithë popullatës komunale.

## Arsimi

Sipas drejtorit komunal të arsimit, tetë nxënës romë dhe 56 nxënës ashkalinj vijnë shkollat fillore dhe të mesme të ulëta me kurrikula të Kosovës, "Andon Zako Çajupi", "Bedri Gjinaj" dhe "Aziz Sylejmani", që gjenden në qytetin e Mitrovicës së Jugut.<sup>246</sup> Transporti i parregullt i nxënësve ndërmjet komunave Mitrovicë e Jugut dhe Mitrovicë e Veriut, si dhe perceptimet negative të sigurisë shpien drejt një shkalle të lartë të braktisjes së shkollave nga nxënësit romë të Kosovës.<sup>247</sup>

Shkollat në komunën e Mitrovicës së Jugut nuk ofrojnë orë të gjuhës rome. Asnjë mësimdhënës nga dy komunitetet nuk është i punësuar në komunën e Mitrovicës së Jugut, si dhe nuk ka orë mësimore formale për të rritur.<sup>248</sup>

Një qendër mësimore vepron në zonën e "Mëhallës Rome" nën menaxhimin e OJQ-së "Qendra e Dokumentimit Rom dhe Ashkali (Roma and Ashkali Documentation Center)". Kjo mbështetet financiarisht nga Këshilli Danez për Refugjatë (DRC), ndërsa komuna e Mitrovicës së Jugut siguron lokalet dhe drutë e ngrohjes për dimër.<sup>249</sup> Gjithsej 417 fëmijë përfitojnë nga programet e kësaj qendre mësimore.<sup>250</sup> Që nga korriku 2017, qendra mësimore vazhdon të përballet me Agjencinë e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronave, e cila konteston pronësinë e lokaleve. Komuna është duke ndërmjetësuar në këtë kontest.<sup>251</sup>



## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Mitrovicës së Jugut ka përm-bushur pragun minimal për përfaqësimin e përgjithshëm të komuniteteve në shërbimin civil komunal, edhe pse nuk janë përm-bushur kuotat e komuniteteve individuale.<sup>252</sup> Që nga dhjetori i vitit 2018, një burrë ashkali punon si roje sigurimi, ndërsa katër romë e ashkalinjë të Kosovës janë punësuar për kohësisht nga kompania rajonale e mbeturinave "Uniteti".<sup>253</sup> Për më tepër, një ashkali punon në Post Telekom, një tjetër në ZKKK, njëri në Qendrën e Dokumentimit për Romë e Ashkalinj, ndërsa një tjetër për Këshillin Danez për Refugjatë. Po ashtu, një grua rome punon në DRC, ndërsa një tjetër për Qendrën e Dokumentimit për Romë e Ashkalinj. Përveç këtyre, rreth dhjetë banorë të "Mëhallës Rome" punojnë joformalisht, duke ofruar shërbime riparimi sipas kërkesës.<sup>254</sup> Shumica e pjesëtarëve të punësuar të komunitetit ashkali që jetojnë në lagjen "2 Korriku" janë të vetë-punësuar dhe ofrojnë shërbime të prerjes së druve, shërbime të riparimit të veturave dhe shtëpiake. OJQ-të ndërkombëtare dhe lokale, si "Diakonie Youth Centre", Këshilli Danez për Refugjatë, Caritas Kosova si dhe "Women for Women International" ofrojnë trajnime të ndryshme profesionale, si ato të floktarisë, rrobaqepësisë, si dhe artizanateve të ndryshme, që shënjestrojnë gratë.<sup>255</sup> Një numër i pacaktuar i fëmijëve janë të angazhuar në aktivitete pune. Djemtë zakonisht mbledhin materiale të riciklueshme ndërsa vajzat kërkojnë lëmshë.<sup>256</sup> Sipas zyrës komunale të punësimit, 188 banorë romë (81 gra, 107 burra), 187 ashkalinj (81 gra, 107 gra) si dhe katër egjiptianë (dy gra, dy burra), janë të regjistruar si të papunë aktivë, derisa qendra për mirëqe-

nie sociale raporton që 15 familje ashkali dhe 126 familje rome marrin ndihma sociale.<sup>257</sup>

## Shëndetësia

Tek "Roma Mahalla", shërbimet shëndetësore ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare.<sup>258</sup> Çështjet shëndetësore që lidhen me ekspozimin ndaj plumbit në kampet e personave të zhvendosur ende ndikojnë tek banorët e "Mëhallës Rome".<sup>259</sup> Në këtë kontekst, disa organizata ndërkombëtare në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë së komunës së Mitrovicës së Jugut kanë zhvilluar fushata testimi dhe trajtimi për ata që janë të prekur nga kontaminimi me plumb.<sup>260</sup>

Në lagjen "2 Korriku", shërbimet shëndetësore janë të disponueshme jashtë lagjes; megjithatë, shërbimet janë lehtësisht të qasshme dhe të mundshme në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Spitalin Rajonal.<sup>261</sup> Komuna ofron një program gjithëpërfshirës të kujdesit për shëndetin riprodhues për të gjitha gratë, duke përfshirë ato nga komuniteti rom dhe komuniteti ashkali.<sup>262</sup>

## Kthimi dhe riatdhesimi

Ndërmjet 1 janarit 2016 dhe 31 dhjetorit 2018, 37 pjesëtarë të komunitetit rom dhe 111 pjesëtarë të komunitetit ashkali janë riatdhesuar në komunë.<sup>263</sup> Gjatë të njëjtës periudhë, dy familje rome (me shtatë anëtarë)<sup>264</sup> u kthyen vullnetarisht në komunë; megjithatë, 31 familje të zhvendosura kanë dorëzuar kërkesë për kthim si dhe ishin në pritje të ndarjes së tokës apo ndonjë forme tjetër të ndihmës që prej marsit 2019.<sup>265</sup>

**237** Agjencia Statistikore e Kosovës, shih më sipër, fusnota 2.

**238** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 6 korrik 2017. Në një intervistë të zhvilluar më 8 mars 2019, ZKKK-ja theksonte që rreth 65 familje ashkalinj banonin në lagjen "2 Korriku", 15 familje ashkalinj banonin në Shipol, ndërsa 230 familje romë dhe ashkalinj banonin në "Roma Mahalla", pa ofruar ndonjë klasifikim të mëtejme.

**239** Llogaritet që ka 43 familje rome të Kosovës, me 258 anëtarë, si dhe 187 familje ashkallike me numër të panjohur të anëtarëve; intervista me përfaqësuesin e komunitetit u zhvillua më 13 mars 2019.

**240** Llogaritet që ka 56 familje ashkallike të Kosovës, me 270 anëtarë; intervista me përfaqësuesin e komunitetit u zhvillua më 13 mars 2019.

**241** Llogaritet që ka 12 familje ashkallike të Kosovës, me 45 anëtarë; intervista me përfaqësuesin e komunitetit u zhvillua më 13 mars 2019.

**242** Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e njeriut, Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve, OSBE, UNHCHR e të tjerë.

**243** Ndërtuar më 2003–2004, nga Këshilli Danez për Refugjatë (Danish Refugee Council) si dhe Ndihma Kishtare Norvegjeze (Norwegian Church Aid) për familjet me dokumente pronësore në Mëhallën Rome para luftës.

**244** Ndërtuar ndërmjet viteve 2006 dhe 2008 nga Danish Refugee Council dhe Mercy Corps.

**245** Ndërtuar ndërmjet viteve 2009 dhe 2014 nga Mercy Corps.

**246** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit u zhvillua më 4 korrik 2017.

**247** Informata bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**248** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit u zhvillua më 4 korrik 2017.

**249** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit u zhvillua më 4 korrik 2017.

**250** 219 djem dhe 198 vajza. Intervista me përfaqësuesin e qendrës mësimore është zhvilluar më 28 qershor 2017.

**251** Intervista me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 28 qershor 2017.

**252** Raporti i OSBE-së, shih fusnotën më sipër 8.

**253** Intervista me përfaqësuesin e qendrës për punësim, zhvilluar më 14 mars 2019.

**254** Informata bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**255** Informata bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**256** Intervista me përfaqësuesin e OJQ-së zhvilluar më 28 qershor 2017.

**257** Intervista me qendrën e punësimit dhe qendrën për punë sociale, zhvilluar më 14 mars 2019.

**258** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 6 korrik 2017.

**259** Në 2005, sipas rezultateve të përpunimit të mostrave të dheut, kryer nga OBSH-ja, u bë e qartë që pjesëtarët e komunitetit rom të zhvendosur në kampe në Mitrovicë Veriore dhe Zveçan po vuanin nga një nivel i lartë i kontaminimit me plumb; monitorimi afatgjatë nga ekipet e OSBE-së në terren.

**260** Informata bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**261** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 6 korrik 2017.

**262** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të shëndetësisë u zhvillua më 10 korrik 2017.

**263** Nuk ka ndarje të mëtejme; intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 14 mars 2019.

**264** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 14 mars 2019.

**265** Nuk ka ndarje të mëtejme; Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 6 korrik 2017.











# Komuna e Novobërdës

## Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Sipas regjistrimit të vitit 2011, 6,729 banorë janë regjistruar në komunën e Novobërdës, prej të cilëve janë romë dhe tre janë ashkalinj të Kosovës.<sup>266</sup> Në komunë nuk janë regjistruar egjiptianë. ZKKK-ja ka raportuar që janë 67 banorë romë në komunë, ndërsa përfaqësuesi i romëve thekson se që komuniteti kishte 62 pjesëtarë.<sup>267</sup> Komuniteti rom i Kosovës është i koncentruar në fshatin e përzier etnikisht të Bostanit. Sipas ZKKK-së dhe përfaqësuesit të komunitetit rom, përkundër shifrave të regjistrimit të popullsisë, nuk ka ashkalinj që jetojnë në komunën e Novobërdës.<sup>268</sup>

## Banimi dhe infrastruktura

Më 2009 dhe 2010, Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) ka financuar ndërtimin e 13 shtëpive për familjet rome në fshatin Bostan. Kjo ka përmirësuar në masë të madhe kushtet e jetesës për pjesëtarët e komunitetit, përkundër faktit që shtëpitë nuk kanë izolim termik.<sup>269</sup> Furnizimi i ujit nuk ka qenë stabil deri së

voni.<sup>270</sup> Më 2016, komuna kishte nënshkruar memorandum mirëkuptimi me kompaninë rajonale të ujësjellësit "Hidromorava" për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e sistemeve të ujit në komunën e Novobërdës. Megjithatë, "Hidromorava" nuk ka marrë përgjegjësinë e plotë për ofrim shërbimesh deri në shkurt të vitit 2019, për shkak të borxheve të akumuluar të energjisë elektrike të banorëve.

Më 20 shkurt 2019, një ceremoni zyrtare e nënshkrimit dhe pranimit-dorëzimit u mbajt me kryetarin e komunës së Novobërdës, kryetarët e gjashtë fshatrave të mbuluar, si dhe drejtorit të "Hidromorava". Banorët mirëpritën pranimit-dorëzimin, si dhe shpresojnë të kenë ujë të pijes të përbalueshëm, të disponueshëm për familjet atje.

Komuna së voni ka rindërtuar rrugën kryesore, ka ndërtuar edhe trotualet, si dhe ka instaluar dritat e rrugës në fshatin Bostan, por shumica e rrugëve anësore presin të shtrihen me zhavorr.<sup>271</sup>

## Përfaqësimi në vendimmarrje

Komuniteti rom përfaqësohet me një burrë në Komitet për Komunitete, ndërsa KKS-ja pritet të themelohet në komunën e Novobërdës. Pozitat e Nën-kryetarit të komunës dhe Nën-kryesuesit të Kuvendit Komunal për komunitete janë të obligueshme; megjithatë, komuniteti rom nuk përbën komunitetin më të madh në pakicë numerike në komunë. Asnjë burrë rom i Kosovës nuk është i punësuar në ZKKK.

## Arsimi

Sipas informatave të ofruara nga drejtoria komunale e arsimit, 19 nxënës romë vijnë shkollimin fillor me kurrikulë të Serbisë në shkollën "Miladin Popović" në Bostan. Disa nxënës romë të Kosovës vijnë shkollimin e mesëm në fshatrat Kufcë e Epërme dhe Koretishtë. Pasi që shkollat e mesme që vijohen nga romët e Kosovës gjenden rreth 20 km larg nga vendbanimi i romëve në fshatin Bostan, të gjithë nxënësit romë gëzojnë transportin e ofruar nga shkollat me kurrikulë të Serbisë.<sup>272</sup>

Që prej prillit 2017, qendra mësimore, përkrahur nga OJQ-ja VoRAE, ka filluar të funksionojë në lokalet e shkollës "Miladin Popović" në fshatin Bostan. Qendra mësimore ofron orë plotësuese si dhe vijohet nga afro 14 fëmijë romë.<sup>273</sup> Qendra mësimore gjithashtu punëson dy mentorë romë.<sup>274</sup> Që prej tetorit 2018, drejtorja e arsimit ka lejuar shfrytëzimin e lokaleve të kopshtit parashkollor për aktivitete jashtë-shkollore. Qendra mësimore më parë ishte përbërur me vështirësi në mbajtjen e aktiviteteve jashtë-shkollore me nxënës romë për shkak të mungesës së hapësirave adekuate.

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Novobërdës nuk ka përmbytur normën e përgjithshme minimale për përfaqësim të komuniteteve në shërbimin civil; megjithatë, ka arritur kuotën individuale për komunitetin rom.<sup>275</sup> Gjashtë pjesëtarë të komunitetit rom janë të punësuar në sektorin publik: një pastruese, një pastrues, një rojë sigurimi, një polic, e përveç këtyre, një grua dhe një burrë nga OJQ-ja VoRAE.<sup>276</sup>

Qasja në punësim në sektorin privat mbetet sfiduese; disa pjesëtarë të komunitetit rom angazhohen në veprimtari joformale, duke përfshirë punën fizike sezonale si dhe - në masë më të vogël - mbledhjen e metalit / plastikës nga mbeturinat.<sup>277</sup> Sipas zyrës komunale të punësimit, tetë individë romë (pesë burra dhe tri gra) janë regjistruar si punëkërkues aktivë, ndërsa sipas qendrës për punë sociale, 11 pjesëtarë romë marrin ndihma sociale.<sup>278</sup>



## ■ Shëndetësia

Pjesëtarët e komunitetit rom nga komuna shfrytëzojnë shërbimet e mjekësisë familjare nga të dyja sistemet në Novobërdë; por, për ndërhyrje më të mëdha mjekësore, banorët duhet të udhëtojnë deri në spital-et e mbajtura nga Serbia në Graçanicë, si dhe në fshatin Pasjan në komunën e Parteshit. Përveç këtyre, mungesa e shërbimeve adekuate shëndetësore për gratë në komunë ndikon tek gratë e të gjitha komuniteteve në komunën e Novobërdës.<sup>279</sup>

## ■ Kthimi dhe riatdhesimi

ZKKK-ja nuk ka regjistruar raste të zhvendosjes së romëve të Kosovës nga komuna që pas vitit 1999. Ndërmjet 1 janarit 2016 dhe 31 dhjetorit 2018, një grua rome është riatdhesuar në komunë, ndërsa nuk ka pasur kthim vullnetar.<sup>280</sup>

---

**266** Agjencia Statistikore e Kosovës, shih më sipër, fusnota 2.

**267** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së dhe përfaqësuesin e romëve, zhvilluar më 11 mars 2019.

**268** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së është zhvilluar më 10 korrik 2017, intervista me përfaqësuesin e romëve më 28 korrik 2017.

**269** Intervista me përfaqësuesin e komunitetit rom, zhvilluar më 25 korrik 2017.

**270** Informata bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**271** Informata bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**272** Intervista me përfaqësuesin e komunitetit rom, zhvilluar më 25 korrik 2017.

**273** Tetë vajza dhe gjashtë djem.

**274** Një grua dhe një burrë.

**275** Raporti i OSBE-së, shih fusnotën më sipër 8.

**276** Intervista me ZKKK, zhvilluar më 10 korrik 2017.


**277** Intervista me përfaqësuesin e komunitetit rom, zhvilluar më 25 korrik 2017.

**278** Intervista me përfaqësuesin e qendrës së punësimit zhvilluar më 11 mars 2019.

**279** Intervistë me përfaqësuesin e Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë më 26 korrik 2017.

**280** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 11 mars 2019.











# Komuna e Obiliqit

## Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 ka zbuluar që nga 21,549 banorë të regjistruar në komunë, 661 janë romë të Kosovës, 578 janë ashkalinj të Kosovës dhe 27 janë egjiptianë.<sup>281</sup> Sipas ZKKK-së, rreth 1,100 romë, 550 ashkalinj dhe 25 egjiptianë jetonin në komunë në dhjetor të vitit 2018.<sup>282</sup> Luhatjet në shifra mund të jenë për shkak të rritjes së numrit të personave të riatdhesuar dhe të kthyerve që arrijnë në komunë.<sup>283</sup>

Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë kryesisht të përqendruar rreth fshatit Plemetin, ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë në komunë, në fshatrat Carravodicë dhe Milloshevë, si dhe lagjet "Azotiku" dhe "Elektrobartja" në qytetin e Obiliqit.<sup>284</sup>

## Banimi dhe infrastruktura

Shumica e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian jetojnë në zonën e Plemetinit, në dy objekte të banimit so-

cial, si dhe një lokacion kthimi, me shtëpi të ndërtuara si pjesë e Projektit të Kthimit dhe Riintegritimit - Kosovë (RRK), fazave I, II, III, IV dhe V. Komuna, me përkrahjen e USAID-it, ka shtruar me zhavorr rrugët në Plemetin. Pjesëtarët e tre komuniteteve që jetojnë në pjesët tjera të komunës kryesisht jetojnë në shtëpi solide pa ndonjë problem madhor infrastrukturor.

Objektet e banimit social vuajnë nga një numër problemesh infrastrukturorë, duke përfshirë ato me ujësjellës dhe energji elektrike, por edhe me rrjetin e kanalizimit. Gjendja e dobët e njëres prej ndërtesave të banimit social ishte përkeqësuar edhe më shumë në shtatorin e vitit 2017, kur erërat e forta kishin dëmtuar edhe më shumë kulmin edhe ashtu të brishtë, i cili pjesërisht ishte shkatërruar në dy raste zjarri në të kaluarën. Në dhjetorin e vitit 2017, si dhe janar 2018, kulmi i ndërtesës së banimit social ishte rindërtuar me kontributet e OSBE-së, Ambasadës së Luksemburgut, Caritas Luxembourg, si dhe komunës së Obiliqit, pas një konference donatorësh të organizuar nga OSBE-ja në tetor të vitit 2017. Përkundër rindërtimit, problemet me ujësjellës, kanalizime dhe energji elektrike mbesin.

## Përfaqësimi në vendimmarrje

Të tre komunitetet janë të përfaqësuar në mekanizmat komunalë për mbrojtjen e komuniteteve. Një burrë ashkali dhe një tjetër egjiptian janë anëtarë të Komitetit për Komunitete, që kryesohet nga një burrë rom. Dy burra romë janë pjesëtarë të KKS-së. Asnjë prej tre komuniteteve nuk përfaqësohet në Kuvendin e Komunës. Një burrë rom është i punësuar në ZKKK. Pozitat e NKK-së dhe ZKKK-së nuk janë të detyrueshme pasi që komunitetet në pakicë numerike përbëjnë më pak se dhjetë për qind të gjithë popullatës në komunë. Komuna ka krijuar pozitën e NKK-së me vullnetin e mirë të udhëheqësisë komunale; megjithatë, pozita nuk mbahet nga komuniteti rom i Kosovës.<sup>285</sup>

## Arsimi

Sipas informatave të ofruara nga drejtorja komunale e arsimit, 161 nxënës ashkalinj vijnë shkollat me kurrikulë të Kosovës "Ibrahim Rugova", "Ismajl Dumoshi" dhe "Pandeli Sotiri", shkolla fillore dhe të

mesme të ulëta në qytetin e Obiliqit, si dhe zonën e Plemetinit, si dhe shkollat fillore dhe të mesme të ulëta "Fazli Grajqevci" dhe "Hasan Prishtina" në Milloshevë. Përveç këtyre, 163 nxënës romë vijnë shkollën fillore dhe të mesme me kurrikulë të Serbisë, "Sveti Sava" në Plemetin, si dhe shkollën fillore dhe të mesme "Dositej Obradović" në Carrovodice. Rreth 15 nxënës romë po ashtu vijnë shkollën fillore dhe të mesme "Branko Radičević" në qytetin e Obiliqit.<sup>286</sup> Asnjë mësues nga tre komunitetet nuk japin mësim në komunë, si dhe nuk ofrohen orë të gjuhës dhe kulturës rome.

OJQ-ja "Balkan Sunflowers" mban dy qendra mësimore në Plemetin, të cilat ofrojnë aktivitete arsimore në gjuhën shqipe dhe serbe. Komuna ofron hapësirat pa pagesë, por edhe ofron drutë e zjarrit për ngrohje në stinën e dimrit për këto qendra mësimore.<sup>287</sup> Rreth 100 fëmijë vijnë qendrën mësimore në gjuhën shqipe,<sup>288</sup> ndërsa qendra mësimore në gjuhën serbe vijohet nga afro 120 fëmijë romë.<sup>289</sup> Orët formale të arsimit për të rritur ofrohen në shkollën fillore dhe mesme të ulët "Ibrahim Rugova", si dhe vijohen nga pjesëtarët e komunitetit ashkali.<sup>290</sup>

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Obiliqit ka përmbushur prapë prapë përgjithshëm minimal për të gjitha komunitetet; megjithatë, kuotat minimale për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian nuk janë arritur.<sup>291</sup> Tre banorë romë janë të punësuar në sektorin publik - një burrë në ZKKK, ndërsa dy gra punojnë si pastreuese.



Burra e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian angazhohen në aktivitete joformale ekonomike, si mbledhja e metaleve, prerja e druve dhe grumbullimi i mbe-turinave. Gratë nuk angazhohen as në aktivitete formale e as joformale ekono-mike të punësimit. Që prej korrikut 2017, shtatë romë dhe katër ashkalinj të Kosovës janë punësuar në riciklim metalesh, mu-ratim dhe deponim të mallrave përmes programeve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe UNDP-së. Në to-tal, 130 romë<sup>292</sup> si dhe 62 ashkalinj<sup>293</sup> janë të regjistruar si punëkërkues në zyrën komunale të punësimit. Në të kaluarën, tre burra romë kanë përfituar nga projek-te të ndryshme për krijimin e të ardhurave të implementuara nga UNDP dhe GIZ. Fëmijët nga tre komunitetet ndihmojnë familjet e tyre në grumbullim mbeturinash apo kërkim lëmoshe në rrugët e komunës së Prishtinës. Derisa nuk ka shifra të përl-logaritjeve të fëmijëve të angazhuar në aktivitete të tilla, ka më shumë djem të përfshirë sesa vajza. Shumica e fëmijëve në fjalë vijnë nga objektet e banimit so-cial në fshatin Plemetin.<sup>294</sup> Përfundimisht, sipas zyrës komunale të punësimit, 165 romë, 80 ashkalinj dhe tre egjiptianë janë të regjistruar si punëkërkues aktivë, ndërsa qendra për punë sociale raporton se 193 familje rome, 63 familje ashkallike, si dhe pesë familje egjiptiane marrin asistencë sociale<sup>295</sup>.

## ■ Shëndetësia

Të tre komunitetet kanë qasje në insti-tucione shëndetësore, ndërsa të dy gjinitë janë përfituese të barabarta. Institucio-net mjekësore gjenden në distanca të qasshme nga zonat e banuara nga ko-munitetet rom, ashkali dhe egjiptian të

Kosovës. Komuna ofron ndihmë falas për shëndetin reproduktiv për gratë nga të tre komunitetet.<sup>296</sup>

## ■ Kthimi dhe riatdhesimi

Ndërmjet 1 janarit 2016 dhe 31 dhjetorit 2018, nuk ka pasur në dispozicion të dhë-na për riatdhesimin në këtë komunë, edhe pse afro 90 ekonomi familjare me afro 500 individë janë riatdhesuar në komunë mes viteve 2014 dhe 2017.<sup>297</sup> Ndërsa, ndërmjet 1 janarit 2016 dhe 31 dhjetorit 2018, 98 familje rome, 41 familje ashka-like dhe pesë familje egjiptiane të Kosovës janë kthyer vullnetarisht në komunë.<sup>298</sup>

**281** Agjencia Statistikore e Kosovës, shih më sipër, fusnota 2.

**282** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 12 mars 2019.

**283** Informata bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**284** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 21 korrik 2017.

**285** Nënkryetari është serb i Kosovës.

**286** Informata bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**287** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit u zhvillua më 24 korrik 2017.

**288** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit u zhvillua më 24 korrik 2017.

**289** Intervista me përfaqësuesin e qendrës mësimore zhvilluar më 24 korrik 2017.

**290** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit u zhvillua më 24 korrik 2017.

**291** Raporti i OSBE-së, shih fusnotën më sipër 8.

**292** 104 burra dhe 26 gra.

**293** 54 burra dhe 140 gra.

**294** Intervista me përfaqësuesin e OJQ-së zhvilluar më 24 korrik 2017.

**295** Nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë apo komunitetit, si dhe nuk ka informata mbi anëtarët e familjeve. Intervistat me qendrën e punësimit dhe qendrën për punë sociale janë zhvilluar më 11 mars, respektivisht 13 mars 2019.

**296** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të shëndetësisë u zhvillua më 25 korrik

2017.

**297** Nuk ka ndarje në gjini apo komunitete. Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 12 mars 2019.

**298** Nuk ka numra të individëve, apo ndarje të të dhënave në gjini. Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 12 mars 2019.







# Komuna e Pejës

## Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 ka zbuluar që nga 96,450 banorë të regjistruar në komunën e Pejës, 993 janë romë të Kosovës, 143 janë ashkalinj të Kosovës dhe 2.700 janë egjiptianë.<sup>299</sup> Sipas ZK-KK-së, numri i pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në komunë nuk ka ndryshuar në masë të konsiderueshme që prej regjistrimit, si dhe mbetet, nga qershori i vitit 2017, me afro 1,300 romë, 200 ashkalinj dhe 3,000 egjiptianë.<sup>300</sup> Nuk ka pasur shifra të përditësuar në dispozicion në kohën e publikimit. Pjesëtarët e tre komuniteteve banojnë në lagjet urbane “7 Shtatori”, “Dardania 3” dhe “Kristali / Kristal” të qytetit të Pejës, si dhe në fshatrat Brestovik, Çallapek, Fira-jë, Gllogjan, Katundi i Ri, Kliçinë, Lubeniq, Nakëll, Orasje, Poçestë, Qungur, Raushiq, Rosujë, Ruhot, Treboviq, Vitomiricë, Zahaq si dhe Zllapek.

## Banimi dhe infrastruktura

Pjesa më e madhe e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian jetojnë në shtëpi solide. Edhe pse shtëpitë janë të vjetra, gjendja e shumicës së shtëpive dhe infrastrukturës është e mirë. Shumica e rrugëve janë të asfaltuara dhe qasja në energji elektrike e ujësjellës është përgjithësisht e mirë. Derisa një pjesë e sistemit të kanalizimeve është ndërtuar, ndërsa mbeturinat grumbullohen një herë në javë, mbesin problemet me ndriçimin publik. Përveç këtyre, pjesëtarët e tre komuniteteve nganjëherë nuk arrijnë të paguajnë faturat e shërbimeve publike, e kështu shkyçen nga shërbimet e filla.<sup>301</sup> Për të trajtuar këto çështje, komuna ka filluar ndërtimin e sistemit të kanalizimit në lagjen “7 Shtatori”, duke asfaltuar rrugët në shumicën e zonave dhe duke instaluar ndriçimin publik.

## Përfaqësimi në vendimarrje

Të tre komunitetet janë të përfaqësuar në mekanizmat lokalë për mbrojtjen dhe

pjesëmarrjen e komuniteteve. Një grua rome dhe një burrë ashkali përfaqësojnë komunitetet e tyre në Komitetin për Komunitete, që kryesohet nga një burrë egjiptian. Komiteti rom dhe ai egjiptian përfaqësohen me nga një anëtar në KKSB. Të njëjtit, burri rom dhe burri egjiptian, punojnë në ZKKK. Nuk ka përfaqësues nga tre komunitetet në Kuvend; ndërmjet viteve 2013 dhe 2017, një egjiptian ishte këshilltar i Kuvendit Komunal. Pozitat e NKK-së dhe ZKKK-së nuk janë të detyrueshme pasi që komunitetet në pakicë numerike përbëjnë më pak se dhjetë për qind të gjithë popullatës në komunë.

## Arsimi

Fëmijët nga të tre komunitetet janë të regjistruar në sistemin arsimor të Kosovës. Sipas drejtorisë komunale të arsimit, janë 240 nxënës romë, katër nxënës ashkalinj, si dhe nëntë nxënës egjiptianë që vijnë shkollat fillore dhe të mesme të ulëta “Xhemajl Kada” dhe “Dardania”. Përveç kësaj, 83 nxënës romë, 34 nxënës ashkalinj dhe 143 nxënës egjiptianë vijnë shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në fshatrat Ba-

ran, Brestovik, Çallapek, Gllogjan, Kliçinë, Loxhë, Lubeniq, Nabërgjan, Novosellë, Orasje, Poçestë, Qyshk, Raushiq, Ruhot, Treboviq, Trestenik, Vitomiricë, Zahaq dhe Zllapek, disa prej të cilave ndiqen edhe nga nxënës të Katundit të Ri, Qungurit, Nakëllit dhe Rosujës. Sfidat kryesore të lidhura me arsimin që përballohen nga romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët në komunën e Pejës janë shkalla e lartë e braktisjes së shkollave, si dhe mungesat apo mos-vijimi. Sipas përfaqësuesve të komuniteteve, kjo ndodh kryesisht për shkak të gjendjes së dobët ekonomike të të tre komuniteteve.<sup>302</sup> Në komunë nuk ofrohen orë mësimi për gjuhën dhe kulturën rome. Nuk ka përfaqësues të tri komuniteteve që japin mësim në shkollat e komunës.<sup>303</sup> Nuk ka as qendra mësimore që funksionojnë në komunë.<sup>304</sup>

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Podujevës nuk e ka përmbushur as pragun minimal për përfaqësimin e përgjithshëm të komuniteteve e as kuotën e veçantë për përfaqësimin e komuniteteve individuale në shërbimin civil komunal.<sup>305</sup> Nuk ka të dhëna të disponueshme për numrin e personave nga tre komunitetet që janë të punësuar në shërbimin civil apo sektorin publik. Sipas zyrës komunale të punësimit, 174 romë (100 burra, 74 gra), 75 ashkalinj (40 burra, 35 gra), si dhe 233 tre egjiptianë (135 burra, 98 gra) janë të regjistruar si punëkërkuar aktivë, ndërsa qendra për punë sociale raporton se 124 familje rome me 611 anëtarë, 18 familje ashkallike me 73 anëtarë, si dhe 131 familje egjiptiane me 631 anëtarë të familjes marrin asistencë sociale.<sup>306</sup> Pjesëtarët e tre komuniteteve kryesisht



angazhohen në punë sezonale, si artizanatet (kryesisht punime metali), bujqësi (ndihmojnë pronarët e tokave), pastrim apo punë ndërtimore.<sup>307</sup> Sipas OJQ-ve dhe përfaqësuesve të komunitetit, puna e fëmijëve ekziston në komunë, ndërsa fëmijët kryesisht përfshihen në kërkim lëmoshe dhe grumbullim kanaqesh. Edhe pse nuk ka të dhëna të sakta për numrin dhe gjininë e fëmijëve, sipas përfaqësuesve të OJQ-ve, numri i përafërt i fëmijëve shkon përtej 100. Vajzat duken që angazhohen më shumë në kërkim lëmoshe, ndërsa djemtë angazhohen më shumë në grumbullim kanaqesh.<sup>308</sup>

## ■ Shëndetësia

Sipas përfaqësuesve të komuniteteve, pasi që fshatrat Firajë dhe Orasje gjenden 10–12 kilometra larg nga qyteti i Pejës, banorët e tyre përballen me vështirësi në sigurimin e trajtimit shëndetësor, për shkak të largësisë së madhe nga institucionet shëndetësore.<sup>309</sup> Përveç kësaj, banorët e lagjes “Qungur” kanë vështirësi me ofrimin e trajtimeve mjekësore, pasi që qendra e tyre shëndetësore nuk është funksionale për shkak të mungesës së personelit mjekësor.<sup>310</sup> Megjithatë, sipas drejtorisë komunale të shëndetësisë, distanca fizike nuk është problem madhor sa i përket qasjes në shërbime shëndetësore, pasi që 23 qendra shëndetësore janë në dispozicion, përveç ekipeve mobile mjekësore që rregullisht vizitojnë fshatrat në zonat e largëta. Për më tepër, qendra mjekësore afër “Qungurit” nuk është funksionale, ndërsa banorët detyrohen të shkojnë deri në Pejë për kontrollet e tyre shëndetësore. Komuna ofron vizita falas dhe kontrareceptivë për gratë nga të tre komunitetet.<sup>311</sup>

## ■ Kthimi dhe riatdhesimi

Ndërmjet 1 janarit 2016 dhe 31 dhjetorit 2018, 148 pjesëtarë të komunitetit rom, tetë pjesëtarë të komunitetit ashkali, si dhe 52 egjiptianë janë riatdhesuar në komunë.<sup>312</sup> Gjatë të njëjtës periudhë, tre familje rome dhe shtatë familje egjiptiane, bashkë me një individ rom dhe tetë egjiptianë, janë kthyer vullnetarisht nga vendet e zhvendosjes së mëhershme.<sup>313</sup>

**299** Agjencia Statistike e Kosovës, shih më sipër, fusnota 2

**300** Intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 28 qershor 2017.

**301** Dy intervista me përfaqësues të komuniteteve, zhvilluar më 6 dhe 10 korrik 2017.

**302** Dy intervista me përfaqësues të komuniteteve, zhvilluar më 6 dhe 10 korrik 2017.

**303** Po aty.

**304** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit u zhvillua më 11 korrik 2017.

**305** Raporti i OSBE-së, shih fusnotën më sipër 8.

**306** Të dhënat e zberthyera në gjini nuk janë të disponueshme. Intervista me qendrën e punësimit është mbajtur më 12 mars, ndërsa ajo me qendrën për punë sociale më 13 mars 2019.

**307** Intervista me dy përfaqësues të komunitetit mbajtur më 6 korrik 2017, respektivisht më 10 korrik 2017.

**308** Intervista me përfaqësues të dy OJQ-ve (“Iniciativa për Paqe dhe Unitet” si dhe “Shoqata për Romë të Kosovës”) më 10 korrik 2017, përfaqësues të dy komuniteteve, më 6 korrik 2017, respektivisht 10 korrik 2017.

**309** Intervista me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 6 korrik 2017.

**310** Informata bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**311** Intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të shëndetësisë u zhvillua më 30 korrik 2017.

**312** Nuk ka ndarje të mëtejme në gjini; intervista me ZKKK-në zhvilluar më 14 mars 2019.

**313** Nuk ka ndarje të mëtejme; intervista me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 14 mars 2019.









# Komuna e Podujevës

## Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, 88,499 banorë janë të regjistruar në komunën e Podujevës, nga të cilët 74 janë romë të Kosovës, 680 janë ashkalinj të Kosovës dhe dy egjiptianë.<sup>314</sup> Që nga dhjetori 2018, sipas përlogaritjeve të përfaqësuesve të komuniteteve, ka rreth 1,121 ashkalinj dhe 53 banorë romë të Kosovës, si dhe 12 egjiptianë të regjistruar në komunë.<sup>315</sup> Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës banojnë në lagjet urbane “Xhafer Meta”<sup>316</sup> dhe “Ali Ajeti”<sup>317</sup> të qytetit të Podujevës. Pjesëtarët tjerë të komuniteteve jetojnë në fshatrat Batllavë, Orllan, Peranë si dhe Sveqël.<sup>318</sup>

## Banimi dhe infrastruktura

Lagjet “Xhafer Meta” dhe “Ali Ajeti” gjenden në afërsi të qendrës së qytetit të Podujevës. Shtëpitë solide janë të një standardi të pranueshëm dhe nuk raportohen probleme infrastrukturore në zonat ku banojnë pjesëtarët e të dy komuniteteve. Nuk

raportohen vështirësi as tek qasja në ujësjellës, energji elektrike, kanalizime apo ndriçim publik.<sup>319</sup>

## Përfaqësimi në vendimarrje

Komuniteti ashkali dhe komuniteti rom i Kosovës janë të përfaqësuar në mekanizmat lokalë për mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e komuniteteve. Dy gra ashkallike dhe një burrë rom mbajnë ulëse në Komitetin për Komunitete, që kryesohet nga një grua ashkallike, ndërsa të dy komunitetet përfaqësohen me nga një burrë në KKSB. Asnjë pjesëtar nga dy komunitetet nuk ka ulëse në Kuvend të Komunës, e as punon në ZKKK. Pozitat e NKK-së dhe ZKKKK-së nuk janë të detyrueshme pasi që komunitetet në pakicë numerike përbëjnë më pak se dhjetë për qind të gjithë popullatës në komunë.

## Arsimi

Fëmijët nga komuniteti ashkali dhe komuniteti romë i Kosovës janë të regjistruar në sistemin arsimor të Kosovës. Sipas drejtorisë komunale të arsimit, dhjetë nxënës romë, 124 nxënës ashkalinj janë të regjistruar në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta “Naim Frashëri”, “Enver Maloku”, “Shaban Shala” dhe “Ibrahim Rugova” në Podujevë, si dhe 16 nxënës ashkalinj të tjerë vijnë në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta “Ali Ajeti” në fshatin Sfeqël, “Luigj Gurakuqi” në fshatin Batllavë dhe “Zahir Pajaziti” në fshatin Orllan.<sup>320</sup>

Asnjë mësimmhënës nga komuniteti rom apo ashkali nuk është i punësuar në shkollat e komunës, si dhe nuk ofrohen orë për gjuhën dhe kulturën rome. Në komunë veprojnë dy qendra mësimore, njëra në shkollën fillore dhe të mesme të ulët “Ibrahim Rugova”<sup>321</sup> si dhe tjetra në lagjen urbane “Ali Ajeti”.<sup>322</sup>

Të dyja qendrat drejtohen nga OJQ lokale “Qëndrimi” me mjete financiare që jepen nga OJQ VoRAE. Komuna mbështet qendrat e mësimmhënies duke i siguruar një

klasë mësimi në shkollën “Ibrahim Rugova”. Orët formale të mësimi për të rriturit janë në dispozicion në shkollat e mesme “Aleksandër Xhuvani”, “Fan S Noli” dhe “Isa Boletini.” Këto orë mësimi vijohen nga pjesëtarët e komunitetit romë dhe ashkali të Kosovës.<sup>323</sup>

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Podujevës nuk e ka përmbushur as pragun minimal për përfaqësimin e përgjithshëm të komuniteteve e as kuotën e veçantë për përfaqësimin e komunitetit në shërbimin civil komunal.<sup>324</sup> Gjithsej 23 pjesëtarë romë dhe ashkali të Kosovës janë të punësuar në sektorin publik, përfshirë pesë në Forcën e Sigurisë të Kosovës, katër si mësimmhënës, një në Policinë e Kosovës, dy në qendrat e mësimmhënies si personel teknik, një si zjarrfikës, një si motër në qendrën kryesore të mjekësisë familjare, pesë në kompaninë e shërbimeve publike, një si pastrues në ndërtesën e komunës dhe një në kompaninë publike të transportit “Kosovatrans”.<sup>325</sup>

Sipas zyrës komunale të punësimit, 82 ashkali të Kosovës dhe dy romë të Kosovës, banorë, janë të regjistruar si punëkërkuar aktivë, ndërsa qendra për punë sociale raporton se 66 familje ashkali të Kosovës me 426 anëtarë dhe dy familje rome me 15 anëtarë marrin asistencë sociale.<sup>326</sup> Sipas një përfaqësuesi të OJQ-së, puna e fëmijëve nuk ekziston në komunë.<sup>327</sup>



## ■ Shëndetësia

Pjesëtarët e komunitetit romë dhe komunitetit ashkali të Kosovës nuk ballafaqohen me pengesa për t'ju qasur shërbimeve shëndetësore e që ofrohen në qendrën kryesore të mjekësisë familje dhe në spitalin e qytetit. Përballimi financiar i barnave nganjëherë paraqet problem për ekonominë familjare të cënueshme të komunitetit romë dhe komunitetit ashkali të Kosovës. Ndihma rreth shëndetit reproduktiv është në dispozicion në komunë.<sup>328</sup>

## ■ Kthimi dhe riatdhesimi

20 (12 burra, tetë gra) pjesëtarë të komuniteti ashkali të Kosovës u riatdhesuan mes datës 1 janar 2016 dhe 31 dhjetor 2019.<sup>329</sup> Gjatë periudhës së njëjtë, asnjë pjesëtarë nga të tria komunitetit nuk u kthye në komunë.<sup>330</sup>

**314** Agjencia Statistikore e Kosovës, shih më sipër, fusnota 2.

**315** Intervista me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 12 mars 2019.

**316** Rreth 200 ashkalinj; nuk ka të dhëna të kategorizuara sipas gjinisë në dispozicion.

**317** Rreth 600 ashkalinj; nuk ka të dhëna të kategorizuara sipas gjinisë në dispozicion.

**318** Intervistat me dy përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 12 mars 2019.

**319** Intervista me dy përfaqësues të komunitetit janë zhvilluar më 5 korrik 2017.

**320** Zbërthimi në kategori gjinore e komunitare nuk është në dispozicion; intervista me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit u zhvillua më 18 korrik 2017; shifrat janë ofruar nga ekipet e OSBE-së në terren.

**321** Vijohen nga afro 30 fëmijë. Zbërthimi në kategori gjinore e komunitare nuk është në dispozicion; intervista me përfaqësuesin e qendrës mësimore më 5 korrik 2017.

**322** Vijohen nga afro 50–60 nxënës. Zbërthimi në kategori gjinore e komunitare nuk është në

dispozicion; intervista me përfaqësuesin e qendrës mësimore më 5 korrik 2017.

**323** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit u zhvillua më 18 korrik 2017.

**324** Raporti i OSBE-së, shih fusnotën më sipër 8.

**325** Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë dhe gjinisë nuk janë në dispozicion; intervistë me përfaqësuesin e qendrës së punësimit u zhvillua më 12 mars 2019.

**326** Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë nuk janë në dispozicion. Intervistë me qendrën për punë sociale, zhvilluar më 12 mars 2019.

**327** Intervistë me përfaqësuesin e OJQ “Qëndrimi”, zhvilluar më 5 korrik 2017.

**328** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të shëndetësisë u zhvillua më 18 korrik 2017.

**329** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 12 mars 2019.

**330** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 12 mars 2019.







# Komuna e

# Prishtinës

## Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, nga 198,897 banorë të regjistruar në komunën e Prishtinës, 56 janë romë të Kosovës, 557 janë ashkali të Kosovës dhe tetë janë egjiptianë.<sup>331</sup> Që nga dhjetori i vitit 2018, vlerësimi i ZKKK tregon se shtatë familje romë,<sup>332</sup> 283 ashkali të Kosovës<sup>333</sup> dhe pesë egjiptianë,<sup>334</sup> ndërsa përfaqësuesit e komunitetit vlerësojnë se 23 romë të Kosovës (12 burra, 11 gra), 315 ashkali të Kosovës (240 burra, 75 gra)<sup>335</sup> dhe asnjë egjiptianë i Kosovës jetojnë në komunë.<sup>336</sup> Shumica e romëve të Kosovës dhe ashkalive të Kosovës jetojnë në zonat urbane të komunës së Prishtinës. Pjesëtarët e komuniteti ashkali të Kosovës jetojnë në lagjen “Kodra e Trimave” dhe përreth stacionit të trenit.<sup>337</sup> Disa pjesëtarë të komunitetit gjithashtu jetojnë në zonën rreth Qendrës Klinike Universitare të Kosovës në komunën e Prishtinës, si dhe në fshatrat Besi dhe Kolovicë. Pjesëtarët e komuniteti romë të Kosovës kryesisht jetojnë në zonën “Moravska” të komunës së Prishtinës.<sup>338</sup>

## Banimi dhe infrastruktura

Shumica e pjesëtarëve të komuniteti ashkali dhe komunitetit romë të Kosovës jetojnë në shtëpitë e tyre të përhershme që janë të lidhura me kanalizim dhe energji elektrike, me qasje në ndriçim rruge dhe rrugë të asfaltuara. Sidoqoftë, shumica e shtëpive janë të vjetra dhe shpesh ka rrjedhje nga kulmi apo u mungon hyrja e duhur apo fasada dhe ato duhet riparuar apo rinovuar menjëherë. Që nga marsi i vitit 2019, një familje romë e Kosovës nuk ka zgjidhje banimi dhe rasti është në pritje të përgjigjes nga komuna.<sup>339</sup>

## Përfaqësimi në vendimmarrje

Të dyja komunitetet janë të përfaqësuara nga një burrë në KK si dhe KKSBB. Asnjë pjesëtarë i komunitetit ashkali dhe i komunitetit romë të Kosovës nuk është i punësuar në ZKKK si dhe nuk janë të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Pozitat e NKK-së dhe ZKKKK-së nuk janë të detyrueshme pasi që komunitetet në pakicë numerike përbëjnë më pak se dhjetë për qind të

gjithë popullatës në komunë.

## Arsimi

Fëmijët nga komuniteti ashkali dhe komuniteti romë i Kosovës janë të regjistruar në sistemin arsimor të Kosovës. Sipas informacionit që është dhënë nga drejtorja komunale e arsimit, katër romë të Kosovës dhe 78 ashkali të Kosovës janë të regjistruar si nxënës në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta “Asim Vokshi”, “Emin Duraku”, “Gjegj Fishta”, “Model”, “Nexhmi Mustafa” dhe “Pjeter Bogdani”. Të gjitha shkollat janë brenda një largësie të qasshme nga zonat ku jetojnë nxënësit. Asnjë mësimdhënës nga të dyja komunitetet nuk është i punësuar në këto shkolla. Asnjë orë mësimi për gjuhën dhe kulturën romë nuk mbahet nga ana e komunës. Arsimi zyrtar për të rriturit sigurohet në shkollën fillore dhe të mesme të ulët “Emin Duraku”; megjithatë, ai nuk vijohet nga pjesëtarët e të dy komuniteteve.<sup>340</sup>

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Prishtinës nuk e ka përmbushur as pragun minimal për përfaqësimin e përgjithshëm të komuniteteve e as kuotën e veçantë për përfaqësimin e komunitetit në shërbimin civil komunal.<sup>341</sup> Që nga korriku i vitit 2017, katër burra ashkali të Kosovës u punësuan në sektorin privat,<sup>342</sup> një burrë ashkali i Kosovës punon për komunën dhe tetë gra ashkali të Kosovës kanë punuar në kuzhinat komunale që ofrojnë ushqim për institucionet publike.<sup>343</sup> Të dhënat e përditësuara nuk ishin në dispozicion. Gjithsej katër burra ashkali të Kosovës janë të regjistruar si punëkërkuar aktivë,<sup>344</sup> kurse qendra për punë sociale raporton se katër romë (dy burra, dy gra), 229 ashkali të Kosovës (103 burra, 126 gra) dhe pesë egjiptianë (tre burra, dy gra) pranojnë asistencë sociale nga komunitetet.<sup>345</sup>

Pjesëtarët e komunitetit romë dhe komuniteti ashkali të Kosovës janë kryesisht të angazhuar në veprimtaritë e ekonomisë informale. Burrat janë të përfshirë në mbledhjen dhe riciklimin e mbeturinave të metaleve, ndërsa gratë qëndrojnë në shtëpi.<sup>346</sup> Fëmijët nga të dyja komunitetit - djemët më shumë se vajzat janë të përfshirë në kërkim të lëmshës.<sup>347</sup> Komuna ka katër projekte për krijimin e të ardhurave që administrohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe nga GIZ, të cilat sigurojnë mundësi punësimi në periudha afatshkurta. Nuk ka ndonjë përfitues nga të dyja komunitetet.<sup>348</sup>



## ■ Shëndetësia

Burrat dhe gratë nga të dyja komunitetet kanë qasje në objektet e kujdesit shëndetësor që gjenden në afërsi të zonave ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve. Komuna ofron falas ndihmë për shëndetin reproduktiv për të gjithë banorët e komunës.<sup>349</sup>

## ■ Kthimi dhe riatdhesimi

Mes datës 1 janar 2016 dhe 31 dhjetor 2018, 19 familje ashkali të Kosovës e veç kësaj, dhjetë burra dhe pesë grave,<sup>350</sup> dhe dy familje rome e veç kësaj nëntë burra dhe pesë gra,<sup>351</sup> u riatdhesuan në komunë.<sup>352</sup> Gjatë periudhës së njëjtë, nuk u raportua për kthim në komunë.<sup>353</sup>

**331** Agjencia Statistikore e Kosovës, shih më sipër, fusnota 2.

**332** Nuk ka zberthim të dhënave sipas gjinisë apo shifra individuale.

**333** 143 burra dhe 140 gra.

**334** Tre burra dhe dy gra. Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 8 mars 2019.

**335** Sipas intervistës që u zhvillua më 9 mars 2019.

**336** Intervistë me dy përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 8 mars 2019.

**337** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 19 korrik 2017.

**338** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 18 korrik 2017.

**339** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 18 korrik 2017.

**340** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit, zhvilluar më 24 korrik 2017.

**341** Raporti i OSBE-së, shih fusnotën më sipër 8.

**342** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës rajonale për punësimi, zhvilluar më 12 korrik 2017.

**343** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 12 korrik 2017.

**344** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punësim, zhvilluar më 11 mars 2019.

**345** Intervistë me qendrën për punë sociale, zhvilluar më 9 mars 2019.

**346** Intervistë me dy përfaqësues të komunitetit,

zhvilluar më 18 dhe 19 korrik 2017.

**347** Vlerësohet se janë gjashtë djem dhe katër vajza ashkali të Kosovës si dhe disa fëmijë romë të Kosovës. Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 19 korrik 2017, si dhe me përfaqësuesin e OJQ, zhvilluar më 10 korrik 2017.

**348** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës rajonale për punësimi, zhvilluar më 12 korrik 2017.

**349** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të shëndetësisë, zhvilluar më 14 korrik 2017.

**350** Nuk ka të dhëna të zberthyera sipas gjinisë për familjet.

**351** Nuk ka të dhëna të zberthyera sipas gjinisë për familjet.

**352** Intervistë me ZKKK, zhvilluar më 8 mars 2019.

**353** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 8 korrik 2019.

# Komuna e Prizrenit

## Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Prizreni ka popullsinë më madhe rome në Kosovë. Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, nga 177,781 banorë të regjistruar në komunën e Prizrenit 2,899 janë romë të Kosovës, 1,350 janë ashkali të Kosovës dhe 168 janë egjiptianë.<sup>354</sup> ZK-KK-ja vlerëson se deri në dhjetor të vitit 2018, 2,889 romë të Kosovës jetojnë në komunë.<sup>355</sup> Përveç kësaj, ata raportuan se 1,350 ashkali të Kosovës dhe 168 egjiptianë jetojnë në komunë.<sup>356</sup> Pjesëtarët e komunitetit romë, komunitetit ashkali dhe komuniteti egjiptian të Kosovës kryesisht jetojnë në qytetin e Prizrenit, përkatësisht në lagjet "Arbana", "Bazhdarana", "Edit Durham", "Jeni Mahala", "Jeta e Re", "Kurilla", "Ortakoll", "Terzimahalla" dhe "Qytmahalla".<sup>357</sup> Disa pjesëtarë të të tria komuniteteve jetojnë edhe në fshatrat Atmagjië, Krusha e Vogël, Landovicë, Piran, Sërbica e Epërme, Sërbica e Ultë, Shpinadijë, Vllashnjë dhe Zojz.<sup>358</sup>

## Banimi dhe infrastruktura

Standardi i përgjithshëm i infrastrukturës dhe i banimit konsiderohet të jetë i modest. Sidoqoftë, disa shtëpi të përhershme kanë nevojë që të riparohen. Në vitin 2016, komuna financoi renovimin e 18 shtëpive që u përkisnin pjesëtarëve të të tria komuniteteve, në bashkëpunim me OJQ VoRAE. Në vitin 2017, komuna ndau 20,000 EUR për renovime të mëtejme dhe rinovoi edhe 24 shtëpi tjera, prapë në bashkëpunim me OJQ VoRAE.<sup>359</sup> Vetë komunitetet po ashtu përmirësuan infrastrukturën e kanalizimit në lagjen "Jeta e Re", me ndihmën e komunës.<sup>360</sup>

## Përfaqësimi në vendimarrje

Që të tria komunitetet janë të përfaqësuar në mekanizmat lokal për mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e komuniteteve. Më saktësisht, një burrë nga secila nga të tria komunitetet është në KK, ndërsa pjesëtari i komunitetit egjiptian pritet të zëvendësohet nga një pjesëtar i komunitetit goran të Kosovës në pjesën e dytë të mandatit.<sup>361</sup> Një burrë romë i Kosovës i përfaqëson të

të tria komunitetet në KKS. Përveç kësaj, një burrë romë i Kosovës është i punësuar në ZKKK. Të tria komunitetet nuk janë të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Pozitat e NKK-së dhe ZKKK-së janë të detyrueshme në komunën e Prizrenit; sidoqoftë, asnjë nga të tria komunitetet nuk përbëjnë komunitetin më të madh në shumicë numerike për t'u zgjedhur në këto pozita.

## Arsimi

Fëmijët nga komuniteti romë i Kosovës në Prizren janë të regjistruar në sistemin arsimor të Kosovës. Sipas informacionit që është dhënë nga drejtoria komunale e arsimit, janë 593 nxënës romë të Kosovës<sup>362</sup> të cilët vijojnë mësimin në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta "Atmaxha", "Ardhmëria", "Aziz Tolaj", "Dy Dëshmoret", "Emin Duraku", "Ibrahim Fehmiu", "Lekë Dukagjini", "Lidhja Prizrenit", "Mati Logoreci", "Motrat Qirijazi", "Mustafa Bakiu", "Naim Frashëri", "Nazim Kokollari", "Sinan Thaçi", dhe "Zef Lush Marku" në qytetin e Prizrenit dhe fshatrat e afërta. Asnjë shkollë nuk është më larg se katër kilometra nga zonat ku jetojnë pjesëtarët

e të tria komuniteteve.<sup>363</sup>

Përafësisht 50 deri në 60 nxënës romë të Kosovës kanë vijuar orët e gjuhës rome për çdo vit.<sup>364</sup> OJQ e romëve të Kosovës "Nevi Koncepti" ka mbajtur orët pas përfundimit të orarit të shkollës në hapësirat e shkollave "Ardhmëria", "Aziz Tolaj", "Dy Dëshmoret", "Ibrahim Fehmiu", "Lekë Dukagjini", "Mati Logoreci", "Motra Qirijazi" dhe "Mustafa Bakiu", mbështetur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) përmes projektit të quajtur "PROSPECT". Mes 200 dhe 250 nxënës nga të të tria komunitetet kanë vijuar orët plotësuere pas orarit të shkollës.<sup>365</sup>

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Prizrenit nuk e ka përmbushur as pragun minimal për përfaqësimin e përgjithshëm të komuniteteve e as kuotën e veçantë për përfaqësimin e komunitetit në shërbimin civil komunal.<sup>366</sup> Katër romë të Kosovës dhe ashkali të Kosovës punojnë në administratën e komunës - një burrë romë i Kosovës është i punësuar si shërbyes civil dhe dy burra romë të Kosovës dhe një grua ashkali e Kosovës punojnë si personel teknik dhe përkrahës. Përveç kësaj, një burrë egjiptian, tre burra romë të Kosovës dhe një grua rome e Kosovës janë të punësuar në sektorin e shëndetësisë si personel teknik, ndërsa 16 burra romë të Kosovës, pesë burra ashkali të Kosovës dhe një burrë egjiptian janë të punësuar në kompaninë lokale të shërbimeve publike "Ekoregjioni".<sup>367</sup>

Qasja në punësim në sektorin privat mbetet sfidë; burrat nga të tria komunitetet punojnë jozyrtarisht si zanatçinj (farkëtarë, saldatorë, bravandreqës apo



ndërtimtarë), grumbullues të gjërave që riciklohen apo muzikantë.<sup>368</sup> IOM ka zhvilluar projekte të vogla për krijimin e të ardhurave në komunë. Në vitin 2017, ai u dha 15 grante për biznese të vogla pjesëtarëve të komunitetit romë, përfshirë një gruaje. Komuna po ashtu ka mbështetur personat e riatdhesuar me grante për biznese të vogla nga fondi i Ministrisë së Punëve të Brendshme për riintegrimin e personave të riatdhesuar.<sup>369</sup> Gjithsej 474 romë të Kosovës (222 gra, 252 burra), 102 ashkali të Kosovës (41 gra, 61 burra) dhe një burrë egjiptian<sup>370</sup> janë të regjistruar i punëkërkues aktivë në zyrën komunale për punësim, ndërsa qendra për punë sociale raporton se janë 88 familje rome, 28 familje ashkali të Kosovës dhe dhjetë familje egjiptiane që marrin asistencë sociale.<sup>371</sup> Puna e fëmijëve ekziston në komunë. Në përgjithësi djemtë janë të angazhuar në punë bujqësore sezonale apo punë të përkohshme krahu.<sup>372</sup>

## ■ Shëndetësia

Qasja në kujdesin shëndetësor nuk konsiderohet si problem nga përfaqësuesit e të tria komuniteteve.<sup>373</sup> Pjesëtarët e të tria komuniteteve kanë qasje të plotë në objektet e kujdesit shëndetësor, si në zonat urbane edhe ato rurale. Shëndeti reprodaktiv për gratë është në dispozicion falas.<sup>374</sup>

## ■ Kthimi dhe riatdhesimi

Mes datës 1 janar 2016 dhe 31 dhjetor 2018, 141 pjesëtarë të të tria komuniteteve u riatdhesuan në komunë.<sup>375</sup> Gjatë periudhës së njëjtë, nuk u shënuar ndonjë kthim vullnetar nga pjesëtarët e zhvendosur nga të tria komunitetet.<sup>376</sup>

## ■ Gjuha rome

Gjuha rome është folur me traditë në komunë. Një radio stacion, një revistë dhe një teatër që përdorin gjuhën rome funksionojnë në Prizren. Organizatat e shoqërisë civile të komunitetit romë të Kosovës që një kohë të gjatë kanë avokuar për njohjen e gjuhës rome si gjuhë në përdorim zyrtar në Prizren<sup>377</sup>, mbi bazën e asaj që ajo është folur me traditë në komunë. Organizatat e Shoqërisë Civile e kanë komunikuar këtë kërkesë në komunë në vitin 2016 dhe që nga koha e këtij publikimi, komuna nuk ka kthyer përgjigje ndaj kërkesës me shkrim.

**354** Agjencia Statistike e Kosovës, shih më sipër, fusnota 2.

**355** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 14 korrik 2019.

**356** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 14 korrik 2019.

**357** Intervistë me tre përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 24 dhe 26 korrik 2017.

**358** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 24 korrik 2017.

**359** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 24 korrik 2017.

**360** Pas nismës së ndërmarr nga OJQ-ve të komunitetit romë të Kosovës "Nevi Koncepti" dhe "Durmish Asllano", 11 romë të Kosovës dhe dy familje shqiptare të Kosovës u lidhën me sistemin e kanalizimit; monitorimi afatgjatë i ekipit në terren të OSBE-së.

**361** Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2017, duke pasur parasysh popullsinë e madhe të komuniteteve joshumicë në komunën e Prizrenit, për të siguruar përfaqësimin e të gjitha komuniteteve në KK, si dhe në përputhje me numrin e anëtarëve të caktuar për KK në komunën e Prizrenit, u nxor vendimi që anëtari nga radhët e komunitetit egjiptian të Kosovës të zëvendësohet nga komuniteti goran i Kosovës në pjesën e dytë të mandatit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e ka konfirmuar ligjshmërinë e vendimit në fjalë.

**362** Drejtoria komunale e arsimit nuk ka informacion për nxënësit nga radhët e komunitetit ashkali të Kosovës.

**363** Intervistë me tre përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 24 dhe 26 korrik 2017.

**364** Informata bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**365** Intervistë me drejtorin e OJQ "Nevo Koncepti", zhvilluar më 24 korrik 2017.

**366** Raporti i OSBE-së, shih fusnotën më sipër 8.

**367** Intervistë me ZKKK, zhvilluar më 27 korrik 2017.

**368** Intervistë me tre përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 24 dhe 26 korrik 2017.

**369** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 24 korrik 2017.

**370** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punësim, zhvilluar më 12 mars 2019.

**371** Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë nuk janë në dispozicion, intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punë sociale, zhvilluar më 12 mars 2019.

**372** Intervistë me tre përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 24 dhe 26 korrik 2017, dhe me dy përfaqësues të OJQ-së më 20 dhe 24 korrik 2017.

**373** Intervistë me tre përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 24 dhe 26 korrik 2017.

**374** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të shëndetësisë, zhvilluar më 27 korrik 2017.

**375** 91 romë të Kosovës, 44 ashkali të Kosovës dhe 6 egjiptianë të Kosovës. Intervistë me ZKKK, zhvilluar më 14 mars 2019.

**376** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 14 korrik 2019.

**377** Sipas neneve 2.4 dhe 8 të Ligjit nr. 02 / L-37 për përdorimin e gjuhëve (korrik 2006), në ato komuna ku jeton një bashkësi, gjuha amtare e së cilës nuk është njëra nga gjuhët zyrtare në Kosovë dhe e cila përfaqëson më shumë se 3 për qind të popullatës së përgjithshme të komunës, gjuha e asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në atë komunë. Përveç kësaj, një bashkësi, gjuha e së cilës me traditë është folur në një komunë, do të ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në atë komunë. Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, komuniteti romë në komunën e Prizrenit përbën përafërsisht 1.63 për qind të popullsisë së përgjithshme të saj.









# Komuna e Rahovecit

## Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, 56,208 banorë janë të regjistruar në komunën e Rahovecit e nga të cilët 84 janë romë të Kosovës, 404 janë ashkali të Kosovës dhe 299 janë egjiptianë.<sup>378</sup> Që nga korriku i vitit 2017, rreth 900 pjesëtarë nga të gjitha tre komunitetet kanë jetuar në komunë sipas përfaqësuesve të komunitetit dhe vlerësimeve të ZKKK-së.<sup>379</sup> Zonat kryesore ku jetojnë pjesëtarët e komunitetit romë, komunitetit ashkali dhe komuniteti egjiptian të Kosovës janë Rahovec i Epërm dhe Ratkoc,<sup>380</sup> ndërsa pjesëtarë tjerë të të tria komuniteteve jetojnë në disa fshatra përfshirë Celinë, Krushë e Madhe dhe Xërxe.<sup>381</sup> Mes 200 dhe 350 pjesëtarë të të tria komuniteteve jetojnë në Rahovec të Epërm dhe rreth 600 në zonat rurale.<sup>382</sup> Nuk ka pasur shifra të përditësuara në dispozicion në kohën e publikimit.

## Banimi dhe infrastruktura

Shumica dërmuese e pjesëtarëve nga të tria komunitetet jetojnë në shtëpi të përhershme në gjendje modeste. Disa familje nuk kanë asnjë pronë dhe jetojnë ose me të afërmit, ose në prona që janë marrë me qira. Infrastruktura në zonat ku jetojnë pjesëtarët e të tria komuniteteve është bazike, por pjesëtarët e komuniteteve kanë qasje në energji elektrike, furnizim me ujë dhe kanalizim. Disa rrugë janë të asfaltuara dhe disa kanë ndriçim. Sipas përfaqësuesve të komunitetit, pjesëtarët e të tria komuniteteve të cilët jetojnë në kushte jo të mira të banimit i janë drejtuar autoriteteve komunale për përkrahje, por nuk kanë marrë asnjë lloj mbështetjeje.<sup>383</sup> Përveç kësaj, shumë familje nga komunat e tjera jetojnë në komunën e Rahovecit në shtëpitë e marra me qira apo shtëpitë që i takojnë të afërmeve të tyre dhe ata janë të përfshirë në strategjinë komunale për integrimin e personave të riatdhesuar.<sup>384</sup>

## Përfaqësimi në vendimarrje

Të tria komunitetet janë të përfaqësuara në mekanizmat lokal për mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e komuniteteve. Më saktësisht, një burrë egjiptian dhe burrë ashkali i Kosovës janë anëtarë të KK dhe një burrë egjiptian dhe një burrë romë i Kosovës janë anëtarë të KKSB. Një burrë egjiptian punon si drejtor në ZKKK dhe asnjë nga të tria komunitetet nuk janë të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës.<sup>385</sup> Pozitat e NKK dhe ZKKKK nuk janë të detyrueshme në komunë.

## Arsimi

Fëmijët nga të tria komunitetet janë të regjistruar në sistemin arsimor të Kosovës. Sipas informacionit që është dhënë nga drejtorja komunale e arsimit, 69 nxënës romë të Kosovës, 97 ashkali të Kosovës dhe 42 egjiptianë vijnë në mësimin në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në "Ardhmëria" në Rahovec të Epërm, "Bajram Curri" në Krushë të Madhe, "4 Dëshmoret" në

Ratkoc, "Faik Konica" në Celinë, "Rudolf Walther" në Dejnë, "Mustafë Ibishi" në Kramovik, "Hamëz Thaqi" në Xërxe, "Skender Kastrati" në Radostë, "Rilindja" në Çifllak, "Vëllezërit Frashëri" në Drenoc dhe "Liria" në Bellacërkë.

Asnjë shkollë, në të cilat e vijnë në mësimin nxënësit nga të tria komunitetet, nuk është më larg se katër kilometra nga një zonë e veçantë ku jetojnë komunitetet dhe nuk ka ndonjë gjë e cila i parandalon fëmijët që t'ju qasen shkollave.<sup>386</sup> Që nga korriku i vitit 2017, asnjë mësimdhënës nga të tria komunitetet nuk është punësuar në shkollat e komunës dhe orët për gjuhën dhe kulturën romë nuk janë në dispozicion.<sup>387</sup> Ngjashëm, orët e arsimit zyrtar për të rriturit nuk janë në dispozicion.<sup>388</sup> Për më tepër, nuk ka qendra të mësimnxënies përveç OJQ-së "Schüler Helfen Leben" që drejton një projekt që nga maji i vitit 2017, që përfshin orë plotësuese në hapësirat e shkollës për nxënësit nga të tria komunitetet. OJQ-ja po ashtu vepron në cilësinë e ndërmjetësit për arsim duke organizuar takime të rregullta dhe vizita ndërgjegjësimi për të avokuar me prindërit që të regjistrojnë fëmijët e tyre dhe për t'i bindur ata që të vazhdojnë që t'i dërgojnë fëmijët në shkollë pas braktisjes së shkollave nga ata. OJQ-ja gjithashtu nganjëherë jep pajisje të vogla për nxënësit dhe organizon veprimtari të tjera. Ngjashëm, OJQ VoRAE është e angazhuar në fshatin Ratkoc me një projekt të ngjashëm.<sup>389</sup>



## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Rahovecit e ka përmbushur pragun minimal për përfaqësimin e përgjithshëm të komuniteteve në shërbimin civil; megjithatë, kuotat e veçanta për secilin komunitet nuk është e përmbushur përkitazi me përfaqësimin e të tria komuniteteve në shërbimin civil komunal.<sup>390</sup> Që nga 31 dhjetori 2018, asnjë pjesëtar i komuniteteve nuk ka punuar në sektorin publik.<sup>391</sup>

Veprimtaria kryesore ekonomike informale e pjesëtarëve të të tria komuniteteve është puna sezonale në bujqësi (në punishten e verës Stonecastle), ndërtimtari, këndimi në grupe muzikore, mbledhja e mbeturinave metalike, kërkimi i lëmoshës dhe prerja e drunjve. Burrat janë më shumë të angazhuar në këto veprimtari se gratë. Puna e fëmijëve nuk është gjerësisht e përhapur në komunë. Që nga korriku i vitit 2017, mes 10 dhe 15 djem dhe vajza kanë qenë të angazhuar në mbledhjen e mbeturinave metalike në Rahovec të Epërm. Dy gra janë të punësuar në një kompani private.<sup>392</sup> Mes viteve 2016 dhe 2017, Këshilli i Evropës dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale mbajtën disa trajnime dhe projekte për krijimin e të ardhurave për gratë dhe burrat nga të tria komunitetet. IOM po ashtu rregullisht drejton projekte për krijimin e të ardhurave në komunë.<sup>393</sup> Gjithsej 265 (116 gra, 149 burra) romë, ashkali dhe egjiptianë janë të regjistruar si punëkërkuar aktivë, ndërsa 25 romë të Kosovës, 256 ashkali të Kosovës dhe katër egjiptianë marrin asistencë sociale.<sup>394</sup>

## Shëndetësia

Gratë dhe burrat nga të tria komunitetet nuk përballen me vështirësi për t'ju qasur shërbimeve shëndetësore dhe objekteve mjekësore për shkak të distancës fizike.<sup>395</sup> Komuna ofron ndihmë falas dhe në mënyrë të barabartë për shëndetin reprodaktiv për gratë nga të gjitha komunitetet, por nuk ndërmerr veprimtari informimi për komunitetet për të ndërgjegjësuar ato për çështjet e shëndetit reprodaktiv.<sup>396</sup>

## Kthimi dhe riatdhesimi

Mes datës 1 janar 2017 dhe 31 dhjetor 2018, 28 romë të Kosovës, 19 ashkali të Kosovës dhe shtatë egjiptianë u riatdhesuan në komunë, si dhe katër familje u kthyen në mënyrë vullnetare e të cilat ishin të zhvendosura. Nuk kishte të dhëna në dispozicion për vitin 2016.<sup>397</sup>

**378** Agjencia Statistike e Kosovës, shih më sipër, fusnota 2.

**379** Nuk ka zbrëthim të saktë në dispozicion. Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK, zhvilluar më 20 korrik 2017, si dhe me tre përfaqësuesit e komuniteteve, zhvilluar më 24 dhe 25 korrik 2017.

**380** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK, zhvilluar më 20 korrik 2017, si dhe me tre përfaqësuesit e komuniteteve, zhvilluar më 24 dhe 25 korrik 2017.

**381** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 25 korrik 2017.

**382** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 25 korrik 2017.

**383** Intervistë me tre përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 24 dhe 25 korrik 2017.

**384** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 20 korrik 2017.

**385** Informacion i bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**386** Intervistë me tre përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 24 dhe 25 korrik 2017.

**387** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë

komunale të arsimit, zhvilluar më 6 qershor 2017.

**388** Po aty.

**389** Po aty.

**390** Raporti i OSBE-së, shih fusnotën më sipër 8.

**391** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punësim, zhvilluar më 8 mars 2019.

**392** Nuk ka të dhëna të zbrërthyer për komunitetin; intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 20 korrik 2017.

**393** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës komunale për punësim, zhvilluar më 27 korrik 2017.

**394** Intervistë me qendrën për punë sociale, zhvilluar më 8 mars 2019.

**395** Intervistë me tre përfaqësues të komuniteteve, zhvilluar më 24 dhe 25 korrik 2017, si dhe me përfaqësuesin e drejtorisë komunale për shëndetësi, zhvilluar më 27 korrik 2017.

**396** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të shëndetësisë, zhvilluar më 27 korrik 2017.

**397** Nuk ka zbrëthim të saktë në dispozicion. Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 8 mars 2019.







# Komuna e Shtimes

## Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011 në Kosovë, nga 27,324 banorë të regjistruar në komunën e Shtimes, 760 janë ashkali të Kosovës, 23 janë romë të Kosovës dhe asnjë banorë i përkatësisë egjiptiane të Kosovës nuk është i regjistruar në komunë.<sup>398</sup> Që nga dhjetori i vitit 2018, sipas ZKKK-së dhe vlerësimit të përfaqësuesve të komunitetit, 950 ashkali të Kosovës (500 burra, 450 gra) dhe 15 romë të Kosovës (shtatë burra, tetë gra) jetojnë në komunën e Shtimes.<sup>399</sup> Përderisa komuniteti romë i Kosovës jeton në qytetin e Shtimes, banorët ashkali të Kosovës janë të shpërndarë mes qytetit të Shtimes dhe fshatrave Davidovc, Gjurkoc dhe Vojnovc.

## Banimi dhe infrastruktura

Pjesëtarët e komunitetit ashkali dhe të komunitetit romë të Kosovës jetojnë në vendbanime joformale në shtëpi të veçanta të përhershme, me qasje të duhur në energji elektrike, ujë dhe kanalizim. Komuna ka investuar në asfaltimin e rrugëve që çojnë

në zonat ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve. Megjithatë, që nga marsi i vitit 2019, shumica e shtëpive të tyre ishin të vjetra, shpesh kishin rrjedhje nga kulmi apo u mungonte hyrja e dhura apo fasada dhe kishin nevojë që të riparoheshin ose rinovoheshin.

## Përfaqësimi në vendimarrje

Komuniteti ashkali dhe komuniteti romë i Kosovës janë të përfaqësuar në mekanizmat lokal për mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e komuniteteve. Tre burra ashkali të Kosovës dhe një burrë romë i Kosovës janë anëtarë të KK dhe njëri nga burrat ashkali të Kosovës është kryesues i tij. Po i njëjti burrë romë i Kosovës, bashkë me një burrë tjetër ashkali të Kosovës, janë anëtarë të KKSB. Përveç kësaj, një grua ashkali e Kosovës është e punësuar në ZKKK. Të dy komunitetet nuk janë të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Pozitat e NKK dhe ZKKKK nuk janë të dezyrueshme në komunë.

## Arsimi

Fëmijët nga komuniteti ashkali dhe komuniteti romë i Kosovës janë të regjistruar në sistemin arsimor të Kosovës. Sipas drejtorisë komunale të arsimit, gjashtë nxënës romë të Kosovës dhe 154 nxënës ashkali të Kosovës vijojnë mësimin në dy shkolla fillore dhe të mesme të ulëta: "Emin Duraku" në qytetin e Shtimes, "Lasgush Poradeci" në fshatin Gjurkoc, "Emin Duraku" në fshatin Davidovc dhe "Lasgush Poradeci" në fshatin Vojnovc. Objektet shkollore janë brenda distancës prej katër kilometra nga zonat ku jetojnë pjesëtarët e të dyja komuniteteve. Një burrë ashkali i Kosovës është i punësuar si mësimdhënës në shkollë fillore. Komuna nuk ofron orë mësimi për gjuhën dhe kulturën rome apo arsim formal për të rriturit.<sup>400</sup> Ekziston një qendër e mësimnxënies në shkollën fillore dhe të mesme të ulët "Emin Duraku", që drejtohet bashkë nga komuna dhe OJQ "Balkan Sunflowers". Qendra e mësimnxënies vijohet nga rreth 30 djem dhe 25 vajza nga komuniteti ashkali i Kosovës, si dhe nga tre vajza rome dhe një djalë romë i Kosovës.<sup>401</sup>

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Shtimes nuk e ka përmbushur as pragun minimal për përfaqësimin e përgjithshëm të komuniteteve e as kuotën e veçantë për përfaqësimin e komunitetit në shërbimin civil komunal.<sup>402</sup> Që nga korriku i vitit 2017, një grua ashkali e Kosovës ka punuar për ZKKK, dy për drejtorinë komunale të shëndetësisë dhe pesë burra ashkali të Kosovës për drejtorinë komunale të arsimit. Burrat nga komuniteti ashkali i Kosovës janë kryesisht të angazhuar në veprimtari ekonomike informale të tilla si mbledhja e materialeve që riciklohen, ndërsa gratë nuk punojnë.<sup>403</sup> Sipas përfaqësuesve të komunitetit, puna e fëmijëve nuk ekziston në komunë.<sup>404</sup> Për më tepër, tetë burra ashkali të Kosovës dhe një burrë romë i Kosovës u punësuan në sektorin privat.<sup>405</sup> Gjithsej dy burra romë të Kosovës dhe 220 ashkali të Kosovës (116 burra, 104 gra)<sup>406</sup> janë të regjistruar si punëkërkuar aktivë, ndërsa qendra për punë sociale raporton se 47 ashkali të Kosovës dhe një rom i Kosovës marrin asistencë sociale.<sup>407</sup>

## Shëndetësia

Gratë dhe burrat nga komuniteti ashkali dhe komuniteti romë nuk përballen me vështirësi lidhur me qasjen fizike në objektet shëndetësore. Gratë në komunë kanë qasje në ndihmë falas për shëndetin reprodutiv, përfshirë kujdesin para dhe pas lindjes.<sup>408</sup>



## ■ Kthimi dhe riatdhesimi

Mes datës 1 janar 2016 dhe 31 dhjetor 2018, 135 pjesëtarë të komunitetit ashkali të Kosovës (64 burra, 71 gra)<sup>409</sup> u riatdhesuan në komunë. Asnjë pjesëtarë nga të dyja komunitetit nuk u kthye në mënyrë vullnetare në komunë nga vendi i zhvendosjes gjatë të së njëjtës periudhë.

**398** Asnjë pjesëtar i komunitetit egjiptianë nuk ishte i regjistruar në komunë; shih më sipër, fusnota 2.

**399** Intervistë me dy përfaqësuesit e komunitetit, zhvilluar më 9 mars 2019 me përfaqësuesin romë të Kosovës, dhe më 13 mars 2019 me përfaqësuesin ashkali të Kosovës dhe me përfaqësuesin e ZKKK më 12 mars 2019.

**400** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit, zhvilluar më 24 korrik 2017.

**401** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për mësimnxënie, zhvilluar më 25 korrik 2017.

**402** Raporti i OSBE-së, shih fusnotën më sipër 8.

**403** Intervistë me dy përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 17 dhe 21 korrik 2017.

**404** Intervistë me dy përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 17 dhe 21 korrik 2017.

**405** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 25 korrik 2017.

**406** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punësim, zhvilluar më 11 mars 2019.

**407** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punë sociale, zhvilluar më 13 mars 2019.

**408** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, zhvilluar më 19 korrik 2017.

**409** Intervistë me ZKKK, zhvilluar më 12 korrik 2019.







# Komuna e Suharekës

## Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, 59,722 banorë janë të regjistruar në komunën e Suharekës e nga të cilët 41 janë romë të Kosovës, 493 janë ashkali të Kosovës dhe pesë janë egjiptianë.<sup>410</sup> Sidoqoftë, që nga dhjetori i vitit 2018, në bazë të vlerësimit të ZKKK-së, janë 20 romë të Kosovës, 375 ashkali të Kosovës dhe dhjetë egjiptianë.<sup>411</sup> Pjesëtarët e komunitetit ashkali dhe të komunitetit romë të Kosovës jetojnë në qytetin e Suharekës dhe në fshatin Gejlance, ndërsa vetëm komuniteti ashkali i Kosovës jeton në fshatrat Leshan dhe Tërnje.

## Banimi dhe infrastruktura

Gjendja e banimit dhe infrastruktura në komunën e Suharekës është në përgjithësi e kënaqshme. Ndonëse banimi nuk konsiderohet çështje a nevojë urgjente për shumicën dërmuese të pjesëtarëve të komunitetit ashkali dhe të komunitetit romë, shtatë familje ashkali të Kosovës si dhe një grua me tre fëmijë, të cilat janë pa

pronë, kanë kërkuar tokë dhe ndërtimin të shtëpive nga komuna. Në qershor të vitit 2018, organizata humanitare "Rame-ti" e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të Kosovës organizoi një veprimtari për mbledhje e fondeve dhe siguroi mjete për një banesë për gruan ashkali të Kosovës dhe fëmijët e saj. Organizata mbledhi 22,000 EUR dhe bleu banesën për familjen, kurse Kryetari i Suharekës ndau edhe 3000EUR shtesë duke qenë se kostoja e përgjithshme e banesës ishte 25,000EUR. Për më tepër, më 27 korrik 2018, Kryetari i Suharekës dhe Kryesuesi i KK-së nënshkruan një memorandum mirëkuptimi me MPMS për ndërtimin e shtatë shtëpive për familjen e cënueshme të pjesëtarëve ashkali të Kosovës në komunën e Suharekës, përfshirë tre familje ashkali të Kosovës në Gejlance dhe një në Tërnje e të cilat kishin nevojë urgjente për rindërtimin të shtëpive, siç u theksua nga udhëheqësit e komunitetit.

## Përfaqësimi në vendimarrje

Të tria komunitetet janë të përfaqësuara në mekanizmat lokal për mbrojtjen dhe

pjesëmarrjen e komuniteteve. Një burrë romë i Kosovës, një burrë ashkali i Kosovës dhe një burrë egjiptian janë anëtar të KK që kryesohet nga një grua ashkali e Kosovës. Komunitetet janë të përfaqësuara në KKSB nga një burrë romë i Kosovës dhe një grua egjiptiane e Kosovës. Asnjë përfaqësues i komuniteti ashkali të Kosovës nuk është anëtar i KKSB. Asnjë pjesëtarë nga të tria komunitetet nuk punon për ZKKK dhe asnjë nga të tria komunitetet nuk janë të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Pozitat e NKK dhe ZKKKK nuk janë të detyrueshme në komunë.

## Arsimi

Sipas informacionit të dhënë nga drejtorja komunale e arsimit, 36 nxënës ashkali të Kosovës janë të regjistruar në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta "Shkëndija", "Destan Bajrakatari" dhe "7 Marsi" në qytetin e Suharekës. Përveç kësaj, 81 nxënës vijojnë shkollat fillore dhe të mesme të ulëta "Drita" në fshatin Gejlance, "V. P. Shkodrani" në fshatin Leshan dhe "Flamuri Arbërit" në fshatin Reshtan, "Dituria" në Samodrezh dhe "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" në fshatin Sallagrazdë. Shkollat

gjenden mes një deri në katër kilometra nga zonat ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve dhe sipas përfaqësuesve të komuniteteve nuk ka asnjë gjë e cila i parandalon fëmijët për t'ju qasur shkollave.<sup>412</sup> Që nga korriku i vitit 2017, një burrë ashkali i Kosovës punon si mësimdhënës në shkollën fillore dhe të mesme të ulët "V. P. Shkodrani" në fshatin Leshan dhe një burrë ashkali i Kosovës punon si mësimdhënës në shkollën fillore dhe të mesme të ulët "Drita" në fshatin Gejlance.<sup>413</sup> Deri në korrik 2017, nuk ka pasur qendra të mësimnxënies në komunë. Orët e mësimi të gjuhës dhe kulturës rome nuk janë në dispozicion në shkolla dhe as orët e mësimi për arsimin e të rriturve.<sup>414</sup>

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

Komuna e Suharekës nuk e ka përmbushur as pragun minimal për përfaqësimin e përgjithshëm të komuniteteve e as kuotën e veçantë për përfaqësimin e komunitetit në shërbimin civil komunal.<sup>415</sup> Bujqësia është veprimtaria kryesore ekonomike informale për pjesëtarët e të tria komuniteteve në zonat rurale, ndërsa në zonat urbane disa pjesëtarë të komuniteteve punojnë në kompani private apo kryejnë punë sezonale.<sup>416</sup> Shumë romë dhe ashkali të Kosovës punojnë edhe si muzikantë.<sup>417</sup> Sipas ZKKK-së, ndonëse asnjë pjesëtar i komuniteteve nuk është i punësuar në sektorin publik, deri në dhjetor 2018 pesë janë të punësuar në sektorin privat.<sup>418</sup> Gjithsej 695 pjesëtarë të komuniteteve janë të regjistruar si punëkërkuar aktivë në zyrën komunale për punësim,<sup>419</sup> ndërsa qendra për punë sociale raporton se 41 familje ashkali të Kosovës dhe dy familje rome marrin asistencë sociale.<sup>420</sup>



## ■ Shëndetësia

Deri në korrik të vitit 2017, fshatrat Tërnje dhe Leshan kanë objekte shëndetësore që ofrojnë shërbime bazike të kujdesit mjekësor, ndërsa pjesëtarët e të tria komuniteteve nga fshati Gejlanc duhet të udhëtojnë deri në fshatin e afërt Gjinovcë (2 km larg) ose deri në qendrën kryesore shëndetësore në qytetin e Suharekës, e cila është tetë kilometra larg. Komuna ofron ndihmë falas për shëndetin reproduktiv për gratë nga të tre komunitetet.<sup>421</sup>

## ■ Kthimi dhe riintegrimi

Sipas ZKKK-së, dy familje ashkali të Kosovës dhe një familje rome e Kosovës u riadhesuan në komunë mes janarit të vitit 2016 dhe dhjetorit të vitit 2018. Asnjë pjesëtarë nga të tria komunitetët nuk u kthye në mënyrë vullnetare në komunë nga vendi i zhvendosjes gjatë të së njëjtës periudhë.<sup>422</sup>

---

**410** Agjencia Statistikore e Kosovës, shih më sipër, fusnota 2.

**411** Intervistë me ZKKK, zhvilluar më 13 mars 2019.

**412** Intervistë me dy përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 19 korrik 2017.

**413** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit dhe drejtorët e shkollave, zhvilluar më 21 korrik 2017.

**414** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit, zhvilluar më 21 korrik 2017.

**415** Raporti i OSBE-së, shih fusnotën më sipër 8.

**416** Intervistë me dy përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 19 korrik 2017.

**417** Intervistë me dy përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 19 korrik 2017.

**418** Nuk ka të dhëna të zbërthyer për komunitetin; Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 13 mars 2019.

**419** Nuk ka të dhëna të zbërthyer për

komunitetin; intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punësim, zhvilluar më 13 mars 2019.

**420** Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë nuk janë në dispozicion; intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punë sociale, zhvilluar më 13 mars 2019.

**421** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të shëndetësisë, zhvilluar më 19 korrik 2017.

**422** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 13 korrik 2019.









# Komuna e

# Vushtrrisë

## Punësimi dhe mirëqenia sociale

### Pasqyrë e përgjithshme dhe vendbanimet

Regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 ka zbuluar se nga 69,870 banorë të regjistruar në komunën e Vushtrrisë, 68 janë romë të Kosovës, 143 janë ashkali të Kosovës dhe një është egjiptian.<sup>423</sup> Deri në dhjetor të vitit 2018, sipas ZKKK-së dhe përfaqësuesve të komuniteteve, përafërsisht 320 romë të Kosovës, 107 ashkali të Kosovës dhe asnjë egjiptian jetojnë në komunë.<sup>424</sup> Qyteti i Vushtrrisë ka 71 banorë ashkali, gjersa fshati Priluzhë ka 320 romë të Kosovës dhe rreth 36 ashkali të Kosovës jetojnë Stanovc dhe fshatin Bukosh<sup>425</sup>.

### Banimi dhe infrastruktura

Pjesëtarët e komuniteti ashkali, të cilët jetojnë në qytetin e Vushtrrisë dhe në fshatrat Stanovc dhe Bukosh, banojnë në shtëpi të përhershme në pronësi të pjesëtarëve të komunitetit dhe nuk kanë probleme pronësore. Pjesëtarët e komunitetit romë dhe të komuniteti ashkali në fshatin Priluzhë përballen me konteste pronësore duke qenë se ata jetojnë në një vendbanim jo-

formal në një tokë në pronësi komunale dhe nuk posedojnë dokumentacion të pronësisë.<sup>426</sup>

### Përfaqësimi në vendimmarrje

Një burrë romë i Kosovës dhe një burrë ashkali i Kosovës përfaqësojnë komunitetet e tyre në KK. Ngjashëm, një burrë romë i Kosovës dhe një burrë ashkali i Kosovës janë anëtarë të KKSBB. Komuniteti romë dhe komuniteti ashkali i Kosovës nuk kanë përfaqësues në Kuvendin e Komunës dhe asnjë pjesëtar i të dy komuniteteve nuk është i punësuar në ZKKK. Pozitat e NKK dhe ZKKKK nuk janë të detyrueshme në komunë.

### Arsimi

Sipas drejtorit komunal të arsimit, gjashtë nxënës ashkali të Kosovës vijojnë mësimin sipas sistemit arsimor të Kosovës në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta "Mustafë Venhari" dhe "Shkolla nr. 2" në qytetin e Vushtrrisë. Përveç kësaj, dhjetë nxënës ashkali të Kosovës janë të regjistruar në

shkollën "Nazmi Zhegrova" në fshatin Stanovc dhe atë "7 Marsi" në fshatin Bukosh. 48 nxënës romë të Kosovës vijojnë mësimin në sistemin arsimor të Serbisë në shkollën fillore dhe të mesme të ulët "Vuk Karadžić" në fshatin Priluzhë.<sup>427</sup> Një mësimdhënës burrë ashkali i Kosovës ligjëron teknologjinë në shkollën fillore dhe të mesme të ulët "Nazmi Zhegrova" në fshatin Stanovc. Orët e mësimi të gjuhës dhe kulturës rome nuk janë në dispozicion në komunën e Vushtrrisë. Arsimi formal për të rriturit është në dispozicion; megjithatë, deri në korrik të vitit 2017 ai nuk është vijuar nga pjesëtarët e komunitetit romë ose komuniteti ashkali të Kosovës.<sup>428</sup> Një qendër e mësimnxënies që financohet bashkë nga OJQ VoRAE dhe komuna dhe që drejtohet nga OJQ "Roma Road" dhe "Romano Anglunipe" funksionon në fshatin Priluzhë. Qendra e mësimnxënies përballet me vështirësi rreth ngrohjes dhe lidhjes me internet.<sup>429</sup> Për më tepër, qendra e mësimnxënies varet nga projektet që jepen nga VoRAE që ka rezultuar me shqetësime mes përfaqësuesve të komunitetit në lidhje me qëndrueshmërinë afatgjatë të qendrës.

Komuna e Vushtrrisë e ka përmbushur pragun minimal për përfaqësimin e përgjithshëm të komuniteteve në shërbimin civil; megjithatë, kuotat e veçanta për të dyja komunitetet nuk është përmbushur përkritazi me përfaqësimin në shërbimin civil komunal.<sup>430</sup> Deri në dhjetor të vitit 2018, pesë pjesëtarë të komunitetit u punësuan në sektorin publik - dy romë të Kosovës punojnë si mjeshtër në shkollën me sistemin arsimor të Serbisë në Prilluzhë, një ashkali i Kosovës është i punësuar si mësimdhënës në shkollën fillore në fshatin Stanovc dhe një ashkali i Kosovës punon si polic në Prishtinë.<sup>431</sup> Dy ashkali të Kosovës punojnë në sektorin privat (një në mulli në pronësi private dhe një tjetër si shofer në një kompani të shitjeve me shumicë). Mes 10 dhe 15 djem e vajza janë të angazhuar në punën e fëmijëve, duke mbledhur materiale që riciklohen në fshatin Priluzhë.<sup>432</sup> Deri në dhjetor të vitit 2018, 24 ashkali të Kosovës (tetë gra, 16 burra) dhe 22 romë të Kosovës u regjistruan si punëkërkuar aktivë, ndërsa sipas qendrës për punë sociale, nëntë ashkali të Kosovës dhe 32 familje rome marrin asistencë sociale.<sup>433</sup>

### Shëndetësia

Asnjë pengesë nuk u raportua në lidhje me qasjen në kujdesin shëndetësor në komunën e Vushtrrisë. Pjesëtarët e komunitetit ashkali, të cilët jetojnë në qytetin e Vushtrrisë dhe në fshatrat Stanovc dhe Bukosh shfrytëzojnë shërbimet mjekësore që ofrohen nga qendra kryesore e mjekësisë familjare në qytetin e Vushtrrisë, ndërsa në fshatin Priluzhë, romët e Kosovës dhe ashkallitë e Kosovës shfrytëzojnë shërbimet



e qendrës së mjekësisë familje në fshatin Priluzhë.<sup>434</sup>

## ■ Kthimi dhe riatdhesimi

Mes datës 1 janar 2016 dhe 31 dhjetor 2018, rreth 47 familje u riatdhesuan në komuna e Vushtrisë,<sup>435</sup> nga të cilat 22 janë romë të Kosovës dhe përafërsisht 25 janë ashkali të Kosovës. Gjatë periudhës së njëjtë, nuk u regjistruar ndonjë rast i kthimit vullnetar në komunë.<sup>436</sup>

---

**423** Agjencia Statistikore e Kosovës, shih më sipër, fusnota 2.

**424** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 13 mars 2019.

**425** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 13 mars 2019.

**426** Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit, zhvilluar më 12 korrik 2017.

**427** Informacion i bazuar në monitorimin nga ekipet e OSBE-së në terren, aktualisht nga 15 marsi 2019.

**428** Intervistë me përfaqësuesin e drejtorisë komunale të arsimit, zhvilluar më 11 korrik 2017.

**429** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për mësimnxënie, zhvilluar më 12 korrik 2017.

**430** Raporti i OSBE-së, shih fusnotën më sipër 8.

**431** Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punësim, zhvilluar më 13 mars 2019.

**432** Intervistë me përfaqësuesin e OJQ-së, zhvilluar më 12 korrik 2017.

**433** Nuk ka në dispozicion zberthim të dhënave gjinore, nuk ka informacion për numrin e anëtarëve për familje. Intervistë me përfaqësuesin e qendrës për punë sociale, zhvilluar më 13 mars 2019.

**434** Intervistë me dy përfaqësues të komunitetit, zhvilluar më 12 dhe 21 korrik 2017.

**435** Përafërsisht 60 për qind e burrave dhe 40 për qind e grave; Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 11 korrik 2017.

**436** Intervistë me përfaqësuesin e ZKKK-së, zhvilluar më 13 korrik 2019.









# Shtojca 1:

Fotografitë e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta që vijohen nga nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë<sup>437</sup>

KOMUNA	Emri i shkollës fillore dhe të mesme të ulët, vendndodhja	Romë i Kosovës (M / F)	Ashkali i Kosovës (M / F)	Egjiptian (M / F)
<b>Deçan/Deçane</b>	"Jusuf Gërvalla" fshati Prapaqan	3 / 0	0	0
	"Drita" Fshati Gramaçel	0	19 / 19	0
	"Rexhep Kadrijaj" fshati Rastavicë	2 / 2	0	9 / 16
	"Heronjë e Dukagjinit" fshati Glllogjan	4 / 3	1 / 6	0
<b>Ferizaj/Uroševac</b>	"Ahmet Hoxha" Qyteti Ferizaj	3 / 0	0	0
	"Tefik Çanga" Qyteti Ferizaj	0	19 / 19	0
	"Vezir Jashari" Qyteti Ferizaj	2 / 2	0	9 / 16
	"Naim Frashëri" Fshati Zaskok	4 / 3	1 / 6	0
	"Gjon Sereqi" Qyteti Ferizaj			
<b>Fushë Kosovë/ Kosovo Polje</b> <sup>438</sup>	"Selman Riza" Qyteti i Fushë Kosovës	10	180	40
	"Daut Bogujevci" Qyteti i Fushë Kosovës	0	19	0
	"Mihail Grameno" Qyteti i Fushë Kosovës	0	37	5
	"Aca Marović" Fshati Bresje	49	0	0

<sup>437</sup> Të dhënat në lidhje me arsimin u nxorën nga baza e të dhënave e drejtorive komunale të arsimit që ndahen me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe aty ku jo në të gjitha komunat pasqyrohet përkatësia e nxënësve apo nxënësit të regjistruar në bazë të vetë deklaratimit të prindërve kur kanë regjistruar fëmijët e tyre apo në bazë të perceptimit të tyre për përkatësinë e ndonjë nxënësi. Prandaj, mund të vërehen dallime të vogla mes numrit të banorëve që i përkasin të tria komuniteteve sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë së vitit 2011 dhe numrit të fëmijëve nga të tria komunitetet që janë të regjistruar në sistemin arsimor. Të gjitha të dhënat janë të vlefshme që nga data 25 korrik 2018. Të dhënat e arsimit që kanë të bëjnë me komunat e Leposaviqit dhe Mitrovicës së Veriut janë marrë nga një drejtor komunal i arsimit dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik në Serbi, përkatësisht.

<sup>438</sup> Nuk janë në dispozicion të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë për vijueshmërinë e shkollimit në komunën e Fushë Kosovës



KOMUNA	Emri i shkollës fillore dhe të mesme të ulët, vendndodhja	Romë i Kosovës (M / F)	Ashkali i Kosovës (M / F)	Egjiptian (M / F)
<b>Gjakovë/Đakovica</b>	"Mustafa Bakija" Qyteti i Gjakovës	87 / 72	0	50 / 48
	"Zekerija Rexha" Qyteti i Gjakovës	71 / 86	95 / 75	1 / 0
	"Mallum Këpuska" qyteti i Gjakovës	4 / 1	0	0
	Emin Duraku" Qyteti i Gjakovës	39 / 28	15 / 17	10 / 8
	"Fehmi Agani" Qyteti i Gjakovës	0	13 / 13	0
	"Selman Riza" Qyteti i Gjakovës	19 / 11	19 / 28	41 / 48
	"Luigj Gurakuqi" fshati Korenice	0	0	0
	"Dëshmorët e Kombit" fshati Jabllanicë	0	4 / 6	7 / 9
	"Isa Boletini" Fshati Osek Hylë	0	12 / 6	0
	"Sylejman Vokshi" fshati Smolicë	0	0	7 / 12
	"Zef Lush Marku" Gjakovë	29 / 20	72 / 56	12 / 26
	"Fani Noli" Fshati Dujakë	0	15 / 16	0
	"Ukshin Myftari" Fshati Skivjan	0	0	34 / 28
	"Haxhi Hoti" Fshati Rogovë	0	41 / 43	0
	"Dëshmorët e Herecit" Fshati Herec	0	27 / 19	7 / 9
	"Ali M. Hasi" Fshati Cermjan	0	5 / 3	0
<b>Gjilan/Gnjilane</b>	"Vuk Karadžić" Qyteti i Gjilanit	36 / 34	0	0
<b>Gračanica/Gračanicë</b>	"Kralj Milutin" qyteti i Graçanicës	57 / 65	0	0
	"Miladin Mitić" fshati Llapllasellë	63 / 42	0	0
	"Vellezerit Frashëri" (paralele e komunës së Lipjanit) fshati Radevë	0	12 / 3	0
	"Ditët e Minatorit" (paralele e komunës së Prishtinës, vijuar nga nxënësit nga Kishnica dhe Sushica)	0	3 / 0	0

KOMUNA	Emri i shkollës fillore dhe të mesme të ulët, vendndodhja	Romë i Kosovës (M / F)	Ashkali i Kosovës (M / F)	Egjiptian (M / F)
<b>Istog/Istok</b>	"Mithat Frashëri" Qyteti i Istogut	0	2 / 0	37 / 5
	"Martin Camaj" fshati Gurakoc	0	11 / 11	38 / 35
	"Martin Camaj" Llukavc i Thatë	0	6 / 3	22 / 22
	"Bajram Curri" Qyteti i Istogut	10 / 6	12 / 12	1 / 4
	"Bajram Curri" Fshati Cercë	0	1 / 1	1 / 1
	"Bajram Curri" fshati Muzhevinë	0	2 / 1	3 / 6
	"Bajram Curri" Fshati Dubravë	0	0	10 / 3
	"Avni Rustemi" Fshati Zallq	0	0	44 / 41
	"Ismajl Qemajli" fshati Saradran	1 / 3	0	4 / 0
	"Trepça" Fshati Banjë	0	5 / 5	23 / 17
	"Fan S. Noli" Fshati Llukavc i Begut	0	0	4 / 7
<b>Kamenicë/Kamenica</b>	"Desanka Maksimovic" qyteti i Kamenicës (nxënësit nga fshatrat Berivojcë dhe Boscë e vijojnë këtë shkollë)	75 / 66	0	0
	"Idriz Seferi" Fshati Strezoc (nxënësit nga fshati Leshtar e vijojnë këtë shkollë)	6 / 12	0	0
<b>Klinë/Klina</b>	"Ismet Rraci" Qyteti i Klinës	10 / 19	7 / 5	1 / 1
	"Motrat Qiriazhi" Qyteti i Klinës	0	4 / 4	0
	"Motrat Qiriazhi-1" Fshati Zajm	0	4 / 4	0
	"Azem Bejta" fshati Grabanicë	9 / 8	5 / 5	3 / 2
	"Tre Dëshmoret - 2" fshati Jashanicë	0	2 / 2	0
	"Tre Dëshmoret - 3" fshati Gjurgjeviku	0	1 / 2	0
	"Isa Boletini" Fshati Drenoc	0	1 / 0	0
	"Isa Boletini - 1" fshati Poterq i Eperm	3 / 3	3 / 0	0 / 4
	"Atë Gjergj Fishta" fshati Jagodë	4 / 4	16 / 11	0
	"Avni Zhabota" fshati Shtupel	0	17 / 13	0
	"Nënë Tereza" fshati Budisalc	2 / 0	7 / 0	3 / 0



KOMUNA	Emri i shkollës fillore dhe të mesme të ulët, vendndodhja	Romë i Kosovës (M / F)	Ashkali i Kosovës (M / F)	Egjiptian (M / F)
<b>Leposavić/Leposaviq</b>	"Leposavić" qyteti i Leposaviqit	9 / 7	0	0
	"Stana Baćanin" fshati Leshak	1 / 0	0	0
<b>Lipjan/Lipljan</b>	"Fehmi Agani" Qyteti i Lipjanit dhe fshati Medvec	0	37 / 45	0 / 2
	"Haradin Bajrami" Qyteti i Lipjanit dhe fshati Magure	0	29 / 22	0
	"Ismajl Luma" Qyteti i Lipjanit	2 / 3	43 / 40	0
	"Migjeni" Qyteti i Lipjanit	0	26 / 19	0
	"Zenel Hajdini" Qyteti i Lipjanit	0	38 / 67	0
	"Shtjefen Gjeqovi" dhe "Vladimir Nazor" fshati Janjevë	24 / 14	0	0
<b>Mamuşa/Mamushë/Mamuša</b>	"Anadolu" qyteti i Mamushës	4 / 3	0	0
	"Ataturk" qyteti i Mamushës	0 / 1	0	0
<b>Mitrovica/Mitrovicë North</b> <sup>439</sup>	"Desanka Maksimović" qyteti i Mitrovicës së Veriut		3 / 6	
	"Dositej Obradović" qyteti i Mitrovicës së Veriut		6 / 4	
	"Predrag i Miodrag Mihajlović" qyteti i Mitrovicës së Veriut		39 / 38	
	"Sveti Sava" qyteti i Mitrovicës së Veriut		6 / 4	
	"Veljko Banašević" qyteti i Mitrovicës së Veriut			
	"Vlado Četković" qyteti i Mitrovicës së Veriut		2 / 2	
			4 / 6	
			107 / 138	

<sup>439</sup> Të dhënat e ndara sipas komuniteteve nuk ishin në dispozicion për shkollat në këtë komunë.

KOMUNA	Emri i shkollës fillore dhe të mesme të ulët, vendndodhja	Romë i Kosovës (M / F)	Ashkali i Kosovës (M / F)	Egjiptian (M / F)
<b>Mitrovicë/Mitrovica South</b>	"Andon Zako Çajupi" qyteti i Mitrovicës së Jugut	5 / 3	3 / 2	0
	"Bedri Gjinaj" qyteti i Mitrovicës së Jugut	0	20 / 19	0
	"Aziz Sylejmani" qyteti i Mitrovicës së Jugut	0	6 / 6	0
<b>Novo Brdo/Novobërdë</b>	"Miladin Popović" fshati Bostan	10 / 9	0	0
<b>Obiliq/Obilić</b>	"Ibrahim Rugova" Qyteti i Obiliqit	0	9 / 10	0
	"Pandeli Sotiri" Fshati Plemetin	0	46 / 49	0
	"Fazli Grajqevci" fshati Milloshevë	0	7 / 6	0
	"Hasan Prishtina" fshati Milloshevë	0	17 / 10	0
	"Ismajl Dumoshi" Qyteti i Obiliqit	0	5 / 2	0
	"Dositaj Obradović" fshati Carravodicë	3 / 0	0	0
	"Sveti Sava" Fshati Plemetin	74 / 86	0	0
	"Branko Radičević" qyteti i Obiliqit <sup>440</sup>	15	0	0
<b>Pejë/Peć</b>	"Xhemajl Kada" Qyteti i Pejës	121 / 117	0	0
	"7 Shtatori" Fshati Vitomericë	8 / 5	0	22 / 19
	"7 Shtatori" Fshati Brestovik	4 / 6	0	0
	"Dëshmorët e Kombit" fshati Baran	2 / 1	0	2 / 1
	"Dëshmorët e Kombit" fshati Çallapek	3 / 2	0	3 / 2
	"Dardania" Qyteti i Pejës	0 / 2	3 / 1	0 / 9
	"Migjeni" Fshati Glllogjan	0 / 4	0	4 / 8
	"Naum Veqilharxhi" fshati Kliçinë	0	6 / 3	8 / 9
	(vijohet nga nxënësit nga fshati Rosujë)			

<sup>440</sup> Pesëmbëdhjetë nxënës romë, bazuar në monitorimin e ekipeve të OSBE-së deri më 15 mars 2019. Të dhënat e ndara sipas gjinisë nuk ishin në dispozicion për këtë shkollë.



KOMUNA	Emri i shkollës filllore dhe të mesme të ulët, vendndodhja	Romë i Kosovës (M / F)	Ashkali i Kosovës (M / F)	Egjiptian (M / F)
<b>Pejë/Peć</b>	"28 Nëntori" Fshati Raushiq, degë e shkollës	0	0	1 / 9
	"28 Nëntori" Fshati Lubeniq, degë e shkollës	0	0	4 / 3
	"28 Nëntori" Fshati Zllapek, Degë e shkollës	0	0	4 / 1
	"Pjetër Budi" Fshati Poçestë	1 / 1	0	0 / 1
	"Pjetër Budi" 1 Fshati Orasje, degë e shkollës	14 / 15	0	7 / 5
	"Rilindja" Fshati Trestenik	5 / 5	7 / 3	0
	"Rilindja" Fshati Ruhot, degë e shkollës	0	0	4 / 6
	"Skenderbeu", Fshati Treboviq		63 / 58	
	(vijohet nga nxënësit nga fshatrat Qungur dhe Katundi i Ri) <sup>441</sup>			
	"Haxhi Zeka" Fshati Zaha		14 / 11	
	(vijohet nga nxënësit nga fshati Nakëll) <sup>442</sup>			
	"Lidhja e Pejës" fshati Novosellë	0	10 / 5	0
	"Ali Kelmendi" Fshati Nabërgjan	1 / 0	0	0 / 3
"Skender Çeku" Fshati Qyshk	0	0	6 / 10	
"2 Korriku" Fshati Loxhë	2 / 4	0	1 / 0	
<b>Podujevë/Podujevo</b>	"Naim Frashëri" qyteti i Podujevës	7 / 3	38 / 20	0
	"Enver Maloku" qyteti i Podujevës	0	3 / 2	0
	"Shaban Shala" Qyteti i Podujevës	0	4 / 6	0
	"Ibrahim Rugova" qyteti i Podujevës	0	26 / 25	0
	"Ali Ajeti" Fshati Sfeqël	0	2 / 3	0
	"Luigj Gurakuqi" Fshati Batllavë	0	3 / 3	0
	"Zahir Pajaziti" Fshati Orllane	0	2 / 3	0

<sup>441</sup> Nuk janë në dispozicion të dhënat e zbrëthyera sipas përkatësisë etnike. Numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar është 121, nga të cilët 63 janë djem dhe 58 vajza.

<sup>442</sup> Nuk janë në dispozicion të dhënat e zbrëthyera sipas përkatësisë etnike. Numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar është 25, nga të cilët 14 janë djem dhe 11 vajza.

KOMUNA	Emri i shkollës fillore dhe të mesme të ulët, vendndodhja	Romë i Kosovës (M / F)	Ashkali i Kosovës (M / F)	Egjiptian (M / F)
<b>Prishtinë/Priština</b>	"Asim Vokshi" Qyteti i Prishtinës	0	17 / 20	0
	"Emin Duraku" Qyteti i Prishtinës	0	16 / 9	0
	"Gjergj Fishta" Qyteti i Prishtinës	0	3 / 6	0
	"Model" Qyteti i Prishtinës	0 / 4	0	0
	"Nexhmi Mustafa" qyteti i Prishtinës	0	3 / 2	0
	"Pjeter Bogdani" qyteti i Prishtinës	0	1 / 1	0
<b>Prizren</b>	"Ardhmëria" Fshati Landovica	16 / 13	0	0
	"Aziz Tolaj" Qyteti i Prizrenit	64 / 117	0	0
	"Dy Dëshmoret" Fshati Pirana (vijohet edhe nga nxënësit nga fshati Sërbica e Ultë)	44 / 33	0	0
	"Emin Duraku" Qyteti i Prizrenit <sup>443</sup>	N/A	N/A	N/A
	"Ibrahim Fehmiu" Qyteti i Prizrenit	27 / 26	0	0
	"Leke Dukagjini" Qyteti i Prizrenit	41 / 34	0	0
	"Lidhja Prizrenit" Qyteti i Prizrenit <sup>444</sup>	N/A	N/A	N/A
	"Mati Logoreci" Qyteti i Prizrenit	55 / 64	0	0
	"Motrat Qirijazi" Qyteti i Prizrenit <sup>445</sup>	N/A	N/A	N/A
	"Mustafa Baku" Qyteti i Prizrenit	10 / 8	0	0
	"Nazim Kokollari" Qyteti i Prizrenit	8 / 12	0	0
	"Atmaxha" Fshati Atmagjë	1 / 2	0	0
	"Zef Lush Marku" Velezhë dhe Caparc (vijohet edhe nga nxënësit nga fshati Shpinadijë)	6 / 2	0	0
	"Naim Frashëri" Fshati Vllashnjë	0 / 1	0	0
	"Sinan Thaçi" Fshati Zojz	4 / 5	0	0

<sup>443</sup> Nuk ka të dhëna në dispozicion për numrin e përgjithshëm të nxënësve të regjistruar si dhe nuk ka zëbërthim sipas përkatësisë apo gjinisë së tyre.

<sup>444</sup> Po aty.

<sup>445</sup> Po aty.



KOMUNA	Emri i shkollës fillore dhe të mesme të ulët, vendndodhja	Romë i Kosovës (M / F)	Ashkali i Kosovës (M / F)	Egjiptian (M / F)
<b>Rahovec/Orahovac</b>	"Ardhmeria" Zona e Rahovecit të Epërm	20 / 15	6 / 5	6 / 7
	"Bajram Curri" Fshati Krushë e Madhe	0	10 / 18	0
	"4 Dëshmoret" Fshati Ratkoc	16 / 16	0	0
	"Faik Konica" Fshati Celinë	0	12 / 9	0
	"Rudolf Walther" Fshati Dejnë	0	4 / 1	4 / 2
	"Mustafë Ibishi" Fshati Kramovik	1 / 1	10 / 4	0
	"Hamëz Thaqi" Fshati Xërxe	0	0	9 / 7
	"Skender Kastrati" fshati Radostë	0	6 / 5	0
	"Rilindja" Fshati Çifllak	0	0	0 / 3
	"Vëllezërit Frashëri" fshati Drenoc	0	5 / 2	0
	"Liria" fshati Bellacërkë	0	0	3 / 1
<b>Shtime/Štimlje</b>	"Emin Duraku" qyteti i Shtimes	2 / 4	46 / 44	0
	"Emin Duraku" fshati Davidovc	0	1 / 1	0
	"Lasgush Poradeci" fshati Gjurkoc	0	23 / 23	0
	"Lasgush Poradeci" fshati Vojnovc	0	8 / 8	0

KOMUNA	Emri i shkollës fillore dhe të mesme të ulët, vendndodhja	Romë i Kosovës (M / F)	Ashkali i Kosovës (M / F)	Egjiptian (M / F)
<b>Suharekë/Suva Reka</b>	“Shkendija” Qyteti i Suharekës	0	13 / 19	0
	“Destan Bajrakatari” qyteti i Suharekës	0	1 / 1	0
	“Drita” Fshati Gejlance	0	27 / 20	0
	“Vaso Pashë Shkodrani” fshati Leshan (vijohet edhe nga nxënësit nga fshati Tërnje)	0	10 / 12	0
	“Flamuri Arbërit” Fshati Reshtan	0	1 / 0	0
	“Dituria” Fshati Samodrezh	0	3 / 0	0
	“7 Marsi” Qyteti i Suharekës	0	1 / 1	0
	“Gjergj Kastriot Skënderbeu” fshati Sallagrazhdë	0	2 / 4	0
<b>Vushtrri/Vuçitrn</b>	“Mustafë Venhari” qyteti i Vushtrrisë	0	3 / 0	0
	“Shkolla nr. 2” Qyteti i Vushtrrisë	0	2 / 1	0
	“Nazmi Zhegrova” fshati Stanovc	0	1 / 4	0
	“Vuk Karadžić” Fshati Priluzhë	29 / 19	0	0
	“7 Marsi” Fshati Bukosh	0	4 / 1	0



# Shtojca 2: Informatat në këtë tabelë janë të bazuara në të dhënat e regjistrimit të popullsisë më 2011<sup>446</sup> apo vlerësimet e përafërta autoritative në rast se nuk ka shifra zyrtare.<sup>447</sup> Komunitet e mbuluara në këtë publikim janë të nënvizuara me ngjyrë të gjelbër.

KOMUNA	Gjithsej popullatë	Ashkali të Kosovës			Egjiptianë të Kosovës			Romë të Kosovës		
		Gjithsej	Gra	Burra	Gjithsej	Gra	Burra	Gjithsej	Gra	Burra
Deçan	40,019	42	21	21	393	189	204	33	14	19
Dragash	33,997	4	2	2	3	2	1	3	1	2
Ferizaj	108,610	3,629	1834	1795	24	12	12	204	96	108
Fushë Kosovë	34,827	3,230	1560	1670	282	134	148	436	204	232
Gjakovë	94,556	613	299	314	5,117	2597	2520	738	362	376
Gjilan	90,178	15	9	6	1	1	0	361	182	179
Glllogoc	58,531		0	0	2	1	1		0	0
Graçanicë	10,675	104	47	57	3	1	2	745	383	362
Hani i Elezit	9,403		0	0		0	0		0	0
Istog	39,289	111	64	47	1,544	782	762	39	18	21
Junik	6,084		0	0		0	0		0	0
Kaçanik	33,409	1	1	0		0	0	5	5	0
Kamenicë	36,085		0	0		0	0	240	108	132
Klinë	38,496	85	45	40	934	455	479	78	36	42
Klokot	2,556		0	0		0	0	9	5	4
Leposaviq	18,635		0	0		0	0	64 <sup>448</sup>	0	0
Lipjan	57,605	1,812	876	936	4	3	1	342	154	188
Malishevë	54,613	5	4	1		0	0	26	13	13

<sup>446</sup> Të dhënat e nxjerra nga platforma online Askdata e operuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në dispozicion në <http://askdata.rks-gov.net/>

<sup>447</sup> Shifrat e përgjithshme të popullatës dhe ato të numrit total të romëve, ashkallive dhe egjiptianëve të Kosovës për komunat Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok dhe Zveçan janë paraqitur ashtu siç gjenden në raportin Profilet Komunale të OSBE-së për vitin 2018, përveç nëse nuk është cekur ndryshe. Në rast se shifrat e popullsisë së komuniteteve në raportin e Profileve Komunale të OSBE-së për vitin 2018 nuk janë të ndara sipas komuniteteve, shifrat e filla nuk janë përfshirë.

<sup>448</sup> Ky numër total i romëve të Kosovës në Leposaviq në kuadër të këtij raporti është i bazuar në vlerësimin e siguruar nga përfaqësuesi i komunitetit.

KOMUNA	Gjithsej popullatë	Ashkali të Kosovës			Egjiptianë të Kosovës			Romë të Kosovës		
		Gjithsej	Gra	Burra	Gjithsej	Gra	Burra	Gjithsej	Gra	Burra
<b>Mamushë</b>	5,507	12	6	6	0	0	0	39	21	18
<b>Mitrovicë Veriore</b> <sup>449</sup>	22,530		0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Mitrovicë Jugore</b>	71,909	647	317	330	6	4	2	528	265	263
<b>Novobërdë</b>	6,729	3	2	1	0	0	0	63	31	32
<b>Obiliq</b>	21,549	578	284	294	27	15	12	661	335	326
<b>Partesh</b>	1,787		0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Pejë</b>	96,450	143	72	71	2,700	1317	1383	993	527	466
<b>Podujevë</b>	88,499	680	328	352	2	2	0	74	37	37
<b>Prishtinë</b>	198,897	557	276	281	8	5	3	56	25	31
<b>Prizren</b>	177,781	1,350	650	700	168	89	79	2,899	1483	1416
<b>Rahovec</b>	56,208	404	193	211	299	151	148	84	43	41
<b>Ranilug</b>	3,866		0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Shtime</b>	27,324	750	357	393		0	0	23	12	11
<b>Skenderaj</b>	50,858	10	3	7	1	0	1		0	0
<b>Shtërpçë</b>	6,949	1	1	0		0	0	24	11	13
<b>Suharekë</b>	59,722	493	256	237	5	2	3	41	18	23
<b>Viti</b>	46,987	14	6	8		0	0	12	5	7
<b>Vushtrri</b>	69,870	143	68	75	1	1	0	68	34	34
<b>Zubin Potok</b>	13,900		0	0		0	0		0	0
<b>Zveçan</b>	16,800		0	0		0	0		0	0
<b>Gjithsej</b> <sup>450</sup>	1,739,825	15,436	7,581	7,855	11,524	5,763	5,761	8,824	4,428	4,396

<sup>449</sup> Vlerësimet më të fundit të siguruara nga përfaqësuesit e komunitetit dhe të paraqitura në segmentin e këtij raporti mbi Mitrovicën e Veriut, tregojnë se janë rreth 86 romë dhe ashkali të Kosovës në komunë, ndonëse nuk ka të dhëna të ndara për këto komunitete.

<sup>450</sup> Totali i popullatës së përgjithshme dhe shifrat totale sipas komuniteteve dhe gjinive janë të bazuara vetëm në të dhënat e nxjerra nga platforma online Askdata e operuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në dispozicion në <http://askdata.rks-gov.net/>.





# PASQYRË E KOMUNITETIT ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN TË KOSOVËS